



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:  
“Politika dhe Administrim” me profil: “Administrim Publik”  
Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof.Asoc.Dr. Ilir TOMORRI**

**Dr. Dorian PANO**

**Korrik/ 2024**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**  
**Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim” me profil: “Administrim Publik”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Administrimit Publik
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në: “Politika dhe Administrim”, me profil “Administrim Publik”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 1002, datë 30.09.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr. 123, datw 14.06.2018 Miratuar me Shkresë MASR, Nr.7241/1 prot, datë 31.08.2018; Vendim Senati Nr. 33, datw 23.12.2022 Miratuar me Shkresë MAS, Nr. 2085/1 prot, datë 27.06.2022
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 132, datë 05.06.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 Vite / 4 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7




17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 PAE/ 3 PAK: V.A. 2022-2023 9 PAE/ 3 PAK: V.A. 2021-2022 9 PAE/ 3 PAK: V.A. 2020-2021
18	Numri i studentëve:	57 - Studentë: V.A. 2022-2023 51 - Studentë: V.A. 2021-2022 42 - Studentë: V.A. 2020-2021
19	Komente / të tjera:	-

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, është Institucion i Arsimit të Lartë publik i cili ofron shërbime publike në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë. Ky universitet është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. VKM, Nr. 801, datë 20.12.2005 dhe akredituar me Vendim BA Nr. Nr. 18, datë 24.03.2022, me kohëzgjatje 4 vite, për periudhën 24.03.2022 deri 23.03.2026.


Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD, në vijim të këtij raporti) është universiteti më i madh publik që ndodhet jashtë kryeqytetit, Tiranë. UAMD përbëhet nga pesë fakultete:

1. Fakulteti i Biznesit;
2. Fakulteti i Shkencave Politike - Juridike;
3. Fakulteti i Edukimit;
4. Fakulteti i Studimeve Profesionale;
5. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;

Ky universitet, ofron programe studimi në ciklin e parë të studimeve (Bachelor), ciklin e dytë të studimeve Master Profesional dhe Master i Shkencave dhe në ciklin e tretë të studimeve të doktoraturës. Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike (FShPJ, në vijim të këtij raporti) është hapur me VKM, Nr. 685, datë 25.08.2010 si një nga njësitë kryesore të Universitetit “Aleksandër Moisiu” (UAMD). Ky fakultet, përbëhet nga tre departamente:

1. Departamenti i Drejtësisë;
2. Departamenti i Shkencave Politike;
3. Departamenti i Administrimit Publik;

FShPJ për vitin akademik 2022-2023, ofron gjithsej 21 programe studimi: 5 (pesë) programe studimi në ciklin e parë të studimeve (Bachelor), 9 (nëntë) programe në ciklin e dytë të studimeve Master Profesional, dhe 6 (gjashtë) programe në ciklin e dytë Master i Shkencave dhe 1 (një) në





ciklin e dytë Master i Shkencave (Integruar). Programi i studimit, Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik” ofrohet nga Departamenti i Administrimit Publik, pranë Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike.

Ky program studimi është hapur me VKM, Nr. 1002, datë 30.09.2009 si DND. në: “Politika dhe administrim”, me profile: i) “Administrim publik”; ii) “Administrim financiar”. Ai është riorganizuar me Vendim Senati të UAMD, Nr. 122, datë 14.06.2018, miratuar nga MASR me shkresë Nr 7241/1, datë 31.08.2018; si dhe në vitin 2022, me Vendim Senati të UAMD, Nr. 33, datë 28.03.2022, konfirmuar nga MAS me shkresën Nr. 2085/1 prot, datë 27.06.2022.

Programi i studimit, realizohet me një kohëzgjatje 2 (dy) vite akademike me 120 kredite. Ky program ofrohet në gjuhën shqipe.

Programi i studimit Master i shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik” ka si qëllim të ofroj studime të thelluara teorike dhe aftësi praktike në fushën e administrimit publik, për ti pajisur studentët me njohuri të avancuara për karrierën e tyre të mëtejshme akademike dhe profesionale.

Në përfundim të studimeve, ata do të jenë të pajisur dhe të formuar profesionalisht si specialistë të aftë në fushën e administrimit publik. Gjithashtu, përfundimi me sukses, në këtë programi studimi u mundëson studentëve të diplomuar, vazhdimin drejt një karriere të mëtejshme kërkimore dhe akademike për studimet e ciklit të tretë të doktoraturës.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik”, është përgatitur nga ekspertët; Prof. Asoc. Dr. Ilir Tomorri dhe Dr. Dorian Pano, të kontraktuar nga kordinatori teknik i ASCAL Znj. Rajna Lila.

Për të hartuar Raportin e Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) grupi i ekspertëve u mbështet në një sërë dokumentash që u aksesuan nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL, të cilat ishin të përfshira në Dosjen e Vetëvlerësimit për këtë program studimi, të ofruar nga Departamenti i Administrimit Publik dhe Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike, i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Gjithashtu, informacionet dhe të dhënat e nevojshme për hartimin e këtij raporti u plotësuan edhe gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion të ekspertëve gjatë vizitës dy ditore në institucion, nëpërmjet intervistave të zhvilluara me personelin akademik dhe administrativ si dhe studentët e programit të studimit të këtij universiteti.

Për të bërë vlerësimin e jashtëm të programit grupi i ekspertëve është mbështetur në kriteret e vendosura në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm, ekspertët kanë ndjekur një metodologji, bazuar tek analizimi i dokumentave dhe përputhja e tyre me kriteret dhe kërkesat ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit Master i Shkencave në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Vlerësimi i programit të studimit u realizua në përputhje me kërkesat e raportit të vlerësimit sa i përket fushave, standardeve dhe kriterëve përkatëse, duke u përqendruar në analizën e planit mësimor, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, përmbajtjes së lëndëve dhe literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik në lidhje me këtë program studimi, infrastrukturës në mbështetje të programit, sigurimit të brendshëm të cilësisë, mbështetjes së studentëve, etj. Vizita 2 ditore në Fakultetin e Shkencave Politike-Juridike (FShPJ) të UAMD-së u realizua gjatë datave 02 & 03/11/2023, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, shoqëruar dhe nga koordinatori teknik i ASCAL, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL. Gjatë kësaj vizite 2- ditore, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u takua me Dekanin e FShPJ, Përgjegjësin e Departamentit, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB), Koordinatorin institucional, stafin akademik të departamentit, studentët e këtij programi studimi. Gjithashtu, gjatë kësaj vizite u realizuan takimet me përfaqësues dhe punonjës të Sekretarisë mësimore, Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC), Njësisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), Sektorit të Burimeve Njerëzore (SBNj), Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve (SPMP), Sektorit të Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit (SKAK), si dhe vizita në mjediset e IAL (auditorë, bibliotekë, laboratorë dhe shërbimeve për studentët, etj.).

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe informacionin dhe të dhënat e mbledhura gjatë takimeve dhe vizitës të realizuar në këtë Institucion.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik” (në vijim, MSh_PAAP), ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike (në vijim, FShPJ) si një nga njësitë kryesore, të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës (në vijim, UAMD). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (në vijim GJV) për të shqyrtuar shkallën e përmbushjes së këtij kriteri analizoi përmbajtjen e dy dokumenteve të rëndësishëm në Dosjen e Vetë Vlerësimit (në vijim DVV), Statutin e Institucionit dhe Planin e Zhvillimit Strategjik të Institucionit.</p> <p>Referuar dokumentacionit të shqyrtuar (<i>Statuti i UAMD-së, Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD-së</i>), GJV konstatoi se programi i studimit Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik (PAAP)”, është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit, të cilat janë të shprehur në planin strategjik të UAMD 2020-2025. Ky program studimi nuk bie ndesh me interesat dhe strategjitë kombëtare të ekonomisë dhe zhvillimit të Arsimit të Lartë në vendin tonë. Nëpërmjet këtij program studimi synohet dhe mundësohet, përgatitja e specialistëve të rinj dhe të aftë në fushën e administrimit publik në shërbim të interesave kombëtare. GJV vlerëson se në tërësi, UAMD ka si mision ofrimin e programeve të studimit që synojnë zhvillimin dhe konservimin e vlerave akademike kombëtare në zhvillimin e vendit.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e	Referuar dokumentacionit lidhur me strategjinë e zhvillimit të institucionit rezulton se, Programi i studimeve Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim



<p>institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Publik”, është në përputhje me misionin dhe objektivat e Institucionit.</p> <p>Referuar statutit të UAMD, (neni 3, 4), misioni dhe qëllimi i këtij Institucioni, ndër të tjera është:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Të krijojë, zhvillojë e të përcjell dije, përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor;</li> <li>b. Të formojë dhe përgatisë profesionistë të rinj dhe të aftë për shoqërinë demokratike shqiptare dhe vlerat europiane;</li> <li>c. Të zhvillojë të menduarit kritik e analitik, të kultivojë ndjenjën e përgjegjësisë dhe angazhimit;</li> <li>d. Të nxisë dhe ofrojë arsimin universitar të integruar me praktikën profesionale për të përgatitur specialistë që përmbushin kërkesat e tregut të punës;</li> <li>e. Të realizoj kualifikime shkencore, me qëllim rritjen e aftësive akademike të personelit akademik sipas fushave përkatëse;</li> <li>f. Të kryejë studime shkencore për të zhvilluar dije të qëndrueshme si dhe për të dhënë kontribut në zhvillimin e vendit.</li> </ol> <p>Referuar, Rregullores së programit të studimit, (Kreu I, neni 7), ky program ka si mision të sigurojë studime të thelluara dhe të avancuara në teorinë dhe në kërkimin shkencor në fushat e Administrimit Publik. Përgatitja e studentëve për vlerësimin e problematikave të organizatave në hapësirën kombëtare dhe ndërkombëtare; si dhe për marrjen e informacionit bazë me qëllim vazhdimin e studimeve të mëtejshme në fusha të ngjashme për Master Ekzekutiv, Doktoratë, etj. Programi i studimit MSh PAAP synon të përgatisë studentët me çështje konkrete të administrimit dhe menaxhimit në institucionet publike në nivel qendror dhe lokal për vlerësimin e problematikave dhe fenomeneve sociale, në mënyrë që të përmirësohet efektiviteti i politikave, shërbimeve dhe programeve publike. Duke gjykuar nga misioni dhe objektivat e programit të studimit, GVJ është i mendimit se ato ofrohen dhe janë në përputhje me fushat e veprimtarisë së Institucionit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 1. Statuti i UAMD-së;</i>  <i>Aneks 10. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD-së;</i>  <i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p>
---	---




	<p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i>  <i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i>  <i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit MSh_PAAP.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit (Statutin e Institucionit, Planin e Zhvillimit Strategjik, Rregulloret përkatëse), GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik”, është hartuar në përputhje të plotë me planin strategjik të zhvillimit të UAMD-së. Ky program ka si objektiva, dhënien e njohurive të thella teorike dhe shkencore për formimin e studentëve si specialistë të lartë në fushën e administrimit publik, në përputhje me strategjinë e institucionit. Statuti, rregullorja e UAMD, FShPJ si dhe rregullorja e programit të studimit MSh_PAAP, përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të institucionit.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik”, është hartuar për ti ofruar studentëve njohuritë dhe përgatitjen e nevojshme në përputhje me fushën e studimit. Ai synon pajisjen e studentëve me njohuri profesionale drejt të menduarit kritik dhe të aftë për tregun e punës në sektorin publik por edhe atë privat.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>GVJ konstaton se, nga analiza e objektivave formues të programit të studimit, janë në përputhje me strategjinë kombëtare dhe prirjet globale të zhvillimit ekonomik. Organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit MSh_PAAP është në përputhje me Planin e Zhvillimit Strategjik të UAMD-së, Planin Strategjik të FShPJ, si dhe Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike, etj. Përmirësimet e vazhdueshme në planet mësimore dhe programet e lëndëve të këtij program studimi, janë në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit, trendet globale të zhvillimit dhe objektivin e Shqipërisë për t’u anëtarësuar në BE. Si përfundim, në gjykimin e GVJ, përgatitja e specialistëve të aftë dhe pajisja e tyre me njohuri të avancuara teorike, praktike dhe shkencore në fushën e administrimit dhe menaxhimit publik, shërbimeve dhe politikave publike, buxhetimit publik, dhe politikave fiskale në sektorin publik, është në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit të vendit.</p> <p><i>Referenca:</i></p>






	<p><i>Aneks 1. Statuti i UAMD-së;</i>  <i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i>  <i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i>  <i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i>  <i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit MSh_PAAP.</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik”, është hartuar në përputhje të plotë me statutin dhe planin strategjik të zhvillimit të UAMD-së. Ky program studimi ka si synim formimin e specialistëve të aftë dhe pajisjen e tyre me njohuri të avancuara teorike, praktike dhe shkencore në fushën e administrimit publik, shërbimeve dhe politikave publike, buxhetimit në sektorin publik.</i></p> <p><i>Në gjykimin e GVJ, program i studimit paraqitet i kompletuar për të garantuar përmbushjen e interesave dhe vlerave kombëtare dhe avancimin e tyre në drejtim të zhvillimit ekonomik, rritjes së cilësisë së administrimit dhe menaxhimit në sektorin publik. GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.2

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**


<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	GVJ shqyrtoi, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni në sistemin AMS të ASCAL (DVV) dhe në mënyrë të veçantë, Rregulloren e UAMD-së, Rregulloren e programit të studimit MSh_PAAP, Statutin dhe Planin e Zhvillimit Strategjik. GVJ konstaton se UAMD, ka një përvojë të konsiderueshme dhe burime e duhura në fushën akademike në përputhje me qëllimin kryesor të këtij institucioni, përcjelljen e dijës tek studentët. UAMD, FShPJ dhe Departamenti i Administrimit Publik (në vijim, DAP), dëshmojnë se kanë kapacitetet e duhura në fushën akademike, mësimdhënëse për ofrimin e programit të studimit të





	<p>ciklit të dytë Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik”.</p> <p>Nga shqyrtimi i listës si dhe CV-ve të personelit akademik të angazhuar në DAP dhe në programin e studimit MSh_PAAP, GVJ është i mendimit se stafi akademik efektiv, ashtu edhe i jashtëm me kontratë, kanë kualifikimet e duhura akademike, profesionale dhe shkencore në përputhje me fushën e programit të studimit. Si përfundim, GVJ gjykon se, FShPJ dhe DAP, kanë kapacitetet dhe burimet e nevojshme si dhe përvojën e duhur për të ofruar këtë program studimi.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 1. Statuti i UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 10. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 99. Lista e Stafit Akademik në këtë program studimi;</i></p> <p><i>Aneks 114. CV e stafit akademik_DAP_FSHPJ.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njesisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik” ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike (FShPJ) si një nga njësitë kryesore, të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Ky fakultet, referuar rregullores (Kreu II, neni 9), përbëhet nga 3 (tre) njësi bazë (departamente):</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Departamenti i Administrimit Publik;</li> <li>2) Departamenti i Drejtësisë;</li> <li>3) Departamenti i Shkencave Politike;</li> </ol> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues, GVJ konstatoi se; fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit, Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik” është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njesisë kryesore (FShPJ) dhe njesisë bazë (DAP) që është përgjegjëse për realizimin e këtij programi studimi. Referuar të dhënave (<i>Aneksi 34,35</i>), programi i studimit</p>




	<p>MSh_PAAP është kodifikuar në përputhje me kërkesat ligjore (VKM 310/2022).</p> <p>Referuar, Planit Mësimor_MSh_PAAP, lëndët e tij janë specifikuar sipas kategorive A-E, në përputhje me kriteret e VKM Nr.41, datë 24.01.2018, ndryshuar me VKM nr.879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185, datë 25.3.2021. GVJ gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqërues, (<i>Statuti i UAMD, Kreu II, neni 8,9, 10; Rregullores së UAMD, Kreu II, neni 10,</i>) Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike (FShPJ) është njësi kryesore përgjegjëse për ofrimin e programeve të studimit. Departamenti i Administrimit Publik (DAP), është njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programin të studimit MSh_PAAP (<i>Rregullorja e FShPJ, Kreu II, neni 9</i>).</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore dhe njësisë bazë që janë përgjegjëse për realizimin e këtij programi studimi. GVJ konfirmon se programi i studimit, MSh_PAAP është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 1. Statuti i UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 34,35. Kodifikimi i programeve të studimit UAMD;</i></p> <p><i>Aneks 60. Kurrikula e programit studimit MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mësimor i programit studimit MSh_PAAP.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit,</p>	<p><i>Ky kriter nuk aplikohet pasi programi i studimit MSh_PAAP, ofrohet plotësisht në përputhje me profilin e institucionit dhe njësive përbërëse të tij.</i></p>




cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>GVJ konstaton se në Statutin dhe rregulloren e institucionit është formuluar si një ndër qëllimet e UAMD, se gjatë periudhës së kryerjes së studimeve të promovohet, Politika e Punësimit të studentëve. Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve të realizuara me GVB, P/Dep., dhe përfaqësues të Sektorit të Komunikimit, Alumni dhe Karrierës (SKAK), u konfirmua se kjo zyrë, ofron këshillime, seminare dhe informacion mbi zhvillimin e karrierës së tyre profesionale pas përfundimit të studimeve dhe orientimin drejt tregut të punës.</p> <p>Referuar rregullores së Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës (neni 4), ky sektor synon t'i ndihmojë studentët të qartësojnë qëllimet akademike dhe të karrierës, të krijojnë plane të karrierës, të zhvillojnë aftësitë e kërkimit të punës dhe të bëjnë një kalim të suksesshëm nga universiteti drejt tregut të punës, ndërtimin e marrëdhënieve me studentë, Alumni, punëdhënës dhe institucione për të lehtësuar praktika studentore, punësim dhe mundësi karriere. <i>GVJ konfirmon, se nuk gjeti ndonjë dokumentacion që evidenton ofrimin e trajnimeve profesionale të mëtejshme nga institucioni për studentët e diplomuar në programin e studimit MSh_PAAP, në bashkërendim me punëdhënësit.</i></p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 1. Statuti i UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 21. Rregullore e SKAK.</i></p>
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ, pasi shqyrtoi fushën e veprimtarisë së UAMD-së, njesisë kryesore Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike (FShPJ) dhe njesisë bazë Departamentit të Administrimit Publik (DAP) që janë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në "Politika dhe Administrim, me profil: Administrim Publik", gjykoi se ky program studimi është në përputhje të plotë me</i></p>




	<p><i>fushën e veprimtarisë së këtyre njësive, sic janë të formuluar në dokumentet bazë të Institucionit.</i></p> <p><i>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore dhe njësisë bazë. FShPJ dhe DAP, dëshmojnë se kanë kapacitetet dhe burimet e nevojshme akademike, mësimdhënëse dhe shkencore për të ofruar këtë program studimi. GVJ konfirmon përmbushjen plotësisht të këtij standardi.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi I.3

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, (<i>Statutin e Institucionit dhe rregulloret përkatëse</i>), GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit, njësia kryesore dhe njësia bazë, koordinojnë dhe bashkëpunojnë për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive midis personelit të angazhuar në veprimtarinë akademike dhe administrative.</p> <p>Institucioni ka hartuar rregullore të funksionimit të njësive kryesore dhe bazë, ku detajohet çdo aspekt i nevojshëm si detyrat, rolet, funksionet e personelit, analiza e punës së kryer prej tyre etj. Strategjia dhe drejtimi i veprimtarisë së njësisë kryesore, bazohen në bashkëpunimin midis 3 (tre) departamenteve. Gjithashtu për mbarëvajtjen e procesit mësimor, përgjegjëse janë dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, Sektori i Komunikimit, Alumni dhe Karrierës, Sekretaria Mësimore, etj. Në rregulloren e DAP (Kreu II, nenet 9-18) dhe programit të studimit, MSH_PAAP (Kreu II, nenet 10, 11, 12), janë të përcaktuara, funksionet dhe detyrat e njësisë bazë, përgjegjësit të</p>




	<p>Dep., përgjegjësve të grupeve mësimore kërkimore-shkencore, koordinatorit të programit dhe stafit akademik.</p> <p>Këto njësi bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme lidhur me procesin e mesimdhënies dhe kërkimit shkencor dhe gjithë ky proces realizohet në mënyrë të koordinuar nga të gjitha hallkat dhe strukturat (përgjegjëse, drejtuese dhe mbështetëse). Njësia kryesore dhe njësia bazë, çdo vit kryejnë analizën e punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të cilat janë të depozituara dhe në DVV. Në gjykimin e GVJ, ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 1. Statuti i UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 41. Organigrama e UAMD-së.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqërues (<i>Aneksi 72. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>), GVJ konstatoi se për realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe përgatitjen profesionale të studentëve, UAMD dhe FShPJ, kanë nënshkruar një sërë marrëveshje me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Një bashkëpunim të gjerë UAMD, ka me institucione publike, dhe aktorë të tjerë në vend, ku palët angazhohen për shkëmbim eksperience dhe ekspertizë në funksion të përmirësimit të procesit mësimor dhe realizimit të objektivave të programeve të studimit si dhe për tu dhënë mundësi studentëve të zhvillojnë praktikat profesionale. Në dokumentacion shoqërues të DVV, gjenden të listuara marrëveshjet e bashkëpunimit midis UAMD-së me IAL brenda dhe jashtë vendit si dhe institucione partnere, të cilat u konfirmuan edhe gjatë vizitës së GVJ në institucion.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentave në DVV (<i>Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>), GVJ konstatoi se UAMD një numër të konsiderueshëm marrëveshje bashkëpunimi me Universitete ndërkombëtare në kuadrin e kërkimit shkencor dhe marrëveshjeve së mobiliteteve Erasmus +.</p>




<p>kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në funksion të realizimit të praktikave profesionale për studentët me qëllim plotësimin e objektivave të programit mësimor, UAMD bashkëpunon gjithashtu dhe me një sërë institucione publike, dhe jopublike në vend si dhe aktorë të tjerë si, (Kuvendi i Shqipërisë, KLSH, Këshillit të Qarkut, Durrës, Autoriteti Portual Durrës, Dhoma e Tregtisë, etj.) Procedurat e zhvillimit të praktikës profesionale, janë të përcaktuara dhe në Udhëzimin e Praktikës Mësimore.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 71. Lista e marrëveshjeve me IAL jashtë vendit;</i></p> <p><i>Aneks 72. Lista e marrëveshjeve me IAL&amp;institucione partnere.</i></p> <p><i>Aneks 105. Udhëzim për praktikën mësimore dhe përgatitjen e mikrotezës.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi me P/Departamentit, GVB dhe stafin akademik si dhe verifikimi i dokumentacionit në DVV u konstatua se, Departamenti në mënyrë periodike në fund të vitit, bën analizën e punës mësimore dhe kërkimore shkencore, ku përfshihen edhe rezultatet konkrete të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet publike dhe aktorë të tjerë, në funksion të realizimit të programit të studimit. Gjithashtu referuar të dhënave të RVB për këtë kriter dhe buletinit të aktiviteteve për vitin akademik 2021-2022, si rezultat i marrëveshjeve të bashkëpunimit, departamenti si njësi bazë për këtë program studimi, organizon takime informuese për studentët, workshope, leksione të hapura me specialistë dhe ekspertë fushës, me qëllim angazhimin e studentëve.</p> <p>Nga takimi me P/Dep. dhe stafin akademik u konfirmua se departamenti, merr në konsideratë sugjerimet dhe propozimet e specialistëve dhe ekspertëve të fushës në funksion të përmirësimit dhe realizimit të objektivave të programit të studimit. Njësia kryesore dhe njësia bazë si njësi përgjegjëse për programin e studimit, çdo vit kryejnë analizën e punës mësimore, kërkimore dhe shkencore, pjesë e cilës janë dhe aktivitetet e</p>




	<p>kryera me institucionet partnere, si rezultat i marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 95. Raporti vjetor_DAP_FShPJ_2020-2021;</i></p> <p><i>Aneks 130, 131,132. Raporti vjetor_FShPJ_2019-2020;2020-2021;2021-2022;</i></p> <p><i>Aneks 51. Buletini i aktiviteteve dhe kërkimit shkencor 2021-2022_FShPJ.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, (Statutin e Institucionit dhe rregulloret përkatëse), GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit, njësia kryesore dhe njësia bazë, bashkëpunojnë për veprimtarinë akademike dhe administrative në funksion të realizimit të këtij program studimi. Në rregulloret e njesisë kryesore/bazë dhe programit të studimit, janë të përcaktuara, funksionet dhe detyrat e përgjegjësit të Dep, përgj. të grupeve mësimore kërkimore-shkencore, koordinatorit të programit dhe stafit akademik. Këto njësi bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme lidhur me procesin mësimor dhe atë të kërkimit shkencor.</i></p> <p><i>GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ konstatoi se, UAMD dhe FShPJ, kanë nënshkruar një sërë marrëveshje me IAL brenda dhe jashtë vendit, me institucione publike dhe jo publike, si dhe aktorë të tjerë në vend, në funksion të realizimit të procesit mësimor, kryerjes së praktikave profesionale për studentët, kërkimit shkencor dhe përmbushjes së objektivave të programit studimit. GVJ konfirmon përmbushjen plotësisht të këtij standardi.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>







Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË


Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, rregullores së UAMD-së, njësisë kryesore/bazë, rregullores së programit të studimit, kurrikulës dhe planit mësimor, GVJ konstaton se, Programi i Studimit Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik”, është i organizuar në lëndë/module, të detyrueshme dhe me zgjedhje të ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) dhe të vlerësuara me kredite mësimore sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Ky program studimi zgjat dy vite akademike, i organizuar në 4 semestra dhe ka në total 120 ECTS dhe është në përputhje me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë Nr. 80/2015 dhe rregulloren e programit të studimit (Kreu II, neni 16,17). GVJ konstaton se disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në programin e studimit janë të organizuara në 5 kategori, nga A në E, në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr. 185/2021. Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, C, D dhe E janë të ndërthurura, të detyrueshme dhe me lëndë me zgjedhje, të vlerësuara secila me kreditet përkatëse.</p> <p>Në hartimin e kurrikulës dhe planit mësimor të programit të studimit janë ruajtur raportet e shpërndarjes së krediteve sipas kategorisë së disiplinave përkatëse:</p>




- Në kategorinë A, bëjnë pjesë lëndët bazë dhe disiplina të formimit të përgjithshëm, (2 lëndë me 10% të krediteve);
- Në kategorinë B, janë lëndët karakterizuese, përfshihen disiplina të formimit karakterizues të programit, (10 lëndë me 50% të krediteve);
- Në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore dhe integruese, (3 lëndë me 15% të krediteve);
- Në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuese, (praktika profesionale, me 10% të krediteve),
- Në kategorinë E janë detyrimet përmbyllëse për diplomim, (mikroteza, me 15% të krediteve).

Kreditet janë përcaktuar për çdo lëndë bazuar në ngarkesën mësimore në auditor si dhe në punën individuale të studentit, për përmbushjen e të gjitha detyrimeve. Referuar të dhënave të kurrikulës dhe planin mësimor, ky program studimi përfshin 15 module me një total prej 90 kredite, praktikën profesionale 12 kredite dhe mikroteza me 18 kredite. Programi i studimit është hartuar në përputhje me kërkesat e VKM Nr.41 të ndryshuar (shtojca I, VKM 185/2021), dhe kategorizimi i lëndëve është si më poshtë:


Kategoria	Komponenti mësimor	Kërkesat ligjore: Master i shkencave	MSh_PAAP Kredite
A	LËNDË BAZË – Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (2 lëndë)	5–10% (kredite)	12 (kredite) 10%
B	LËNDË KARAKTERIZUESE – Përgatitje për disiplinën shkencore (10 lëndë)	50–60% (kredite)	60 (kredite) 50%
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE – Nëndisiplina, profile dhe	12–20% (kredite)	18 (kredite) 15%


	grup-lëndë me zgjedhje (3 lëndë)		
D	LËNDË PLOTËSUESE – Gjuhë të huaja, njohuri informatike, (praktika profesionale)	10% (kredite)	12 (kredite) 10%
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE (Mikroteza)	10–15% (kredite)	18 (kredite) 15%
<p>Në total, 120 kredite për 2 vite akademike.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 60. Kurrikula e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit_MSh_PAAP.</i></p>			
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose	<p>Referuar, shqyrtimit të Rregullores së programit të studimit, Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik” (Kreu I, neni 7), objektivat formues specifike të programit ndër të tjera, janë që ti sigurojë studentëve, studime të thelluara dhe të avancuara në teorinë dhe në kërkimin shkencor në fushat e administrimit publik, shërbimeve dhe politikave në sektorin publik, për t’i pajisur me njohuritë e nevojshme akademike, kërkimore si dhe karrierë të sukseshme profesionale në të ardhmen.</p> <p>Programi i studimit MSh_PAAP, synon të përgatisë studentët: të analizojnë çështje konkrete të administrimit dhe qeverisjes në kontekstin teorik, praktik dhe analitik, të vlerësojnë problematikat dhe fenomenet sociale në kontekstin e rolit të qeverisë, të integrojnë të kuptuarit e zhvillimit të programit, vlerësimin dhe analizën në fokus të përmirësimit të politikave, shërbimeve dhe programeve publike, të kombinojnë metodat sasiore dhe cilësore në udhëheqjen</p>		




<p>profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>e një kërkimi shkencor, të veprojnë në mbështetje të interesit publik me standarde më të larta morale. Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit, GVJ konstaton se, ky program studimi përveç se përmban lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje, ofron mundësinë që studentët të profilizohen në fushën e administrimit publik, shërbimeve dhe politikave në sektorin publik duke ofruar module si; Administrim publik i avancuar, Menaxhimi i Organizatave Publike, Sjellje Organizative e Avancuar, Politika Publike të Avancuara, Shkenca Administrimi të Avancuara, Kontabilitet Publik i Avancuar, Etikë në Administrimin Publik, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore në Sektorin Publik, etj.</p> <p>Gjithashtu, syllabuset e këtij programi studimi tregojnë për një mbulim kryesisht të plotë të një larmie njohurish specifike në fushat e administrimit dhe menaxhimit në sektorin publik dhe profileve të lidhura me to, me një ndërthurje të njohurive teorike dhe koncepteve praktike, si dhe kërkimit shkencor duke përfshirë dhe lëndë si Metodatat Sasiore dhe Cilësore në Kërkimin Shkencor. Struktura dhe plani mësimor i këtij programi studimi, synojnë të përcjellin tek studentët njohuri teorike dhe praktike të kërkuara nga tregu i punës me qëllim aftësimin e tyre në profesionin përkatës. Kjo realizohet përmes njohurive të marra gjatë zhvillimit të leksioneve, seminareve, detyrave dhe projekteve të kursit, si dhe praktikave mësimore, duke harmonizuar njohuritë teorike me ato praktike për të inkurajuar dhe formuar tek studentët mendimin krijues dhe kritik si specialist të ardhshëm në sektorin publik. GVJ gjatë takimit me stafin dhe studentët e këtij programi, konfirmon se përmbajtja e syllabuseve të lëndëve, në perceptimin e stafit akademik dhe studentëve kishte mundur një kombinim të plotë mes njohurive teorike dhe atyre praktike. Studentët u shprehën të aftë për të përballuar probleme reale në punën e tyre në të ardhmen, kjo e konfirmuar dhe nga studentët që ishin të punësuar, duke bindur GVJ për cilësinë dhe thellësinë e njohurive të marra në programin e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqëruar të DVV, konstatohet se në kurrikulën dhe planin mësimor të programit të studimit është specifikuar qartë se realizimi i praktikës/stazhit tre mujor si lëndë e kategorisë D, dhe vlerësohet me 12 kredite (në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41 të ndryshuar me VKM nr. 879) dhe realizohet në semestrin e katërt të studimeve. Detyrimet përmbyllëse, për këtë program studimi i referohen përgatitjes së</p>





	<p>mikrotezës dhe mbrojtjes së diplomës, përfshihen në kategorinë E, dhe vlerësohen me 18 kredite (gjithashtu në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41 të ndryshuar me VKM nr. 879) dhe kryhet në semestrin e katërt të studimeve. GVJ konfirmon përmbushjen e këtij kriteri edhe nëpërmjet konfirmimit gjatë vizitës në Institucion.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 60. Kurrikula e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 115. Syllabuset e lëndëve të Programit të Studimit_MSh_PAAP.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p><i>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-</p>	<p><i>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi</i></p>




<p>pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>GVJ konstaton se ky program është hapur në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015 dhe se UAMD, nuk ka status të veçantë.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, planit mësimor dhe kurikulës së Programit të Studimit, Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim” me profil: “Administrim Publik”, GVJ konstaton se, përmbajtja e programit të studimit, struktura e tij, lëndët, shpërndarja e krediteve dhe ngarkesës mësimore janë të ngjashme me programe studimi me të njëjtin emër ose me emërtime të ngjashme të ofruar nga IAL të tjera në vendin tonë.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Sipas analizës së rregullore së programit të studimit, GVJ konfirmon se Programi i studimit MSh_PAAP, është program studimi i ciklit të dytë të studimit, referuar nivelit të 7 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (shtojca 1, VKM 185/2021); organizohet me 120 ECTS dhe kohëzgjatje normale dy vite akademike me kohë të plotë, i ofruar në gjuhën shqipe dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015. Sipas RVB për këtë kriter, referuar shkresës nr. 117/1, dt 08.02.2023 të rektorit të UAMD, kodi i programit të studimit është S72MS0413 në përputhje me VKM 310/2022.</p>




	<p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 60. Kurrikula e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 34. Shkresë MAS, për Kodifikimin e Programeve të Studimit_UAMD.</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Referuar Rregullore së UAMD (Kreu I, neni 51), përcaktohet se UAMD ose njësitë përbërëse të tij mund të realizojnë programe të përbashkëta me një ose më shumë institucione arsimore publike ose jo publike brenda ose jashtë vendit. Referuar, Rregullores së programit të studimit (Kreu IV), si dhe takimit të GVJ me dekanin e FShPJ, P/Dep., u konfirmua se për Programin e Studimit Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim” me profil: Administrim Publik”, është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Côte D’Azur, Nicë, Francë për ofrimin e një diplome të dyfishtë, për studentët e këtij program studimi.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 73.3. AS_DD_Master Droit Public_Univ Côte d’Azur_Univ DURRES.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konfirmon se Programi i Studimit, Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik”, është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe aktet rregullatore të institucionit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, rregullores së njësisë kryesore/bazë, rregullores së programit të studimit, kurrikulës dhe planit mësimor, GVJ konstaton se, programi i studimit MSh_PAAP, është i organizuar në lëndë/module, të detyrueshme dhe me zgjedhje, të ndara sipas veprimtarive formuese dhe të vlerësuara me kredite (ECTS). Ky program studimi zgjat dy vite akademike, i organizuar në 4 semestra dhe në total ka 120 kredite. Objektivat formues</i></p>




	<p><i>specifikë të programit ndër të tjera, janë që t'i ofrojë studentëve, studime të thelluara dhe të avancuara në fushat e administrimit dhe menaxhimit në sektorin publik. Referuar, Rregullores së programit të studimit, si dhe takimit të GVJ me dekanin e FShPJ, P/Dep., u konfirmua se për programin e studimit MSh_PAAP, është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Côte D'Azur, Nicë, Francë, për ofrimin e një diplome të dyfishtë për studentët e këtij program studimi. GVJ konfirmon përmbushjen e plotë të këtij standardi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Nga shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit në DVV (<i>Statutit, Rregulloreve përkatëse</i>) GVJ konstaton se, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës (UAMD), është institucion publik i arsimit të lartë, që ushtron veprimtari mësimore, kërkimore-shkencore dhe administrative. Ai është krijuar me VKM, Nr. 801, datë 20.12.2005 (<i>Statuti, neni 1</i>).</p> <p>Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimi, Master i Shkencave në "Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik", është Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike (FShPJ). Ky fakultet është hapur me VKM, Nr. 685, datë 25.08.2010 si një nga njësitë kryesore të UAMD-së. FShPJ për vitin akademik 2022-2023, ofron gjithsej 21 programe studimi: 5 (pesë) programe studimi në ciklin e parë të studimeve (Bachelor), 9 (nëntë) programe në ciklin e dytë të studimeve Master Profesional, dhe 6 (gjashtë) programe në ciklin e dytë, Master i Shkencave dhe 1 (një) në ciklin e dytë, Master i Shkencave (Integruar). Në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave të tij, FShPJ është i organizuar me një strukturë, në përputhje të plotë me kriteret e kërkuara sipas kuadrit ligjor në fuqi. Ky fakultet, ka në përbërjen e tij 3 (tre) njësi bazë:</p>









1. Departamentin e Administrimit Publik;
2. Departamentin e Drejtësisë;
3. Departamentin e Shkencave Politike;

Departamenti i Administrimit Publik, si njësi bazë për vitin akademik 2022-2023, ofron gjithsej 8 (tetë) programe studimi: 2 (dy) programe studimi në ciklin e parë të studimeve (Bachelor), 4 (katër) programe në ciklin e dytë të studimeve Master Profesional, 2 (dy) programe në ciklin e dytë Master i Shkencave. Programi i studimit, Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik” ofrohet nga Departamenti i Administrimit Publik, si njësi bazë për këtë program studimi. Ky program studimi është hapur me VKM, Nr. 1002, datë 30.09.2009. Ai është riorganizuar me Vendim Senati të UAMD, Nr. 122, datë 14.06.2018, miratuar nga MASR me shkresë Nr 7241/1, datë 31.08.2018; si dhe në vitin 2022, me Vendim Senati të UAMD, Nr. 24, datë 28.03.2022, konfirmuar nga MAS me shkresën Nr. 2085/1, datë 27.06.2022. Ky program studimi zgjat dy vite akademike, i organizuar në 4 semestra dhe ka në total 120 ECTS, në përputhje me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë Nr. 80/2015, Statutin e UAMD-së, Rregulloren e UAMD-së, FSHPJ, dhe rregulloren e programit të studimit (Kreu II, neni 16). Referuar, rregullores së UAMD-së, FShPJ dhe rregullores së departamentit (nenit, 15, pika 1), Departamenti në përputhje me fushat kërkimore shkencore, disiplinat, profilet, ciklet e studimit, propozon grupet mësimore- kërkimore. Departamenti është i organizuar në 2 (dy) grupe mësimore, kërkimore-shkencore. Të dhënat për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik (PAE dhe PAK), për njësinë bazë përgjegjëse (DAP), për programin e studimit, MSh\_PAAP, sipas viteve akademike, paraqiten si më poshtë:

Kualifikimi i stafit akademik për DAP	2022-2023		2021-2022		2020-2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	1	1	2	1	2
Prof. Asoc.	2	3	2	3	2	4
Dr./PhD.	10	3	8	5	9	7
MSc.	1	10	3	5	3	15




<b>Totali</b>	<b>14</b>	<b>17</b>	<b>14</b>	<b>15</b>	<b>15</b>	<b>28</b>	
<p>Për sa i përket kualifikimeve të Personelit Akademik në tre vite akademike është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Për vitin akademik 2020-2021, <b>58.14%</b> e stafit akademik (PAE&amp;PAK) kanë gradë shkencore/tituj akademik, <b>41.86%</b> janë me MSc;</li> <li>▪ Për vitin akademik 2021-2022, <b>72.41%</b> e stafit akademik (PAE&amp;PAK) kanë gradë shkencore/tituj akademik, <b>27.59%</b> janë me MSc;</li> <li>▪ Për vitin akademik 2022-2023, <b>64.52%</b> e stafit akademik (PAE&amp;PAK) kanë gradë shkencore/tituj akademik, <b>35.48%</b> janë me MSc.</li> </ul> <p>Të dhënat për raportet numerike midis personelit akademik efektiv (PAE) dhe personelit akademik me kontratë (PAK) janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Për vitin akademik 2020-2021, është në raportin <b>15/28 ose 34.9% me 65.1%</b>.</li> <li>▪ Për vitin akademik 2021-2022, është në raportin <b>14/15 ose 48.3% me 51.7%</b>.</li> <li>▪ Për vitin akademik 2022-2023, është në raportin <b>14/17 ose 45.2% me 54.8%</b>.</li> </ul> <p>Të dhënat për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik (PAE dhe PAK), të DAP, përgjegjës për programin e studimit, MSh_PAAP, sipas viteve akademike, paraqiten si më poshtë:</p>							
Kualifikimi i stafit akademik për Programin e Studimit: MSh_PAAP	<b>2022-2023</b>		<b>2021-2022</b>		<b>2020-2021</b>		
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	
	Prof.Dr.	2	1	1	1	1	
	Prof. Asoc.	3	1	3	1	2	1
	Dr./PhD.	5	0	5	1	6	1

	MSc.	0	1	0	0	0	0
	<b>Totali</b>	<b>10</b>	<b>3</b>	<b>9</b>	<b>3</b>	<b>9</b>	<b>3</b>

Të dhënat për raportet numerike midis personelit akademik efektiv (PAE) dhe personelit akademik me kontratë (PAK) janë:

- Për vitin akademik 2020-2021, është në raportin 9/3 ose 75% me 25%.
- Për vitin akademik 2021-2022, është në raportin 9/3 ose 75% me 25%.
- Për vitin akademik 2022-2023, është në raportin 10/3 ose 77% me 23%.

Për sa i përket kualifikimeve të Personelit Akademik, për vitin akademik 2022-2023 rezultojnë se 92% e stafit akademik (PAE&PAK) kanë gradë shkencore/tituj akademik, dhe 8% janë me MSc.

Referuar shqyrtimit të CV-ve të stafit akademik, GVJ konstaton se fusha akademike-kërkimore e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve ku japin mësim. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, është i kualifikuar, me eksperiencë akademike, dhe profesionistë në fushën e administrimit dhe menaxhimit në sektorin publik. GVJ konfirmon përmbushjen e këtij kriteri.

**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjisllacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Referuar Statutit të UAMD, (Kreu II, neni 10, pika 3), citohet se Departamenti si njësi bazë e Institucionit mund të ketë në përbërje edhe personel ndihmës akademik. Në rregulloren e FShPJ dhe DAP (neni 22) citohet se personeli ndihmës akademik me karakter administrativ, ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe /ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të universitetit në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional.


Në kategorinë e personelit ndihmës akademik me karakter administrativ përfshihet punonjësja e sekretarisë e cila krijon, ruan, administron dhe shërben dokumentacionin e procesit mësimor. Në RVB për këtë kriter, citohet se departamenti, disponon një laborator për zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të RVB, dhe të




	<p>dhënave për personelin akademik dhe ndihmës akademik, GVJ konstaton se njësia bazë ka të angazhuar personel ndihmës akademik/administrativ, që ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive akademike në funksion të programit të studimit. GVJ konfirmon, përmbushjen e këtij kriteri.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues (<i>Rregullores së UAMD-së, FShPJ, dhe rregullores një njësisë bazë, neni 17</i>) si dhe në takimin e realizuar me GVB dhe P/Dep dhe u konfirmua se, njësia kryesore dhe njësitë bazë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore, për realizimin sa më mirë të objektivave si dhe për mbarëvajtjen e procesit mësimor kanë emëruar një personel akademik në rolin e koordinatorit për çdo program studimi. Referuar urdhërit të dekanit të FShPJ me nr. 121, datë 15.11.2018, “Për emërimin e koordinatorëve për çdo program studimi”, për programin e studimeve Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik”, koordinator është përgjegjësi i departamentit. Ai koordinon, mbikqyrë punën për përgatitjen e dokumentacionit mësimor; programeve të lëndëve (syllabuset), praktikës profesionale dhe udhëzimeve për përgatitjen e mikrotezës; kujdeset për implementimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara të procesit mësimor, mbështet studentët gjatë kryerjes së praktikave profesionale, monitoron ecurinë dhe vlerësimin e brendshëm të programit të studimit. Koordinatori, bashkëpunon me strukturat e tjera përgjegjëse, p/grupeve mësimore, stafin akademik, për mbarëvajtjen e zhvillimit të procesit mësimor, në përputhje me objektivat e programit të studimit. GVJ konfirmon, përmbushjen e plotë të këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 1. Statuti i UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 60. Kurrikula e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p>





	<p><i>Tabela 1. Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat_DAP_FShPJ;</i></p> <p><i>Tabela 2. Të dhëna për personelin akademik dhe ndihmës akademik për Departamentin e Administrimit Publik;</i></p> <p><i>Tabela 3. Të dhëna për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve, që ofrohen në njësinë kryesore&amp;bazë përgjegjëse_FShPJ;</i></p> <p><i>Tabela 6. Të dhëna për personelin akademik të DAP, përgjegjës për Programin e Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 99. Tabela për personelin akademik të Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 78. Shkresa për grupet mësimore, kërkimore-shkencore_DAP_FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 98.Urdhër për emërimin e koordinatoreve për çdo program studimi_FShPJ.</i></p> <p><i>Aneks 114.CV e stafit akademik_DAP_FSHPJ;</i></p> <p><a href="https://uamd.edu.al/fakulteti-i-shkencave-politike-juridike/">https://uamd.edu.al/fakulteti-i-shkencave-politike-juridike/</a>; <a href="https://uamd.edu.al/departamenti-i-administrimit-publik/">https://uamd.edu.al/departamenti-i-administrimit-publik/</a>.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV si edhe konfirmimet e marra gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmon se, njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, MSh_PAAP, Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike (FShPJ) dhe njësia bazë Departamenti i Administrimit Publik (DAP) janë të organizuara në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. FShPJ, ka në përbërjen e tij 3 (tre) njësi bazë/departamente. Programi i studimit, Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik” ofrohet nga Departamenti i Administrimit Publik, si njësi bazë/përgjegjëse për këtë program studimi. Stafit akademik i angazhuar në këtë program studimi, është i kualifikuar dhe me eksperiencë akademike, në fushën e administrimit dhe menaxhimit publik. Njësia bazë ka të angazhuar personel ndihmës akademik/administrativ, që ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive akademike në funksion të programit të studimit. Për programin e studimeve Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik”, koordinator është përgjegjësi i departamentit. GVJ konfirmon përmbushjen plotësisht të këtij standardi.</i></p>




Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ, shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar në DVV (Rregulloren e Njesisë Kryesore; Rregulloren e Njesisë Bazë; Rregulloren e Programit të Studimit, Plani Mësimor i Programit të Studimit, etj.) dhe konstatoi se, informacionet për elementët e rëndësishëm të programit të studimit MSh_PAAP, disponohen nga Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike, (njësia kryesore), dhe Departamenti i Administrimit Publik (njësia bazë). Këto informacione janë publike dhe të mundshme për t'u aksesuar lirisht. <i>GVJ konfirmoi publikimin e përbajtjes së programit të studimit dhe informacione të tjera rreth tij edhe në faqen e internetit/website-n e institucionit në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.</i></p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 60. Kurrikula e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i><a href="https://uamd.edu.al/">https://uamd.edu.al/</a>;</i></p> <p><i><a href="https://uamd.edu.al/fakulteti-i-shkencave-politike-juridike/">https://uamd.edu.al/fakulteti-i-shkencave-politike-juridike/</a>;</i></p> <p><i><a href="https://uamd.edu.al/departamenti-i-administrimit-publik/">https://uamd.edu.al/departamenti-i-administrimit-publik/</a>.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ konstatoi se elementët e rëndësishëm të programit të studimit janë parashtruar në Rregulloren e Programit të Studimit. Sipas kësaj rregulloreje (nenet 13-18), ky program është i organizuar me 120 ECTS, në katër semestra dhe realizohet në dy vite akademike me 60 kredite</p>




<p>semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>në çdo vit. Plani mësimor, përbën dokumentacionin kryesor dhe përfshin elementët e mëposhtëm në përputhje me kriteret e VKM Nr.41, datë 24.01.2018, ndryshuar me VKM nr.879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185, datë 25.3.2021:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Emërtimin për secilin modul të këtij programi studimi, të grupuara dhe të renditura sipas semestrave përkatës;</li> <li>2. Numrin e krediteve për çdo modul;</li> <li>3. Orët në total për secilin modul dhe raportin e orëve (leksione/seminare);</li> <li>4. Detyrimet për secilin modul (leksione; seminare, ushtrime, detyra kursi, projekte kursi, raste studimore, etj.);</li> <li>5. Numrin e orëve për punë individuale.</li> </ol> <p>Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike dhe përfshin (leksione, seminare, ushtrime, projekte/detyra kursi, praktikën profesionale dhe mikrotezën/tema e diplomës). Rregullat për frekuentimin dhe procedurat e vlerësimit të studentëve janë të detajuara në syllabuset e secilës lëndë, duke u bazuar në Rregulloren e FShPJ, DAP dhe Rregulloren e Programit të Studimit (neni 13), përfshijnë (provimin e ndërmjetëm, aktivizimi në seminare, projekte/detyra kursi dhe provimin përfundimtar). Sipas nenit 13 të rregullores së programit të studimit studenti është i detyruar të frekuentojë orët mësimore në masën 75%. Për programin e studimit MSh_PAAP, referuar planit mësimor, parashikohet që në semestrin e katërt të kryhet praktika profesionale dhe përgatitja e mikrotezës/temës diplomës.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVI konstaton se kriteret e përgjithshme të pranimit në programin e studimit MSh_PAAP, të transferimeve dhe ekuivalentimit të studimeve janë të përcaktuara në (<i>Rregulloren e UAMD-së, neni 56; Rregulloren e Njesisë Kryesore, neni 42 dhe Rregulloren e Njesisë Bazë, neni 44</i>). Në nenin 44 të rregullores së njësive bazë, citohet se DAP, ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve për të gjithë ata që gëzojnë statusin e studentit, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda tij, apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet, merret nga komisioni ad-hoc përkatës, i ngritur nga njësia bazë (<i>Dok, Aneks</i></p>




	<p><i>121.Procedurat për transferimin e studentëve_DAP)</i>  Dokumentat që duhet të dorëzohen nga studentët për të garantuar një proces ekuivalentimi sa më të plotë dhe transparent, përshkruhen me hollësi në Rregulloren e DAP.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 60. Kurrikula e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 121. Praktikë për transferimin e studentëve_DAP_FShPJ.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Për të analizuar këtë kriter, GVJ ka shqyrtuar, (Rregulloren e UAMD-së, neni 62, Rregulloren e FShPJ neni 48, Planin Mësimor), por edhe syllabuset e lëndëve përkatëse të programit të studimit MSh_PAAP të cilat janë pjesë e DVV. Referuar të dhënave në aneksin 115 (<i>Syllabuset e lëndëve</i>), GVJ konstaton se syllabusi i çdo lënde përmban informacionet e nevojshme të detajuara, si: titulli i lëndës, titullari, ngarkesa në orë dhe kredite, tipologjia e lëndës (kategoria), viti dhe semestri kur zhvillohet lënda, lloji i lëndës, programi i studimit të cilit i përket, temat e lëndës, mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve të lëndës.</p> <p>Komponentët formues të programit në përgjithësi janë konform formateve të kërkuara sipas VKM Nr.41, datë 24.01.2018, ndryshuar me VKM nr.879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185, datë 25.3.2021. Rregullat për frekuentimin dhe procedurat e vlerësimit të studentëve janë të detajuara në syllabuset e secilës lëndë, duke u bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit (neni 20), përfshijnë (provimin e ndërmjetëm, aktivizimi në seminare, projekte/detyra kursi dhe provimin përfundimtar). Sipas nenit 13 të rregullores së programit të studimit studenti është i detyruar të frekuentojë orët teorike dhe praktike në masën 75%. Nota përfundimtare e studentit është rezultante e elementëve të vlerësimit të vazhduar dhe provimit përfundimtar. Përqindja e rëndësisë për çdo komponent vlerësimi është e përcaktuar në çdo syllabus, konform rregullores së programit të studimit. Kjo procedure u konfirmua edhe gjatë takimit të GVJ me stafin akademik dhe P/Dep, gjatë vizitës në institucion.</p>






<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>GVJ konfirmon se programi i studimit mund të rishikohet me kërkesë të njësisë bazë që ofron programin si rezultat i kërkesave të tregut të punës, dinamikave të brendshme, por edhe me kërkesë të secilit pedagog. Riorganizimi mund të parashikojë bashkime të lëndëve apo ndarje të tyre, pa cënuar raportet e përcaktuara për secilën kategori disiplinash në programin e studimit. Njësia bazë ka të drejtën të propozojë ndryshime deri në masën 20% të krediteve të programit duke krijuar edhe profile. Këto propozime shqyrtohen nga dekanati dhe miratohen nga Senati akademik. Referuar të dhënave në DVV, programi i studimit MSh_PAAP është riorganizuar në vitin 2018, për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për Arsimin e Lartë, si dhe është riorganizuar deri në masën 20 % në vitin 2022 në përputhje me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë Nr. 80/2015.</p> <p>GVJ konstaton ndryshimet e Planit Mësimor të cilat konsistojnë kryesisht në ndryshim dhe sistemim të krediteve, përveç një ndryshimi të lëndës dhe në gjykimin e GVJ janë në drejtim të përmirësimit të përmbajtjes dhe organizimit të programit të studimit. GVJ gjithashtu konstatoi ruajtjen e materialeve të lidhura me programin e studimit edhe në gjuhën angleze. Gjatë takimeve me stafin akademik në lidhje me praktikën e përmirësimit të përmbajtjes dhe organizimit të programit të studimit, konfirmohet angazhimi i vazhdueshëm të stafit në këtë drejtim. Gjithashtu, GVJ u informua nga stafi akademik se në çdo fillim viti, bën rishikime të vazhdueshme të lëndëve apo moduleve, në drejtim të përditësimit të literaturës dhe përmbajtjes së tyre.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 60. Kurrikula e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 115. Syllabuset e lëndëve të Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p>
--	--




	<p><i>Aneks 84. Shkresë e MASR për riorganizimin e Programit të Studimit_UAMD_MSh_PAAP_2018.</i></p> <p><i>Aneks 83. Shkresë e MAS për riorganizimin e Programit të Studimit_UAMD_MSh_PAAP_2022.</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit në DVV (Rregulloreve përkatëse, Plani Mësimor dhe Programeve të Lëndëve), GVJ konfirmon se ky program studimi, është organizuar në përputhje me parashikimet ligjore për ciklin e dytë të studimeve sipas Kornizës 7 të KSHK.</i></p> <p><i>Bazuar në rregulloren e Programit të Studimit, ky program është i organizuar me 120 kredite/ECTS, në katër semestra dhe realizohet në dy vite akademike. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike e cila përfshin (leksione, seminare, ushtrime, projekte dhe detyra kursi, praktikën profesionale dhe temën e diplomës).</i></p> <p><i>Kriteret e përgjithshme të pranimit dhe regjistrimit në programin e studimit MSh_PAAP, të transferimeve dhe ekuivalentimit të studimeve, janë të përcaktuara në rregulloret përkatëse të institucionit. Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me vazhdueshëm në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloret e institucionit. GVJ konfirmon përmbushjen plotësisht të këtij standardi.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të</b>	Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të programit të studimit dhe përmbajtjes të syllabuseve të disiplinave të veçanta, GVJ mund të konfirmojë se programi i studimit përfshin një kategori lëndësh të formimit të nevojshëm profesional dhe njohuri në disiplina të lidhura me administrimin publik, menaxhimin e organizatave publike, politikat publike, kontabilitetin publik, etikën në




<p>mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>administrimin publik, menaxhimin e burimeve njerëzore në sektorin publik, etj. Gjithashtu edhe syllabuset e këtij programi studimi tregojnë për një mbulim kryesisht të plotë të një larmie njohurish specifike në fushat e administrimit dhe menaxhimit në sektorin publik, me një ndërthurje të njohurive teorike dhe koncepteve praktike, si dhe kërkimit shkencor duke përfshirë dhe lëndë si metodat sasiore dhe cilësore në kërkimin shkencor.</p> <p>Struktura dhe plani mësimor i këtij program studimi, në gjykimin e GVJ, synojnë të përcjellin tek studentët formimin teorik dhe praktik të nevojshëm të studentëve në funksion të punësimit të tyre, por edhe në vazhdimësinë e mëtejshme të studimeve. Kjo u konfirmua edhe gjatë takimit të GVJ me studentët e këtij program studimi, ku një numër i konsiderueshëm i tyre, ishin të punësuar në sektorin publik.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Objektivat formues specifikë të programit të studimit janë të listuara në rregulloren e programit të studimit, Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik” (Kreu I, neni 7), objektivat formues specifikë të programit ndër të tjera, janë që ti sigurojë studentëve, studime të thelluara dhe të avancuara në teorinë dhe në kërkimin shkencor në fushat e administrimit publik, shërbimeve dhe politikave në sektorin publik, për t’i pajisur me njohuritë e nevojshme akademike, kërkimore si dhe karrierë të sukseshme profesionale në të ardhmen. Kurrikula dhe plani mësimor është i strukturuar në mënyrë të tillë; duke i ndarë lëndët në: lëndë të formimit bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/integruese, lëndë me zgjedhje, lëndë plotësuese (praktika profesionale) si dhe detyrimet përmbyllëse (përgatitja e mikrotezës). Referuar shqyrtimit të kurikulës dhe planit mësimor, ky program studimi realizohet përmes <b>15 moduleve/lëndëve të cilat kanë nga 6 kredite, praktika profesionale 12 kredite dhe mikroteza 18 kredite.</b> Përmbajtja dhe struktura e lëndëve të këtij programi studimi si dhe kryerja e praktikës profesionale për një periudhë jo më pak se 2 (dy) muaj u ofrojnë mundësi studentëve që të marrin njohuri të thelluara teorike si dhe aftësi praktike të pavarura për kërkimin shkencor. Nga shqyrtimi i shpërndarjes së lëndëve në vite e semestra dhe nga organizimi i tyre, GVJ formoi bindjen se, kurrikula dhe plani mësimor mundëson arritjen e objektivave formues të programit studimit.</p>




<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Grupi i vlersuesve të jashtëm pasi shqyrtoi dokumentacionin në DVV, kurrikulën dhe planin mësimor, konfirmon se struktura e programit të studimit MSh_PAAP, programet e lëndëve të përfshira në të dhe raporti i zhvillimit të mësimit midis teorisë dhe praktikës mësimore janë në përshtatje me drejtimin dhe profilin në fushën e administrimit në sektorin publik. Gjatë vizitës të GVJ në institucion, studentët u shprehën se përmbajtja e lëndëve dhe njohuritë fituara nga ky program studimi i bënë të sigurt për të përballuar kërkesat e tregut të punës. Gjithashtu, në dijeninë e GVJ, kurrikula dhe plani mësimor, në këtë program studimi, emërtimi i lëndëve, përmbajtja e tyre si dhe ngarkesa mësimore, paraqitet e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 60. Kurrikula e Programit të Studimit MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 115. Syllabuset e lëndëve të Programit të Studimit MSh_PAAP.</i></p>												
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, struktura dhe plani mësimor i këtij program studimi, në gjykimin e GVJ, synojnë të përcjellin tek studentët formimin teorik dhe praktik të nevojshëm të studentëve në funksion të punësimit të tyre, por edhe për vazhdimësinë e mëtejshme të studimeve. Struktura e programit MSh_PAAP, referuar të dhënave në planin mësimor (lidhur me veprimtaritë formuese, ngarkesa totale në auditor dhe punë individuale) paraqiten në si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="603 1720 1378 1935"> <thead> <tr> <th>Nr</th> <th>Emërtimi i vep. formuese</th> <th>Ngarkesa/orë</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Leksione</td> <td>480 orë</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Seminare, ushtrime</td> <td>240 orë</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Aktivitete të tjera, projekte/detyra kursi</td> <td>180 orë</td> </tr> </tbody> </table>	Nr	Emërtimi i vep. formuese	Ngarkesa/orë	1	Leksione	480 orë	2	Seminare, ushtrime	240 orë	3	Aktivitete të tjera, projekte/detyra kursi	180 orë
Nr	Emërtimi i vep. formuese	Ngarkesa/orë											
1	Leksione	480 orë											
2	Seminare, ushtrime	240 orë											
3	Aktivitete të tjera, projekte/detyra kursi	180 orë											

4	Praktikë profesionale	300 orë
5	Mikroteza/tema e diplomës	450 orë
6	Punë individuale	1.350 orë
*	<b>Totali</b>	<b>3.000 orë</b>

Këto raporte sigurojnë një ndërthurje të njohurive teorike dhe koncepteve praktike, (leksione, seminare, ushtrime, projekte, detyra kursi, praktika profesionale dhe përgatitja e mikrotezës/diplomës), u mundëson studentëve të formohen nga ana profesionale, të zgjerojnë njohuritë e tyre kërkimore-shkencore dhe të arrijnë objektivat e të nxënimit në këtë program studimi duke garantuar punësimin e tyre në tregun e punës. Referuar anketës së kryer nga DAP në vitin akademik, 2020-2021, lidhur me opinionin dhe propozimin e studentëve për programet e studimit, studentët propozojnë për një rishikim të raportit të mësimin, ndërmjet orëve teorike dhe orëve praktike.

Në dijeninë e GVJ duke qenë se kjo shpërndarje e veprimtarive formuese është e ngjashme edhe me programe të tjera studimi me të njëjtën fushë apo fokus, bën të mundur transferimin e studimeve dhe lehtësimin e kryerjes së mobilitetit të studentëve në universitete të tjera jashtë vendit. Gjatë takimit të GVJ me P/Dep, u konfirmua se për këtë program studimi, është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Côte D'Azur, Nicë, Francë për ofrimin e diplomës së dyfishtë, për studentët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në marrëveshje.

*Referenca:*

*Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;*

*Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;*

*Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit\_MSh\_PAAP;*

*Aneks 60. Kurrikula e Programit të Studimit\_MSh\_PAAP;*

*Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit\_MSh\_PAAP;*

*Aneks 87. Anketë me studentet\_PS\_MSh\_AF\_2020-2021.*

*Aneks 70. Database\_Erasmus Staf akademik&Studente\_DAP\_FShPJ.*

	<i>Aneks 73.3. AS DD_Master Droit Public_Univ Côte d'Azur_Univ DURRES.</i>
<b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Referuar dokumentacionit shoqërues në DVV si dhe në takimin e realizuar me Përgjegjësin e Departamentit dhe stafin akademik që zhvillojnë mësim në këtë program studimi, u konfirmua se syllabuset përditësohen në mënyrë periodike. Literatura bazë dhe ndihmëse ishte kryesisht e viteve të fundit, nga autorët më të njohur në vend në fushën e administrimit dhe menaxhimit në sektorin publik. Nga shqyrtimi më i detajuar që GVJ i bëri përmbajtjes së dosjes së syllabuseve, u konstatua se ato në përgjithësi, garantojnë marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme nga studentët në përshtatje me kërkesat e tregut të punës.
<b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Në gjykimin e GVJ dhe mbështetur në njohurinë dhe formimin e tyre, përmbajtja e programit të studimit MSh_PAAP dhe elementët e tij garantojnë plotësisht përfitimin e dijeve dhe aftësive nga ana e studentëve të kompetencave të synuara siç edhe janë formuluar në Rregulloren e programit të studimit. Lëndët e ofruara në program garantojnë që studentët të mund të marrin njohuri të thelluara teorike dhe praktike në fushën e administrimit dhe menaxhimit në sektorin publik. Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, në gjykimin e GVJ, synojnë të përcjellin tek studentët formimin teorik dhe praktik të nevojshëm në funksion të punësimit të tyre si specialistë të aftë në administratën publike, por edhe të garantoj vazhdimësinë e mëtejshme të karrierës së tyre profesionale.
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Nga analiza e përmbajtjes së programit të studimit MSh_PAAP pranë FShPJ, GVJ konstaton se ky program, në mënyrën sesi është organizuar dhe strukturuar, ofron mundësinë që studentët që e përfundojnë atë të mund të zgjedhin midis dy mundësive, ose vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë të studimeve të doktoraturës; ose punësimin në përshtatje me profilin e programit të studimit dhe pritshmëritë e tregut të punës. Referuar dokumentacionit shoqërues ( <i>Listës së marrëveshjeve të bashkëpunimit</i> ), GVJ konstatoi se UAMD ka nënshkruar një sërë marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike, dhe aktorë të tjerë në vend, si (Kuvendi i Shqipërisë, KLSH, Spitali Rajonal Durrës, Autoriteti Portual Durrës, Dhoma e Tregtisë, etj.) ku palët angazhohen për shkëmbim eksperience dhe ekspertizë në funksion të realizimit të objektivave të programeve të studimit,




	<p>për tu dhënë mundësi studentëve të zhvillojnë praktikat profesionale si dhe për tu punësuar në të ardhmen si specialistë në sektorin publik.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 60. Kurrikula e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 115. Syllabuset e lëndëve të Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Dok. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për Programin e Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Dok. Aneks 72. Lista e marrëveshjeve me IAL&amp;institucione partnere.</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se organizimi, struktura dhe përmbajtja e elementëve të programit të studimit MSh_PAAP, synojnë të përcjellin tek studentët njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike në funksion të punësimit të tyre si specialistë të aftë në administratën publike, por edhe të garantoj vazhdimësinë e mëtejshme të karrierës së tyre profesionale. Nga shqyrtimi i shpërndarjes së lëndëve në vite e semestra, GVJ formoi bindjen se, kurrikula dhe plani mësimor mundëson arritjen e objektivave formues të këtij programi studimi.</i></p> <p><i>Kurrikula dhe plani mësimor i këtij programi studimi, emërtimi i lëndëve, përmbajtja e tyre, ngarkesa mësimore, paraqitet e përfaqëson me programe të tjera studimi në të njëjtën fushë, e cila bën të mundur transferimin e studimeve dhe ofrimin e mundësive për mobilitetin e studentëve në universitete të tjera jashtë vendit. Gjatë takimit me P/Dep., u konfirmua, se është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Côte D'Azur, Nicë, Francë për ofrimin e nje diplome të dyfishtë. GVJ shprehet për përmbushjen e plotë të këtij standardi.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>X</b>




**Standardi II.5**

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Sic theksohet në RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter, përmirësimi i vazhdueshëm i përmbajtjes së programit të studimit është në fokus të vëmendjes të DAP dhe orientohet nga zhvillimet ekonomike në vend. Referuar shqyrtimit të dokumentacionit (<i>Planit të Zhvillimit Strategjik të UAMD-së, Kreu VIII</i>), citohet se objektivi është angazhimi i institucionit për të ndihmuar studentët që të bëjnë lidhjen më të mirë mes përvojës së tyre akademike dhe karrierës profesionale që do të ndjekin. Rol të rëndësishëm, luan Sektori i Komunikimit, Alumni dhe Karrierës i cila synon gjithmonë e më shumë të ofrojë një shërbim cilësor nëpërmjet këshillimeve, orientimeve dhe seminareve për t'i ndihmuar studentët të qartësojnë qëllimet akademike dhe të karrierës, të zhvillojnë aftësitë e kërkimit të punës dhe të bëjnë një kalim të suksesshëm nga universiteti drejt tregut të punës. Gjithashtu, një moment i rëndësishëm është edhe ndërtimi i marrëdhënieve me studentë, Alumni, punëdhënës dhe institucione për të lehtësuar praktikën studentore, punësimin dhe karrierën profesionale.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion, përfaqësues të departamentit u shprehën se përditësimi i përmbajtjes së programit ishte një aktivitet periodik dhe në përputhje me kërkesat dhe zhvillimet e sektorit publik në vend. Referuar dokumentacionit shoqëruar (<i>Listës së marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>), GVJ konstatoi se UAMD, FShPJ ka një sërë marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike, dhe aktorë të tjerë në vend, ku palët angazhohen për shkëmbimin e eksperiencës dhe ekspertizës në funksion të realizimit të objektivave të programeve të studimit. Në takimim e GVJ me P/Dep dhe grupin e vlerësimit të brendshëm u konfirmua se strukturat përkatëse dhe përgjegjëse, marrin në konsideratë propozimet e institucioneve partnere, dhe aktorëve të tjerë për të përmirësuar përmbajtjen dhe strukturën e programit të studimit me qëllimin rritjen e mundësive të punësimit të studentëve në tregun e punës. Referuar RVB për këtë kriter, si dhe gjatë takimit të GVJ me përfaqësues të Sektorit të</p>





	<p>Karrierës, Alumni dhe Komunikimit, u konfirmua se UAMD, zhvillon çdo vit organizon takimin e Alumni-it, një aktivitet që mbledh së bashku studentët e diplomuar, që të ndajnë dhe shkëmbejnë eksperiencat profesionale por edhe krijimin e lidhjeve midis universitetit dhe tregut të punës. Një tjetër aktivitet, është dhe organizimi i Panairit të punës, ku marrin pjesë institucione publike dhe aktorë biznesi si dhe përfaqësues të tyre, i cili ka qëllim rritjen e bashkëpunimit për të dyja palët, si dhe ofrimin e mundësive për zhvillimin e praktikës profesionale dhe punësimin e studentëve të diplomuar.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 10. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit MSh PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit MSh PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 21. Rreg. per Sektorin e Komunikimit Alumni&amp;Karrieres UAMD;</i></p> <p><i>Aneks 22. Informacion per Sektorin e Komunikimit Alumni&amp;Karrieres UAMD;</i></p> <p><i>Aneks 22.2. Shoqata Alumni&amp;Aktivitetet UAMD;</i></p> <p><i>Aneks 72. Lista e marrëveshjeve me IAL&amp;institucione partnere;</i></p> <p><i>Aneks 86. Studim i tregut të punës DAP_FShPJ.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV dhe vizitës të GVJ në institucion, u konfirmua se UAMD, synon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në nivele vendimarrëse; Senatin Akademik, NjSBC, GVB, SKAK, etj. Nga shqyrtimi i Rregullores për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë të UAMD-së (neni, 6) citohet, përfshirja e studentëve në vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie, cilësisë së shërbimeve të ofruara nga universiteti dhe cilësisë së programeve të studimit, etj. Në nivel Institucional, strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë janë: Senati Akademik; Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC); Drejtoria e Kurrikulës dhe</p>




	<p>Standardeve të Cilësisë (DKSC); Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, (DAShA). Në nivel Fakulteti, përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë: Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NjBSC); Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program studimi; Koordinatorët e programeve të studimeve; Sektori i Komunikimit, Alumni dhe Karrierës, Sekretaria Mësimore. Në fakultet, është ngritur dhe funksionon NjBSC e cila përbëhet nga 5 anëtarë, ku përfshihet edhe një student.</p> <p>Gjatë takimeve të GVJ, me përfaqësues të kësaj njësie, u konfirmua bashkëpunimi midis këtyre strukturave, për të siguruar në mënyrë të vazhdueshme, cilësinë në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor, cilësinë e programeve të studimit dhe shërbimeve të ofruara nga universiteti. Referuar të dhënave të RVB si dhe dokumentacionit shoqërues, NjSBC bashkëpunon me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, në mënyrë të vazhdueshme, dhe përdor instrumenta vlerësimi, lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë, monitorimin në mënyrë periodike të cilësisë së programeve të studimit, mësimdhënies dhe kërkimit-shkencor. Në këtë proces, (referuar statutit dhe rregullores së UAMD-së), përfshihen dhe studentë përmes plotësimit të pyetësorëve, për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, performancës së stafit akademik, dhe cilësisë së programeve të studimit. Gjithashtu DAP, ka kryer plotësimin e një pyetësori/anketë me studentët e programit MSh_AP, gjatë vitit akademik 2020-2021, lidhur me opinionin, vlerësimin dhe propozimet e tyre në drejtimin të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. Studentët gjithashtu, organizohen në Këshilla Studentore, ku shprehin mendimet dhe propozimet e tyre për problematika të ndryshme duke përfshirë këtu edhe çështje të procesit mësimor dhe programeve të studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata,</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqërues dhe RVB të përgatitur për këtë kriter, GVJ konstatoi se FShPJ dhe DAP, organizon takime, workshope, konferenca, leksione të hapura me përfaqësues të institucioneve publike, dhe aktorë të tjerë, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës dhe ofrimin e ekspertizës në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit. Në takimim e GVJ me P/Dep dhe stafin akademik, u konfirmua se strukturat përgjegjëse, marrin në konsideratë propozimet e përfaqësuesve të institucioneve partnere, për të përmirësuar</p>





<p>urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>përmbajtjen e programit të studimit në përshtatje me zhvillimet e fundit dhe nevojat e sektorit publik.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 1. Statuti i UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 23.1. Rregullore per funksionimin dhe organizimin e SBSC_UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 23. Urdher per ngritjen e NjBSC_FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 87. Ankete me studentet_PS_MSh_AF_2020-2021;</i></p> <p><i>Aneks 40&amp;122. Raporti VetëVlerësimit_UAMD_2021-2022;</i></p> <p><i>Aneks 72. Lista e marrëveshjeve me IAL&amp;institucione partnere;</i></p> <p><i>Aneks 95. Raporti vjetor 2020-2021 i DAP;</i></p> <p><i>Aneks 51. Buletini i aktiviteteve dhe kërkimit shkencor 2021-2022_FShPJ.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV si dhe vizitës në Institucion, GVJ konfirmon se, UAMD është i angazhuar në një proces të vazhdueshëm të përmirësimit të kurrikulave dhe përmbajtjes së programeve të studimit që ai ofron duke marrë në konsideratë, propozimet e përfaqësuesve të institucioneve partnere me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi. UAMD dhe FShPJ, çdo vit, organizon takimin e Alumni-it, me studentët e diplomuar, që të ndajnë dhe shkëmbejnë eksperiencat profesionale por edhe krijimin e lidhjeve midis universitetit dhe tregut të punës. Në këtë universitet, organizohet dhe Panairi i punës, ku marrin pjesë institucione publike, biznese dhe sipërmarrje private, me qëllim rritjen e bashkëpunimit për të dyja palët. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, u konfirmua se institucioni, përfshin studentët në vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe cilësisë së programeve të studimit, etj. Në takimin e GVJ me P/Dep dhe stafin akademik u konfirmua se njësitë përgjegjëse, konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e përfaqësuesve të institucioneve partnere, për të përmirësuar përmbajtjen e programit të studimit në përshtatje me zhvillimet</i></p>




	<i>ekonomike dhe nevojat e sektorit publik. GVJ shprehet për përmbushjen plotësisht të këtij standardi.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


<b>Standardi II.6</b>	
<b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Referuar, shqyrtimit të Rregullores së programit të studimit, Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik” (Kreu I, neni 7), objektivat kryesorë të këtij programi ndër të tjera, janë që ti sigurojë studentëve, studime të thelluara dhe të avancuara në fushat e administrimit publik, shërbimeve dhe politikave në sektorin publik, për t’i pajisur me njohuritë e nevojshme akademike, kërkimore si dhe karrierë të sukseshme profesionale në të ardhmen në administratën publike. Ky program studimi synon pajisjen e studentëve me njohuri të avancuara teorike dhe koncepte praktike, të përgatisë dhe formojë specialistë të aftë, që t’u përgjigjen kërkesave dhe nevojave të tregut të punës brenda dhe jashtë vendit. GVJ gjykon se objektivat e programit të studimit janë në përputhje me misionin, prioritetet dhe objektivat madhorë të institucionit, të shprehura në statutin dhe planin e zhvillimit strategjik të UAMD-së.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Nga shqyrtimi i Statutit, Rregullores të UAMD-së si dhe Rregullores së njësisë kryesore dhe Njësisë bazë, GVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike (FShPJ) si njësi kryesore dhe Departamenti i Administrimit Publik (DAP) si njësi bazë që ofrojnë programin e studimit Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik”, nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare, në dispozicion të departamentit. Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e njësisë kryesore (neni, 19) dhe rregullores së njësisë bazë (neni, 18), personeli akademik gëzon liri akademike në drejtim të veprimtarisë së tij, në mësimdhënie; punë kërkimore-shkencore;


	<p>kontribut institucional dhe kontribut profesional. Në takimin e realizuar nga GVJ me stafin akademik të këtij programi studimi, u konfirmua se departamenti nxit, mbështet dhe respekton lirinë akademike të stafit akademik në organizimin e veprimtarive të mësimdhënies (fleksibilitetin e organizimit të orëve mësimore dhe metodologjive didaktike), në punën kërkimore-shkencore, pjesëmarrjen në projekte të ndryshme në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë vendas dhe të huaj si dhe në shkëmbimin e eksperiencave dhe kualifikimin e tyre. Përdorimi i metodave të reja të mësimdhënies dhe përshtatja e procesit mësimor në funksion të arritjes së objektivave të programit të studimit, ishte një tjetër faktor i dëshmuar nga GVJ gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 1. Statuti i UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 10. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 13. Strategjia e Kërkimit Shkencor të UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit_MSh_PAAP.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Nga të dhënat e RVB, GVJ informohet se DAP, si njësi bazë që ofron programin e studimit MSh_PAAP, nxit dhe motivon studentët që të angazhohen në projekte studimore dhe kërkimore duke theksuar dhe detyrimet e parashikuara në Planin Mësimor, aktivitetet institucionale si edhe projektet e bashkëpunimit institucional. Nga shqyrtimi i rregullores së programit të studimit, GVJ konstaton se, programi i studimit nxit dhe u mundëson studentëve pjesëmarrjen në projekte dhe aktivitete kërkimore dhe shkencore, në nivel fakulteti dhe universiteti. Gjatë takimeve të GVJ në studentët e këtij programi studimi u konfirmua përfshirja e tyre, në projekte, aktivitete kërkimore, konferenca shkencore, etj. Studentët e këtij programi studimi me nxitjen dhe mbështetjen e pedagogëve të departamentit kanë marrë pjesë në konferencat shkencore të organizuara në nivel departamenti dhe fakulteti. Nga takimi i realizuar me pedagogët e këtij programi</p>




	<p>studimi u konfirmua se studentët janë nxitur dhe janë përfshirë në aktivitete kërkimore, studime dhe projekte të ndryshme. Organizimi i rregullt periodik i konferencave studentore ishte një tjetër praktikë pozitive që u konfirmua me studentët e programit. Bazuar në këto konstatime, GVJ formon opinionin se ky kriter përmbushet plotësisht.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Duke analizuar dokumentacionin në DVV, (<i>Statutin, Strategjinë e Kërkimit Shkencor të UAMD-së, Rregulloret përkatëse</i>), si dhe RVB e përgatitur nga institucioni, GVJ konkludon se, institucioni angazhohet që të mbështesë financiarisht njësinë bazë, për aktivitete studimore, kërkimore dhe shkencore. Në RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter përmenden një sërë elementësh në mbështetje të aktiviteteve studimore dhe kërkimore. GVJ konstaton se (në dokumentin “Projekt Buxhetit Afat Mesëm (PBA) për vitin 2022-2024” të FShPJ), është parashikuar dhe financimi për aktivitete të kërkimit shkencor. Referuar, statutit, rregullores së UAMD-së, rregullores së njësisë kryesore/njësisë bazë, citohet se në buxhetin e njësisë kryesore/bazë duhet të përcaktohet dhe një fond që duhet të mbështesë veprimtarinë mësimore dhe kërkimore-shkencore.</p> <p>Në takimin e GVJ me dekanin e FShPJ, përgj/departamentit dhe stafin akademik, u konfirmua mbështetja financiare nga institucioni, për njësinë bazë dhe stafin akademik, lidhur me pjesëmarrjen në projekte kërkimore, organizimin e konferencave shkencore, botimin e artikujve shkencorë në revista shkencore me faktor impakti, scopus si dhe konferenca shkencore. GVJ formon opinionin se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 1. Statuti i UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 13. Strategjia e Kërkimit Shkencor të UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 126. Rregullore e menaxhimit të veprimtarive shkencore_UAMD-së;</i></p>

	<p><i>Aneks 127. Rregullore e Drejtorisë Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë_UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 52. Buletini i aktiviteteve dhe kërkimit shkencor_DAP_2019-2021;</i></p> <p><i>Aneks 54. Projekt Buxheti Afatmesëm_FShPJ_UAMD_2022-2024;</i></p> <p><i>Aneks 56. Konferenca studentore_FShPJ_2023;</i></p> <p><i>Aneks 57, 57.1. Konferenca Shkencore_DAP_FShPJ, 2019;2022;</i></p> <p><i>Aneks 95. Raporti vjetor_DAP_FShPJ_2020-2021;</i></p> <p><i>Aneks 130, 131,132. Raporti vjetor_FShPJ_2019-2020;2020-2021;2021-2022;</i></p> <p><i>Aneks 39. Raporti për veprimtarinë ekonomike-financiare_UAMD_2020-2021.</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ gjykon se, objektivat e programit të studimit janë në përputhje me misionin, prioritetet dhe objektivat madhorë të institucionit, të shprehura në statutin dhe planin e zhvillimit strategjik të UAMD-së. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga takimi me stafin akademik, u konfirmua se institucioni dhe njësia bazë nxit, mbështet dhe respekton lirinë akademike të stafit akademik në organizimin e veprimtarive të mësimdhënies dhe kërkimore-shkencore.</i></p> <p><i>Referuar dokumentacionit, GVJ konstaton se, programi i studimit nxit, motivon dhe u mundëson studentëve pjesëmarrjen në studime, aktivitete dhe projekte kërkimore - shkencore. Gjatë takimeve të GVJ me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi u konfirmua përfshirja e tyre, në aktivitete, projekte kërkimore, konferenca shkencore, etj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe gjatë takimeve me stafin akademik u konfirmua mbështetja financiare nga institucioni, lidhur me pjesëmarrjen në projekte kërkimore, konferenca shkencore, botimin e artikujve shkencorë, etj. GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>




<b>Standardi II.7</b>	
<b>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në DVV, <i>(Rregullores së Drejtorisë Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë_UAMD, neni 11-14)</i> si dhe RVB të përgatitur nga DAP, përcaktohet se kjo drejtori siguron dhe mbështet njësitë kryesore/bazë dhe stafin akademik për aplikimin në projekte kërkimore-shkencore në nivel kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo drejtori ka si objektiv të saj, menaxhimin dhe pjesëmarrjen në projekte, ndërkombëtarizimin e programeve të studimit, nxitjen e bashkëpunimit me partnerë të huaj, rritjen e vizibilitetit, asistencën e stafit akademik për aplikimin në projekte, etj, bashkërendimin e aktiviteteve me partnerë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në funksion të arritjes së objektivave të programit të studimit. Nga takimi i GVJ me përfaqësues të Drejtorisë Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, u konfirmua se kjo njësi, koordinon, dhe mbështet, njësitë kryesore/bazë dhe stafin akademik për aplikimin në projekte kërkimore-shkencore në nivel kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në procesin e shkëmbimeve të stafit dhe studentëve, në kuadër të projekteve dhe programeve Erasmus +. Në këtë drejtim, instiucioni ka bërë hapa të rëndësishëm drejt formimit të partneriteteve kombëtare dhe ndërkombëtare, duke rritur pjesëmarrjen në projekte kërkimore. GVJ konfirmoi edhe gjatë vizitës në Institucion rezultatet shumë të mira të punës në drejtim të projekteve shkencore dhe aktiviteteve kërkimore. Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqëruar <i>(Rregullores së njësisë kryesore/bazë, Rregullores së programit të studimit, etj)</i>,</p> <p>GVJ konstaton se; njësia kryesore dhe njësia bazë mbështet grupet mësimore, kërkimore-shkencore dhe siguron bashkëpunim me struktura të tjera kërkimore si Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, për pjesëmarrjen në projekte dhe aktivitete të kërkimit shkencor për realizimin e objektivave të këtij programi studimi. Në këto projekte ka një përfshirje jo vetëm të stafit akademik, por edhe të studentëve të këtij programi studimi. GVJ vlerëson shumë pozitivisht punën në</p>






	këtë drejtim dhe GVJ formon opinionin se ky kriter përmbushet plotësisht.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	<p>Në Strategjinë e Kërkimit Shkencor të UAMD-së, Kërkimi Shkencor zë një vend të veçantë. GVJ, konstaton se institucioni mbështet dhe nxit personelin akademik për t'u angazhuar në studime, aktivitete dhe projekte me karakter kërkimor dhe shkencor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Një fushë e rëndësishme për Universitetin ka qënë dhe vijon të jetë ndërkombëtarizimi i kërkimit shkencor, duke krijuar sinergji dhe partneritet me Universitete dhe Institucione kërkimore brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, referuar RVB të përgatitur nga institucioni, njësia bazë (DAP), organizon konferenca shkencore në fushën e Administrimit Publik që i shërbejnë thellimit të dijeve shkencore të stafit akademik dhe studentëve që të tërheqë përherë e më tepër mendimin më të avancuar shkencor bashkëkohor. Një nga objektivat e kërkimit shkencor dhe veprimtarisë kërkimore të institucionit, është dhe fokusi i tij tek studentët, duke u dhënë mundësinë që të angazhohen dhe të nxiten për të marrë pjesë në aktivitete dhe projekte kërkimore shkencore.</p> <p>Gjatë takimeve me P/Dep, stafin akademik, dhe përfaqësues të institucionit, GVJ konstatoi, pjesëmarrjen e stafit akademik si dhe studentëve në aktivitete dhe konferenca shkencore, si dhe në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	<p>Duke analizuar dokumentacionin në DVV, si dhe RVB të përgatitur nga institucioni, GVJ konkludon se, Departamenti i Administrimit Publik si njësi bazë, organizon çdo vit konferencën shkencore në fushën e administrimit publik, politikave dhe shërbimeve publike, që i shërbejnë thellimit të dijeve shkencore të stafit akademik dhe studentëve për arritjen e objektivave në kërkimin shkencor. Gjithashtu departamenti merr pjesë aktive në organizimin e konferencave në nivel fakulteti duke nxitur dhe stafin akademik dhe studentët që të kontribuojnë me punimet e tyre për arritjen e objektivave individuale. Në takimet e realizuara gjatë vizitës së GVJ në institucion, u konfirmua pjesëmarrja e stafit akademik dhe studentëve në projekte kërkimore, konferenca shkencore të organizuara nga fakulteti dhe departamenti, si dhe konferencat shkencore studentore. Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe takimit me përfaqësues të Drejtorisë Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, u konfirmua se UAMD, njësia kryesore dhe njësia bazë</p>




	<p>përgjegjëse për këtë program studimi janë të përfshira në disa projekte kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe kanë një sërë marrëveshje me IAL jashtë vendit në kuadër të programeve Erasmus +, që mundësojnë mobilitete të stafit akademik dhe studentëve të këtij departamenti.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 1. Statuti i UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 13. Strategjia e Kërkimit Shkencor të UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 126. Rregullore e menaxhimit te veprimtarive shkencore_UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 127. Rregullore e Drejtorisë Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë_UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 51. Buletini i aktiviteteve dhe kërkimit shkencor_FShPJ_2021-2022;</i></p> <p><i>Aneks 52. Buletini i aktiviteteve dhe kërkimit shkencor_DAP_2019-2021;</i></p> <p><i>Aneks 58. Grupet e punës për Konferencat Shkencore_FShPJ_2022;</i></p> <p><i>Aneks 56. Konferenca studentore_FShPJ_2023;</i></p> <p><i>Aneks 57, 57.1. Konferenca Shkencore_DAP_FShPJ, 2019;2022;</i></p> <p><i>Aneks 70. Database_Erasmus Staf akademik&amp;Studente_DAP_FShPJ.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Referuar, shqyrtimit të Rregullores së programit të studimit, Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik” (Kreu I, neni 7), objektivat kryesorë të këtij programi, janë që ti sigurojë studentëve, studime të thelluara dhe të avancuara në fushat e administrimit publik, shërbimeve dhe politikave në sektorin publik, për t’i pajisur me njohuritë e nevojshme akademike, kërkimore si dhe karrierë të sukseshme profesionale në përputhje me nevojat e administratës publike në nivel qendror dhe lokal. Ky program studimi synon, të përgatisë</p>




	<p>dhe formojë specialistë të aftë, që t'u përgjigjen kërkesave dhe nevojave të tregut të punës brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Në gjykimin e GVJ, ky objektivi është i arritshëm në mënyrë cilësore nëpërmjet tërësisë së njohurive që lëndët e programit ofrojnë në formën, strukturën dhe përmbajtjen me të cilën paraqiten në dosjen e DVV. Ky program studimi, ofrohet nga një staf akademik i kualifikuar, me eksperiencë akademike dhe profesionale në fushën e administrimit dhe menaxhimit në sektorin publik. GVJ gjykon se objektivat e programit të studimit janë në përputhje me misionin, dhe objektivat kryesorë të institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Duke analizuar RVB e përgatitur nga institucioni dhe dokumentacionin shoqërues (<i>Listën e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>), njësiti përgjegjëse, marrin në konsideratë propozimet dhe rekomandimet e institucioneve partnere, dhe aktorëve të tjerë për të përmirësuar përmbajtjen dhe strukturën e programit të studimit në funksion të realizimit të objektivave të tij me qëllimin, rritjen e mundësive të punësimit të studentëve në tregun e punës. Në dijeninë e GVJ, fusha në të cilën ofrohet ky program studimi, nuk parashikon marrjen e një licence për ushtrimin e profesionit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 1. Statuti i UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 10. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 72. Lista e marrëveshjeve me IAL&amp;institucione partnere;</i></p> <p><i>Aneks 86. Studim i tregut të punës DAP_FShPJ_2021;</i></p> <p><i>Aneks 87. Anketë me studentet PS_MSh_AF_2020-2021.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet</p>	<p>Në gjykimin e GVJ, ky kriter nuk zbatohet për programin e studimit MSh_PAAP.</p>




ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i> ).				
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, si dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se; njësia kryesore dhe njësia bazë mbështet grupet mësimore, kërkimore-shkencore dhe siguron bashkëpunim me struktura të tjera për pjesëmarrjen në aktivitete dhe projekte të kërkimit shkencor për realizimin e objektivave të këtij programi studimi. Në këto aktivitete dhe projekte ka një angazhim jo vetëm të stafit akademik, por edhe të studentëve.</i></p> <p><i>Programi i studimit MSh_PAAP, synon të përgatisë dhe formojë specialistë të aftë, që t'u përgjigjen kërkesave dhe nevojave të administratës publike në nivel qendror dhe lokal. Njësitë përgjegjëse, marrin në konsideratë propozimet dhe rekomandimet e institucioneve partnere për të përmirësuar në vazhdimësi, përmbajtjen dhe strukturën e programit të studimit me qëllimin, rritjen e mundësive të punësimit të studentëve në tregun e punës. Objektivat e këtij programi studimi janë në përputhje me misionin dhe objektivat kryesorë të institucionit. GVJ konfirmon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>





### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Rregullorja e UAMD-së, FShPJ, DAP dhe Rregullorja e Programit të Studimit_MSh_PAAP (nenet, 13, 18, 20), parashikon format e mësimdhënies dhe detyrimet e studentit ndaj lëndës. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike dhe përfshin (leksione, seminare, ushtrime, projekte/detyra kursi, praktikën profesionale dhe mikrotezën/tema e diplomës), ç'ka, në gjykimin e GVJ ofron mënyra të ndryshme dhe nxitëse për mësimnxënie nga ana e studentëve.</p> <p>Referuar të dhënave në aneksin 115 (<i>Syllabuset e lëndëve</i>), GVJ konstaton se syllabusi i çdo lënde përmban informacionet e nevojshme të detajuara, si: titulli i lëndës, titullari, ngarkesa në orë dhe kredite, tipologjia e lëndës (kategoria), viti dhe semestri kur zhvillohet lënda, lloji i lëndës, programi i studimit të cilit i përket, temat e lëndës, mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve të lëndës. Komponentët formues të programit në përgjithësi janë konform formateve të kërkuara sipas VKM Nr.41, datë 24.01.2018, ndryshuar me VKM nr.879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185, datë 25.3.2021.</p> <p>Rregullat për frekuentimin dhe procedurat e vlerësimit të studentëve janë të parashikuara dhe detajuara në syllabuset e secilës lëndë, duke u bazuar në Rregulloren e FShPJ, DAP dhe Rregulloren e Programit të Studimit (neni 20), përfshijnë (provimin e ndërmjetëm, aktivizimi në seminare, projekte/detyra kursi dhe provimin përfundimtar). Sipas nenit 13 të rregullores së programit të studimit, studenti është i detyruar të frekuentojë orët teorike dhe praktike në masën 75%. Edhe infrastruktura institucionale që është në funksion të këtij program studimi dëshmon për kushte të optimale të zhvillimit të programit mësimor. Përdorimi i metodave innovative, mjeteve bashkëkohore, (pajisjeve audio-vizive kompjuter, laptop,</p>




	<p>projektor, etj.) apo edhe platformave të ndryshme që mundësojnë realizimin e aktiviteteve të mësimit, ndikon në përmirësimin dhe performancën e procesit të mësimit dhe mësimit dhe mësimit.</p> <p>Referuar të dhënave të RVB dhe buletinit të aktiviteteve për vitin akademik 2021-2022, si rezultat i marrëveshjeve të bashkëpunimit, departamenti si njësi bazë për këtë program studimi, organizon aktivitete, workshope, leksione të hapura me profesionistë dhe ekspertë fushës, me qëllim angazhimin e studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimit dhe mësimit dhe mësimit.</p>	<p>Referuar Rregullores së Programit të Studimit_MSh_PAAP (neni, 17), format e mësimit janë të larmishme duke përfshirë (leksione, seminare, ushtrime, projekte/detyra kursi), ç'ka, në gjykimin e GVJ ofron mënyra të ndryshme dhe nxitëse për mësimit nga ana e studentëve. GVJ konstaton se; ky program studimi ndërthur njohuritë teorike me ato praktike, për të inkurajuar tek studentët mendimin krijues dhe kritik. Gjatë takimit të GVJ me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, u konfirmua se, synohet nxitja dhe zhvillimi i mësimit në mënyrë interaktive me studentët gjatë zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, përmes aktivizimit dhe diskutimeve, punës individuale dhe në grup, përgatitjes së detyrave/projekteve të kursit. Personeli akademik i DAP për këtë program studimi i përgjigjet nevojave të studentëve duke ofruar dhe përdorur metoda innovative, mjeteve bashkëkohore, (pajisjeve audio-vizive kompjuter, laptop, projektor, etj) apo edhe platformave të ndryshme, që ndikojnë në performancën e procesit të mësimit dhe mësimit dhe mësimit. Një shembull i tillë është zhvillimi i mësimit përmes platformave mësimore online gjatë periudhës së pandemisë-Covid 19. Referuar, rezultateteve të anketimit të kryer nga departamenti në vitin 2020-2021, tregojnë se studentët janë të kënaqur metodologjinë e mësimit në këtë program studimi.</p> <p><i>GVJ rekomandon që, në të ardhmen të rritet përdorimi i platformave e-learning, duke ofruar për studentët dhe stafin akademik, mënyra dhe metoda alternative e interaktive të mësimit dhe mësimit dhe mësimit.</i></p> <p>GVJ shprehet për përmbushjen e këtij kriteri.</p>




	<p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 60. Kurrikula e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 115. Syllabuset e lëndëve të Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 72. Lista e marrëveshjeve me IAL&amp;institucione partnere;</i></p> <p><i>Aneks 52. Buletini i aktiviteteve dhe kërkimit shkencor_DAP_2019-2021;</i></p> <p><i>Aneks 82. Raporti i rezultateve të anketimit të studentëve, stafit akademik dhe administratës mbi institucionin;</i></p> <p><i>Aneks 87. Anketë me studentet_PS_MSh_AP_2020-2021;</i></p> <p><i>Aneks 80. Analiza e pyetsorit për mesimin online_FShPJ_2021.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Për përmbushjen e këtij kriteri, nga shqyrtimi i RVB, GVJ konstaton se, institucioni i kushton një rëndësi përmirësimit të vazhdueshëm të aftësive pedagogjike dhe didaktike të stafit akademik. Si rezultat i marrëveshjeve të bashkëpunimit të UAMD-së me universitete partnere ndërkombëtare në kuadrin e kërkimit shkencor dhe marrëveshjeve së mobiliteteve Erasmus +, stafi akademik, ka përfituar dhe përmirësuar kompetencat didaktike nga shkëmbimi i eksperiencës, dhe praktikave më të mira të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjatë vizitës në Institucion, stafi dëshmon se punon me pasion për të dhënë njohuri studentëve dhe angazhohet për të qenë vazhdimisht në mbështetje të studentëve nëpërmjet informimit të vazhdueshëm të tyre në lidhje me mundësitë – si internshipe, konferenca etj, si dhe komunikimit të hapur me studentët. Përpos pjesës akademike dhe praktike, stafi akademik e konsideron të rëndësishëm edhe rolin e mentorit dhe këshilluesit të karrierës për punësimin e studentëve dhe karrierën e tyre profesionale në të ardhmen. Të pasurit e një qasje fleksibël dhe idetë inovatore nga ana e institucionit është një mundësi shumë e mirë për ti përfshirë studentët dhe për t'i motivuar ata.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në</p>	<p>GVJ, shqyrtoi CV-të e stafit akademik lidhur me formimit akademik dhe profesional të stafit të angazhuar në programin e</p>




<p>mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>studimit MSh_PAAP dhe duke gjykuar nga backgroundi i tyre konfirmon kompetencat akademike dhe përgatitjen profesionale për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve në funksion të arritjes së objektivave të të nxënit për studentët e këtij programi studimi.</p> <p>Gjatë vizitës dhe takimit në institucion të GVJ me stafin akademik, u konfirmua se, synohet nxitja dhe zhvillimi i mësimi në mënyrë interaktive me studentët gjatë zhvillimit të leksioneve dhe seminareve. Gjithashtu, ata përdorin metoda inovative dhe të larmishme në mësimdhënie për të nxitur pjesëmarrjen e studentëve. Nga ana e pedagogëve analizohen situata konkrete dhe diskutohen me studentët, ngrihen pyetje kërkimore dhe bëhen kërkime shkencore duke ndjekur metoda interaktive. Kjo angazhon studentët dhe i bën ata më të lirshëm gjatë orëve të mësimi, për të inkurajuar tek ata mendimin krijues dhe kritik. Gjatë takimit të GVJ me studentët e këtij programi studimi, u konfirmua se, nga pedagogët zhvillohet mësimi në mënyrë interaktive përmes aktivizimit dhe diskutimeve në seminare, punës individuale dhe në grup, si dhe përgatitjeve të detyrave të kursit, esseve. Personeli akademik në këtë program studimi referuar dokumentacionit shoqëruar angazhohet në projekte, marrin pjesë në konferenca shkencore si dhe kanë realizuar botime në revista shkencore. Fusha kërkimore-shkencore e secilit nga anëtarët e këtij stafi është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve ku ata zhvillojnë mësim.</p> <p>Për vitin akademik 2022-2023, stafi akademik që mbulon këtë program studimi, ka në përbërjen e tij 13 pedagogë (PAE dhe PAK), nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 3 janë me titullin Prof. Dr;</li> <li>• 4 janë me titullin Prof. As. Dr;</li> <li>• 5 janë me gradën shkencore “Doktor”;</li> <li>• 1 asistent lektorë me MSc;</li> </ul> <p>Profili i stafit akademik, që angazhohet në mësimdhënie është në përputhje me nevojat dhe objektivat e këtij programi studimi.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e</p>	<p>Në takimin e realizuar nga GVJ me GVB dhe përfaqësues të Njesisë Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, u konfirmua se institucioni përmes strukturave përkatëse ofron përfshirjen e studentëve përmes instrumentave të ndryshëm (anketimet, pyetsorët) në vlerësimin periodik të procesit mësimor. GVJ</p>






mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.

konstatoi si pjesë të DVV, dokumentacionin për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor, performancën e stafit akademik, programeve të studimit të ofruara nga UAMD, etj. Përmes plotësimit të pyetësorëve, studentët vlerësojnë format e mësimdhënies, përmbajtjen e lëndës, si edhe angazhimin e stafit akademik në përcelljen e informacionit lidhur me lëndën. Plotësimi i pyetësorëve me studentët, administrohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, sipas rregullores së kësaj të fundit dhe në përputhje me qëllimin e funksionimit të njësisë për të garantuar cilësinë dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Departamenti, ka kryer plotësimin e një anketë me studentët e programit MSh\_AP, gjatë vitit akademik 2020-2021, lidhur me opinionin, vlerësimin dhe propozimet e tyre në drejtimin të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit, kurrikulës së programit, performancës së stafit akademik dhe metodologjisë së mësimdhënies në këtë program studimi. UAMD dhe Departamenti si njësi bazë, në mënyrë të vazhdueshme ka përmirësuar, metodat e mësimdhënies duke reflektuar, mendimet dhe sugjerimet e studentëve në këtë proces.

*Referenca:*

*Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;*

*Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;*

*Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;*

*Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit\_MSh\_PAAP;*

*Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit\_MSh\_PAAP;*

*Aneks 115. Syllabuset e lëndëve të Programit të Studimit\_MSh\_PAAP;*

*Aneks 71. Lista e marrëveshjeve me IAL jashtë vendit\_UAMD;*

*Aneks 70. Database\_Erasmus Staf akademik&Studente\_DAP\_FShPJ;*

*Dok. Tabela 6. Të dhëna për personelin akademik të DAP, përgjegjës për Programin e Studimit\_MSh\_PAAP;*

*Dok. Aneks 99. Tabela për personelin akademik të Programit të Studimit\_MSh\_PAAP;*

*Dok. Aneks 114. CV e stafit akademik\_DAP\_FShPJ;*

	<p><i>Dok. Aneks 23.1. Rregullore per funksionimin dhe organizimin e SBSC_UAMD-së;</i></p> <p><i>Dok. Aneks 23. Urdher per ngritjen e NjBSC_FShPJ;</i></p> <p><i>Dok. Aneks 81 Formular per vlerësimin e stafit akademik nga studentët_UAMD.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, Institucioni ka miratuar ngritjen e strukturave përkatëse në funksion të garantimit të cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimit të vazhdueshëm të tyre. Në nivel Institucional, strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë janë: Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë; Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë; Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike. Në nivel Fakulteti, përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë: Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NjBSC); Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program studimi; Koordinatorët e programeve të studimeve; Sektori i Komunikimit, Alumni dhe Karrierës, Sekretaria Mësimore. Gjatë takimeve të GVJ, me përfaqësues të kësaj njësie, u konfirmua bashkëpunimi midis këtyre strukturave, për të siguruar në mënyrë të vazhdueshme, cilësinë në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor, cilësinë e programeve të studimit dhe shërbimeve të ofruara nga universiteti. Në gjykimin e GVJ, këto struktura ndihmojnë Institucionin në garantimin e një procesi cilësor didaktik. Më tej nga shqyrtimi i Rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, shihet se këto struktura mbështesin zhvillimet inovatore të procesit mësimor, vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit, vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësimin e performancës dhe rezultateve të punës kërkimore dhe shkencore, si dhe veprimtarive të tjera administrative të personelit akademik dhe ndihmës akademik në nivel institucional. Nga takimet me stafin akademik, u konfirmua mbështetja institucionale për kryerjen e trajnimeve të vazhdueshme, kryesisht në kuadrin e shkëmbimeve Erasmus+, ku u jepet mundësia e rritjes profesionale të stafit dhe e ndërkombëtarizimit të institucionit në përgjithësi. Gjatë vizitës në institucion u konfirmua se, njësi kryesore, njësi bazë, përgj të Dep., përgj. i grupeve mësimore kërkimore-shkencore, koordinatori i programit studimit, së bashku me strukturat e tjera përgjegjëse si NjSBC, koordinojnë</p>




	<p>dhe bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme lidhur me garantimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në procesin e mesimdhënies. Gjithashtu, referuar dhe RVB, në këtë institucion, realizohet edhe procesi i mentorimit të studentëve nga stafi akademik, në funksionin të përmirësimit të procesit të mesimdhënies dhe mesimnxënies.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 1. Statuti i UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 10. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 23.1. Rregullore per funksionimin dhe organizimin e SBSC_UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 125. Rregullore për funksionimin e Drejtorisë së administrimit të shërbimeve akademike_UAMD_2020</i></p> <p><i>Aneks 23. Urdher per ngritjen e NjBSC_FShPJ.</i></p> <p><i>Aneks 135. Vendim për organizimin e mentorimit të studentëve_UAMD_2018.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Referuar shqyrtimit të Rregulloreve të institucionit dhe specifikisht rregullores së Programit të Studimit_MSh_PAAP, si dhe programet e lëndëve, format e mesimdhënies në këtë program studimi përfshijnë, (leksione, seminare, ushtrime, projekte/detyra kursi, etj). Gjatë takimit të GVJ me stafin akademik u konfirmua se, synohet nxitja dhe zhvillimi i mësimin në mënyrë interaktive me studentët gjatë zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, punës individuale dhe në grup. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, pranë institucionit, janë ngritur dhe funksionojnë strukturat përkatëse me qëllim përmirësimin në vazhdimësi të cilësisë së mesimdhënies dhe performancës të stafit akademik dhe ndihmës akademik. Këto struktura mbështesin zhvillimin e metodave të reja inovative, dhe trajtojnë personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mesimdhënies në nivel fakulteti dhe universiteti. GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.2

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Për të analizuar këtë kriter, GVJ ka shqyrtuar, (Rregulloren e UAMD-së, neni 68, Rregulloren e FShPJ, neni 54, Rregulloren e DAP, neni 56 dhe Rregulloren e Programit të Studimit, neni 20), por edhe syllabuset e lëndëve përkatëse të programit të studimit MSh_PAAP të cilat janë pjesë e dokumentacionit në DVV. Rregullorja e njësisë bazë (DAP) dhe e programit të studimit, parashikon me detaje, mënyrën e vlerësimit të njohurive dhe dijeve të studentëve. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përfshijnë; a) provimin e ndërmjetëm, i cili përmban 400 pikë ose 40% të vlerësimit përfundimtar; b) pjesëmarrja, aktivizimi gjatë seminareve, detyrat, projektet, esetë, të cilat përmbajnë 100 pikë ose 10%, të vlerësimit përfundimtar; c) provimi përfundimtar, i cili, përmban 500 pikë ose 50% të vlerësimit përfundimtar. Nota përfundimtare e studentit është totali i elementëve të vlerësimit të vazhduar dhe provimit përfundimtar. Përqindja e rëndësisë për çdo komponent vlerësimi është e përcaktuar dhe në syllabuset e lëndëve. Sipas rregullores së programit të studimit, studenti është i detyruar të frekuentojë orët teorike dhe praktike në masën 75%.</p> <p>GVJ konstatoi, se format e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve për studentët janë përcaktuar edhe në programet e lëndëve në përputhje me kërkesat e VKM Nr.41, datë 24.01.2018, ndryshuar me VKM nr.879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185, datë 25.3.2021, dhe i bëhen të njohura studentëve në gjatë orës/javës parë të zhvillimit të mësimit për çdo lëndë. Gjithashtu referuar RVB, studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme dhe nga pedagogu mentor për çdo paqartësi, që mund të kenë gjatë zhvillimit të procesit mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV (Rregullores së UAMD-së, Rregulloreve të njësisë kryesore/bazë, Rregullores së Programit të Studimit, si edhe programeve lëndore të programit</p>




<p>metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>të studimit MSh_PAAP), GVJ konstaton se syllabusi i çdo lënde përmban informacionet e nevojshme të detajuara, si: titulli i lëndës, titullari, ngarkesa në orë dhe kredite, tipologjia e lëndës (kategoria), viti dhe semestri kur zhvillohet lënda, lloji i lëndës, programi i studimit të cilit i përket, temat e lëndës, format e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve për studentët. Gjatë takimit të GVJ me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, u konfirmua se, studentët informohen nga pedagogu i lëndës/modulit përkatës në javën e parë të fillimit të mesimit, për elementët, përmbajtjen e lëndës, si edhe metodologjinë e vlerësimit të njohurive dhe kontrolloit të dijeve. Programet lëndore vendosen gjithashtu në dispozicion të studentëve që në fillim të semestrit, nëpërmjet mënyrave të brendshme të komunikimit mes studentëve dhe pedagogëve të programit të studimit. <i>GVJ gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Siç GVJ është shprehur edhe më lart, nga shqyrtimi i Rregullores së Programit të Studimit, MSh_PAAP, ofron mënyra të larmishme të testimit dhe vlerësimit të njohurive. Këto forma dhe mënyra vlerësimi të studentit përfshijnë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) provimin e ndërmjetëm, 400 pikë ose 40%, të vlerësimit përfundimtar;</li> <li>b) pjesëmarrja, aktivizimi gjatë seminareve, detyrat/projektet e kursit, esetë, 100 pikë ose 10%, të vlerësimit përfundimtar;</li> <li>c) provimi përfundimtar, 500 pikë ose 50%, të vlerësimit përfundimtar.</li> </ul> <p>Nota përfundimtare e studentit është totali i elementëve të mësipërm. GVJ gjykon se përfshirja e këtyre formave të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin njohuritë dhe kompetencat e fituara në njërin ose disa prej formave të zgjedhura të vlerësimit të njohurive, të cilat duke qenë edhe të shpërndara përgjatë semestrit që zhvillohet programi i lëndës/modulit përkatës.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i>  <i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i>  <i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i>  <i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit MSh_PAAP;</i></p>




	<p><i>Aneks 60. Kurrikula e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i>  <i>Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i>  <i>Aneks 115. Syllabuset e lëndëve të Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i>  <i>Aneks 135. Vendim për organizimin e mentorimit të studentëve_UAMD_2018.</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ, pasi shqyrtoi dokumentacionin, si rregulloret institucionale, Rregulloren e Programit të Studimit, si edhe programet e lëndëve të programit të studimit MSh_PAAP, gjykon se mënyrat dhe format e vlerësimit të njohurive dhe dijeve përfshijnë; provimin e ndërmjetëm, pjesëmarrja, aktivizimi gjatë seminareve, detyrat/projektet e kursit, esetë, dhe provimin përfundimtar. Nga takimi me stafin akademik u konfirmua se studentët, informohen nga pedagogu i lëndës në javën e parë të fillimit të mësimin, për elementët, përmbajtjen e lëndës, si edhe metodologjinë e vlerësimit. Format dhe mënyrat e ndryshme të kontrollit të njohurive dhe dijeve, garantojnë një shpërndarje dhe vlerësim për studentët gjatë gjithë semestrit dhe vitit akademik. GVJ, shprehet për përmbushjen e plotë të këtij standardi.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ konstatoi se, sipas Rregullores së Programit të Studimit MSh_PAAP, vlerësimi i njohurive dhe dijeve të studentit, mbështetet në elementët e kontrollit të vazhdueshëm (provimi i ndërmjetëm, pjesëmarrja, aktivizimi dhe diskutimi në seminare, punë individuale dhe në grup; detyra/projekte kursi, esse, etj.) dhe provimin përfundimtar. Nota përfundimtare e studentit është totali i elementëve të mësipërm. Nga verifikimi i dokumentacionit shoqërues ( <i>Syllabuset e lëndëve</i> ), si dhe gjatë takimit të GVJ me stafin akademik u konfirmua se, studentët informohen nga pedagogu i lëndës/modulit përkatës, për




	<p>elementët, përmbajtjen e lëndës, si edhe metodologjinë e vlerësimit të njohurive dhe kontrollit të dijeve. GVJ gjykon se këto forma dhe mënyra vlerësimi, i motivojnë studentët të përgatiten gjatë gjithë semestrit që zhvillohet programi i lëndës/modulit përkatës. GVJ, konfirmon përmbushjen e plotë të këtij kriteri.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit (<i>Marrëveshjet e bashkëpunimit</i>) konstatoi se UAMD në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) ka nënshkruar një marrëveshje për aplikimin e projektit Clean Score, lidhur me korigjimin dhe vlerësimin e provimeve të studentëve në mënyrë elektronike. Këto mënyra korigjimi dhe vlerësimi të provimeve u konfirmuan dhe gjatë takimit të GVJ me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Mënyra e vlerësimit të studentëve në programin e studimit MSH_PAAP është analizuar nga GVJ në kriteret më lart dhe gjendet e përfshirë në mënyrë transparente në rregulloren e programit të studimit si edhe në programet lëndore/syllabuset përkatëse. Vlerësimi me notë bëhet mbështetur në totalin e vlerësimit gjatë vitit dhe provimit përfundimtar (Rregulloret e programit të studimit, neni 20, 23).</p> <p>Vlerësimi për secilën lëndë, kryhet me sistemin e notave, ku 5 është nota minimale kaluese dhe 10 është ajo maksimale. Në të gjitha format e provimit përdoret, sistemi i vlerësimit me 1.000 pikë/100%, të cilat konvertohen në notë. Kjo mënyrë vlerësimi përfshihet gjithashtu edhe në syllabuset e çdo lënde tek seksioni, Forma e Kontrollit të Dijeve, (Tabela e Vlerësimit). Gjatë vizitës në Institucion, dhe takimeve me stafin dhe studentët e programit, u konfirmua se vlerësimi përfundimtar i lëndës ndjek formën dhe mënyrën e parashikuar në rregullore dhe syllabuset e lëndëve dhe nuk ka shmangie nga ky rregull vlerësimi.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p>





	<p><i>Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 115. Syllabuset e lëndëve të Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 46. Manual për përdorimin e Sistemit Pitagora_RASh;</i></p> <p><i>Aneks 119. Marrëveshje me AADF, Clean Score&amp;UAMD;</i></p> <p><i>Aneks 120. Një praktikë vlerësimi provimeve me sistemin Clean Score.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqëruar në DVV (Rregullores së UAMD-së, Rregulloreve të njesisë kryesore/bazë, Rregullores së Programit të Studimit, si edhe programeve lëndore të programit të studimit MSh_PAAP), sipas RVB për këtë kriter, institucioni thekson kujdesin që ka pedagogu i lëndës që të bëjë vlerësime me komentet e nevojshme të cilat diskutohen individualisht me çdo student në mënyrë që këta të fundit të informohen për performancën e tyre në një element të caktuar të vlerësimit si edhe të mund të japin një feedback nëse kjo është e nevojshme. Në orën pasardhëse të mësimin personeli akademik për provimet e ndërmjetme, pedagogu bën ballafaqimin e rezultateve për studentët në mënyrë që të sigurohet transparenca e vlerësimit. Në rastin e provimit përfundimtar, personeli akademik i lëndës cakton datën dhe orën për të bërë të ditur rezultatet e provimit. Pasi u komunikon studentëve, vlerësimin dhe rezultatet e provimit, pedagogu i pasqyron, ato në sistem brenda afateve të përcaktuara. Pedagogu i lëndës dorëzon pranë sekretarisë mësimore, procesverbalin e rezultateve si dhe tezat e provimit të korrigjuara brenda afateve të përcaktuara. Kjo praktikë u konfirmua nga GVJ gjatë vizitës në Institucion në bisedat me stafin dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 115. Syllabuset e lëndëve të Programit të Studimit_MSh_PAAP.</i></p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në rregulloren (Rregulloren e UAMD-së, neni 70, Rregulloren e FShPJ, neni 56, Rregulloren e DAP, neni 59 dhe Rregulloren e Programit të Studimit, neni 21, 41, si dhe Kodin e Etikës të UAMD-së, neni 17, 23), GVJ konstaton se janë parashikuar procedura specifike në lidhje me zhvillimin e provimeve, dhe disa nga këto rregulla janë në funksion të shmangies së plagjiaturës dhe kopjimit. Studentëve nuk u lejohet të përdorin pajisje celulare në provim, tezat e provimit përgatiten në më shumë se një variant, dhe ndryshohen në çdo sezon provimi etj. Përveç sa parashikohet në Rregulloren Institucionale, Kodin e Etikës dhe në Rregulloren e Programit të Studimit, por edhe gjatë takimeve me P/Dep dhe stafin akademik, u konfirmua se për plagjiaturën dhe kopjimin në provime, ndaj studentëve merreshin masa si përjashtimi i tyre nga sezoni përkatës i provimeve dhe dhënia e paralajmërimit për mospërsëritjen e akteve anti etike në provime.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 32. Kodi i Etikës_UAMD.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e institucionit, Rregulloreve të njesisë kryesore/bazë, dhe Rregullores së Programit të Studimit, rezultati i provimit i komunikohet studentëve brenda afateve të parashikuara, që është jo më vonë se 3 (tre) nga data e kryerjes së provimit. Procesverbali i vlerësimit plotësohet nga pedagogu në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari jo më vonë se 5 ditë pune nga dita e provimit. Ky afat përgjithësisht u konfirmua se respektohej edhe gjatë vizitës së GVJ në Institucion ku nuk u konstatuan shmangie. Komunikimi i rezultatit të provimit bëhet individualisht për çdo student në accountin e tyre, përmes sistemit Pitagora ose nga sekretaria mësimore. Pedagogu i lëndës dorëzon pranë sekretarisë mësimore procesverbalin e rezultateve si dhe tezat e provimit të korrigjuara brenda afateve të përcaktuara. Procesverbali me notat përfundimtare nënshkruhet nga pedagogu/ët e lëndës, sekretarja mësimore, kryesekretarja, Drejtuesi i Njesisë Bazë dhe Drejtuesi</p>




	i Njesisë Kryesore. Kjo u konfirmua dhe gjatë vizitës së GVJ në sekretarinë mësimore.
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Nga shqyrtimi i Rregullores së institucionit, neni 71, Rregulloreve të njesisë kryesore/bazë, nenet 57, 60 dhe Rregullores së Programit të Studimit, GVJ konstatoi se, institucioni garanton të drejtën e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit. Ankesa/kërkesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njesisë Kryesore, jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Drejtuesi i Njesisë Kryesore e kalon për shqyrtim kërkesën Përgjegjësit të Departamentit përkatës. Në rastin kur kërkesa miratohet, Dekani ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës së provimit në prezencë të studentit dhe pedagogut/titullarit të lëndës. Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij për të ndryshuar ose jo vlerësimin e provimit së bashku me arsyetimin përkatës. Në rast se ka ndryshim në vlerësimin e provimit, pasqyrohet në procesverbalin e lëndës duke ndjekur procedurat e përcaktuara në këtë rregullore. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, dokumentohet dhe arshivohet. Kjo praktikë u konfirmua edhe gjatë vizitës në Institucion në takimin me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi.
<b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Nga shqyrtimi i Rregullores së institucionit, neni 71, Rregulloreve të njesisë kryesore/bazë, nenet 57, 60 dhe Rregullores së Programit të Studimit, neni 22, GVJ konstatoi se, institucioni garanton të drejtën e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit. Ankesa/kërkesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njesisë Kryesore, i cili ia përcjell kërkesën Përgjegjësit të Departamentit përkatës. Në rastin kur kërkesa miratohet, Dekani ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës së provimit në prezencë të studentit dhe pedagogut/titullarit të lëndës. Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij për të ndryshuar ose jo vlerësimin e provimit së bashku me arsyetimin përkatës. Në rast se ka ndryshim në vlerësimin e provimit, pasqyrohet në procesverbalin e lëndës duke ndjekur procedurat e përcaktuara në këtë rregullore. Dokumentacioni i plotë administrohet një kopje nga sekretaria





	<p>mësimore dhe një kopje nga njësia kryesore/bazë e cila ofron programin e studimit. Kjo procedurë u konfirmua dhe gjatë vizitës në Institucion.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 115. Syllabuset e lëndëve të Programit të Studimit_MSh_PAAP.</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ, pasi shqyrtoi dokumentacionin në DVV, Rregulloret institucionale, dhe Rregulloren e programit të studimit MSh_PAAP, konstaton se janë parashikuar të gjitha procedurat dhe kriteret e nevojshme në lidhje me vlerësimin, procedurën e ankimimit dhe rishikimit të vlerësimit nga ana e studentëve. GVJ konstatoi se UAMD në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) ka nënshkruar një marrëveshje për aplikimin e projektit Clean Score, lidhur me korrigjimin dhe vlerësimin e provimeve të studentëve në mënyrë elektronike. Rezultati i provimit i komunikohet studentëve brenda afateve të parashikuara nga data e kryerjes së provimit. Bazuar në rregulloret institucionale dhe rregulloren e programit të studimit, institucioni garanton të drejtën e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit. GVJ, gjykon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>




<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi dhe analiza e Kurrikulës dhe Planit mësimor të këtij programi studimi, lëndëve të përfshira si edhe përmbajtjet e detajuara në çdo program lëndor, garantohet thellimi i njohurive profesionale dhe aplikative në fushën e administrimit publik, shërbimeve dhe politikave në sektorin publik por edhe aftësimi i studentëve për t'u angazhuar në veprimtari me fokus të veçantë në kërkimin shkencor. Programi i studimit MSh_PAAP, synon të përgatisë studentët; të analizojnë çështje konkrete të qeverisjes në kontekstin, teorik, praktik dhe analitik, të vlerësojnë problematikat dhe fenomenet sociale në kontekstin e rolit të administratës publike, të integrojnë të kuptuarit e zhvillimit të programit, vlerësimit dhe analizës në fokus të përmirësimit të politikave, shërbimeve dhe programeve publike, të kombinojnë metodat sasiore dhe cilësore në udhëheqjen e një kërkimi shkencor, të veprojnë në mbështetje të interesit publik me standarde më të larta morale. Puna shkencore realizohet si gjatë orës së mësimit ashtu edhe në organizimin e veprimtarive kërkimore e shkencore nga studentët gjatë realizimit të programit mësimor në formën e eseve dhe detyrave të kursit me karakter aplikativ. Rregullorja specifikon se prioritet duhet të ketë organizimi i debatit akademik për të gjitha veprimtaritë me peshë në formimin e studentëve për fushën e programit të studimit dhe organizimi i debateve akademike në bashkëpunim me strukturat dhe përfaqësuesit e administratës publike. Sipas rregullores, puna individuale e studentëve duhet të orientohet në mënyrë të tillë që ata të angazhohen në hulumtim dhe studime sipas fushave dhe përmbajtjes të lëndëve dhe moduleve përkatëse. Gjithashtu, një komponent i rëndësishëm është dhe zhvillimi i praktikës profesionale pranë institucioneve publike, si dhe përgatitja e mikrotezës duke i dhënë mundësi, studentëve për tu thelluar në njohuritë praktike dhe shkencore në përputhje me objektivat e programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe</p>	<p>Nga shqyrtimi i Kurrikulës dhe Planit Mësimor, GVJ konstatoi se ka disa lëndë të cilat fokusohen në trajtimin e elementëve që lidhen me teknologjinë e informacionit, shkencat humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimin si lëndë, Administrim Publik i avancuar, Sjellje Organizative e Avancuar, Menaxhim i Organizatave Publike, Drejtim Projekti në Sektorin Publik i Avancuar, Politika Publike të Avancuara, Ekonomiks Publik i Avancuar, Etikë në Administrimin Publik, Menaxhimi i</p>




<p>ndërveprimet (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Burimeve Njerëzore në Sektorin Publik etj. Në përshtatje me zhvillimet në fushën e administrimit dhe menaxhimit në sektorin publik, të cilat garantojnë thellimin e njohurive të studentëve në përputhje me objektivat e programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblyëse.</p>	<p>Nga analiza e programeve lëndore, GVJ konstatoi se në to është parashikuar një përmbledhje e lëndës në javën e fundit të zhvillimit të procesit mësimor. Veç kësaj, të gjitha programet lëndore kanë të përfshira si një seksion të veçantë në fillim të tyre “Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit”, kjo në përputhje edhe me kërkesat e VKM nr.41 të ndryshuar. Gjatë takimit të GVJ me stafin akademik, u konfirmua se në përputhje me rregulloren dhe objektivat e programit të studimit, në javën e fundit të semestrit, pedagogu i lëndës bën një përmbledhje të njohurive dhe aftësive që janë arritur nga ana e studentëve, si dhe orienton ata në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku duhet të përqëndrohen, dhe i informon për strukturën, natyrën e pyetjeve në provimin përfundimtar.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 60. Kurrikula e programit studimit MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 115. Syllabuset e lëndëve të Programit të Studimit_MSh_PAAP.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e</p>	<p>Plani Mësimor i Programit të Studimit MSh_PAAP, përcakton zhvillimin e praktikës profesionale në semestrin e fundit të studimeve si një instrument për praktikimin e njohurive teorike të përfuara gjatë studimeve. Nga diskutimet me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit, GVJ konstatoi se ata ishin të hapur për të nxitur bashkëpunimin e studentëve, punën e tyre në grup me qëllim aftësimin për zgjidhje të çështjeve dhe problemeve të caktuara. Stafii akademik theksoi përdorimin e metodave interaktive gjatë procesit mësimor, si rastet</p>




<p>problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>studimore, detyra kursi, esse, etj, që nxisin studentët për të punuar në grup, për të ndarë përvojat dhe shprehur aftësitë e tyre.</p> <p>Referuar të dhënave të RVB dhe buletinit të aktiviteteve për vitin akademik 2021-2022, si rezultat i marrëveshjeve të bashkëpunimit, departamenti si njësi bazë për këtë program studimi, organizon aktivitete, workshope, leksione të hapura me profesionistë dhe ekspertë fushës, me qëllim angazhimin e studentëve në internship, praktika profesionale si dhe projekte kërkimore. Vetë studentët u shprehën pozitivisht për mbështetjen që kanë pasur në këtë drejtim nga stafi akademik dhe institucioni. Gjithashtu si rezultat i një numri të konsiderueshëm marrëveshjesh të institucionit me IAL jashtë vendit, mundësohen mobilitete për stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, në kuadër të programeve Erasmus +. GVJ konfirmon përmbushjen e plotë të këtij kriteri.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Si pjesë të DVV, GVJ konstatoi dhe analizoi dokumentacionin për zhvillimin e leksioneve të hapura, që demonstrojnë ndërthurjen e mësimdhënies nga stafi akademik me përfaqësues të institucioneve partnere për të mundësuar prezantimin e ideve mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë lidhur me programin e studimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV si dhe nga takimi i GVJ me stafin akademik, u konfirmua se FShPJ dhe DAP si njësi përgjegjëse, në bashkëpunim me institucionet dhe organizatat publike me të cilat kanë marreveshje bashkëpunimi, organizojnë takime, workshope, konferenca, dhe leksione të hapura, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës dhe ofrimin e ekspertizës në funksion, në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 115. Syllabuset e lëndëve të Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p>




	<p><i>Aneks 51. Buletini i aktiviteteve dhe kërkimit shkencor_FShPJ_2021-2022;</i></p> <p><i>Aneks 52. Buletini i aktiviteteve dhe kërkimit shkencor_DAP_2019-2021;</i></p> <p><i>Aneks 71. Lista e marrëveshjeve me IAL jashtë vendit_UAMD;</i></p> <p><i>Aneks 72. Lista e marrëveshjeve me IAL&amp;institucione partnere;</i></p> <p><i>Aneks 70. Database_Erasmus Staf akademik&amp;Studente_DAP_FShPJ.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Referuar dokumentacionit në DVV, institucioni angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për të mbështetur dhe inkurajuar idetë inovatore të studentëve. Kontributi financiar i institucionit ka qenë në drejtim të organizimit të konferencave shkencore studentore si dhe pjesëmarrjes në projekt kërkimore-shkencore.</p> <p>Referuar analizës së RVB, theksohet se stafi akademik nxit dhe motivon studentët që të marrin pjesë në aktivitete dhe konferenca shkencore, si dhe në projekte kërkimore. Gjatë takimit të GVJ me studentët u confirmua nga këta të fundit, se janë mbështetur nga institucioni, për punimet e tyre shkencore, të cilat i kanë prezantuar në konferencat shkencore të organizuara nga departamenti dhe fakulteti.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 58. Grupet e punës për Konferencat Shkencore_FShPJ_2022;</i></p> <p><i>Aneks 56. Konferenca studentore_FShPJ_2023;</i></p> <p><i>Aneks 57. Konferenca Shkencore_DAP_FShPJ_2022.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga shqyrtimi dhe analiza e Kurrikulës dhe Planit mësimor si edhe përmbajtjes së programeve të lëndëve, programi i studimit_MSh_PAAP, garanton pajisjen e studentëve me njohuri të thelluara profesionale në fushën e administrimit publik dhe menaxhimit publik, por edhe aftësimin e tyre në aktivitete me fokus kërkimin shkencor. Gjatë takimit me stafin akademik, u confirmua se, në javën e fundit të semestrit, pedagogu i lëndës</i></p>




	<p><i>bën një përmbledhje të njohurive dhe aftësive që kanë arritur studentët, si dhe i orienton ku duhet të fokusohen, për provimin përfundimtar. GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga takimi me stafin akademik, konstatoi se institucioni, në bashkëpunim me institucionet dhe organizatat partnere me të cilat kanë marrëveshje bashkëpunimi, organizon takime, workshope dhe leksione të hapura, në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit. Institucioni, angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për të mbështetur dhe inkurajuar idetë inovatore të studentëve, në drejtim të organizimit të konferencave shkencore studentore si dhe pjesëmarrjes së tyre në aktivitete të tjera kërkimore-shkencore. GVJ konfirmon, shkallën e përmbushjes së plotë të këtij standardi.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues në DVV (Rregullores së UAMD-së, Rregulloreve të njësisë kryesore/bazë, neni, 61, 64 Rregullores së Programit të Studimit, neneve 28-30), detyrimi përmbyllës është përgatitja e mikrotezës/diplomës në mënyrë individuale nga studentët.</p> <p>Diplomimi në përfundim të ciklit të dytë të studimeve, Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik” realizohen me temë diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar diplomimi (neni 28, pika 2). Departamenti dhe Fakulteti vendos në dispozicion të studentëve udhëzimin për përgatitjen e mikrotezës/punimin e diplomës në përputhje me rregulloren e programit të studimit. Departamenti përcakton listën e temave të diplomave në përputhje me fushat e studimit që mbulon. Mbrojtja e diplomës bëhet përpara një komisioni, përbërja e të cilit propozohet nga departamenti përkatës dhe miratohet nga Dekani. Komisioni përbëhet nga jo</p>






	më pak se 3 anëtarë (neni 30, pika 1). Tema e diplomës vlerësohet me notë dhe me kredite ECTS sipas Planit Mësimor.
<b>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</b>	<p>Referuar RVB, strukturat përgjegjëse, (Departamenti, stafi akademik, sekretaria mësimore), udhëzojnë studentët duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të përgatitjes së mikrotezës dhe detyrimeve përmbyllëse. Kjo praktikë u konfirmua dhe gjatë takimit të GVJ me studentët dhe stafin akademik, në këtë insitucion. Sipas Rregullores së Programit të studimit (neni 28, pika 3, 4), Departamenti përcakton listën e temave të diplomave dhe të personelit akademik për udhëheqjen e studentëve në përgatitjen e mikrotezës.</p> <p>Departamenti dhe Fakulteti si njësi përgjegjëse për këtë program studimi, vendosin gjithashtu, në dispozicion të studentëve, udhëzimin për përgatitjen e mikrotezës/punimin e diplomës në përputhje me Rregulloren e Programit të Studimit. Ky udhëzues përcakton të gjitha modalitetet e nevojshme, si afatet kohore, rregullat e shkrimit për përgatitjen e mikrotezës/punimit të diplomës. Sipas rregullores, studenti është i detyruar të respektojë afatet e përcaktuara në udhëzimin e punimit të diplomës dhe sugjerimeve të udhëheqësit shkencor.</p>
<b>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</b>	<p>Sipas Rregullores së Programit të Studimit (neni 28, pika 2), citohet se detyrimet përmbyllëse për programin e studimit, MSh_PAAP, realizohen me temë diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar diplomimi. Referuar të dhënave të RVB, theksohet se deri tani, detyrimet përmbyllëse për këtë program studimi, janë realizuar me temë diplome.</p> <p><i>GVJ rekomandon që, Departamenti i Administrimit Publik, të bëj ndryshimet, në Rregulloren e Programit të Studimit_MSh_PAAP (neni 28, pika 2): paragrafi, "Studimet në këtë program studimi, përmbyllen me tezë/punim diplome", në përputhje me kriteret e Ligjit Nr. 80/2015 (neni, 75, pika 5), si dhe Rregulloren e institucionit (neni, 45), Rregulloren e njësisë kryesore (neni, 33), Rregulloren e njësisë bazë (neni, 35).</i></p>
	<p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p>





	<p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i>  <i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i>  <i>Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i>  <i>Aneks 105. Udhëzim për përgatitjen e mikrotezës/temës diplomës_Master i Shkencave_DAP_FShPJ_2022.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqërues në DVV, në rregulloren e programit të studimit dhe udhëzimit për përgatitjen e diplomës, përcaktohet se pedagogu udhëheqës asiston studentët në procesin e përgatitjes së mikrotezës/punimit të diplomës duke përcaktuar grafikun e konsultimeve përgjatë të cilave kontrollohet dhe vlerësohet, ecuria e përgatitjes së punimit dhe i udhëzon ata për elementët e nevojshme të këtij procesi, (rregullat e shkrimit, rishikimit të literaturës, metodologjisë, rezultateve dhe diskutimeve, konkluzionet dhe rekomandimet, referencat si dhe anekset përkatëse). Para mbrojtjes së diplomës, pedagogu udhëheqës rishikon punimin e kryer nga studenti dhe miraton mbrojtjen e temës diplomës duke plotësuar formularin përkatës të vlerësimit të studentit. Kjo procedurë e parashikuar në rregulloren e programit të studimit dhe në paketën orientuese u konfirmua edhe nga takimi i GVJ me stafin akademik dhe studentët gjatë vizitës në Institucion.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Referuar përcaktimeve në Rregulloren e UAMD-së, Rregulloreve të njesisë kryesore/bazë dhe Rregullores së Programit të Studimit, konstatohet se institucioni i kushton rëndësi kërkimit shkencor dhe sidomos aplikimit të saj në fazën e përgatitjes së punimit të diplomës. Vetë studentët dhe stafi i programit të studimit, gjatë vizitës në institucion u shprehën pozitivisht për mbështetjen institucionale në këtë faze, si nëpërmjet shfrytëzimit të ambienteve të institucionit, edhe aksesit në bibliotekën fizike apo online për shfrytëzimin e materialeve, por sidomos asistencës së përhershme nga stafi akademik i institucionit.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i>  <i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i>  <i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p>




	<p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 13. Strategjia e Kërkimit Shkencor të UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 105. Udhëzim për përgatitjen e mikrotezës/temës diplomës_Master i Shkencave_DAP_FShPJ_2022;</i></p> <p><i>Aneks 28. Informacion për bibliotekën online_UAMD;</i></p> <p><i>Aneks 29_Informacion për database e bibliotekës_UAMD.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Sipas, Rregullores së Programit të Studimit, (neni 30, pika 1, 2), mbrojtja e diplomës bëhet përpara një komisioni, përbërja e të cilit propozohet nga departamenti përkatës dhe miratohet nga Dekani. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë. Në përfundim të mbrojtjes së temës së diplomës, studentët vlerësohen me notë, e cila llogaritet si mesatare e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit, (neni 30, pika 3) e rregullores së programit të studimit). GVJ gjatë vizitës në Institucion, konfirmoi pranë sekretarisë mësimore, vlerësimet me notë të studentëve dhe regjistrin e arritjeve akademike.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 105. Udhëzim për përgatitjen e mikrotezës/temës diplomës_Master i Shkencave_DAP_FShPJ_2022.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Rregullorja institucionale e UAMD-së (neni 90), Rregulloret e njesisë kryesore/bazë si edhe Rregullorja e Programit të Studimit, përcaktojnë se studentët e këtij programi, të cilët përfundojnë me sukses studimet, pajisen nga fakulteti me diplomën, Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik”.</p> <p>Në përfundim të studimeve, sipas kërkesës së tyre, studentëve i vihet në dispozicion një kopje zyrtare e dokumentacionit për programin e studimit që kanë kryer.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me</p>	<p>Bazuar në rregulloren e UAMD-së dhe rregulloret e njesisë kryesore/bazë si dhe në zbatim të kriteve dhe udhëzimeve të</p>




<p>legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>MAS, diploma për programin e studimit, Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik”, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe regjistrin shtetëror të çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore të MAS. Diploma për studentët e programit të studimit Master i Shkencave në PAAP, shoqërohet me listën e notave si dhe suplementin e diplomës. Në përfundim të studimeve, studentëve sipas kërkesës së tyre i vihet në dispozicion një kopje zyrtare e dokumentacionit për programin e studimit që kanë kryer (syllabuset e lëndëve, bashkë me suplementin e diplomës). Dokumentacioni në hard copy, ruhet dhe administrohet nga sekretaria mësimore e fakultetit. Institucioni disponon, informacione dhe të dhëna për studentët në përputhje me rregullat dhe kriteret e përcaktuara.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit_MSh_PAAP.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ nga shqyrtimi i rregulloreve përkatëse konstaton se, janë përshkruar dhe përcaktuar në mënyrë të detajuar, procedurat që ndiqen për detyrimet përmbyllëse të programit të studimit. Diplomimi për programin e studimeve, Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik”, referuar Rregullores së Programit të Studimit, bëhet me temë diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar diplomimi. Mikroteza/tema e diplomës përgatitet nga studenti, nën mbikqyrjen e një pedagogu udhëheqës nga departamenti. Mbrojtja e diplomës bëhet përpara një komisioni dhe vlerësohet me notë. Në përfundimin me sukses të studimeve, studenti pajiset nga fakulteti me diplomën, Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik”, listën e notave dhe suplementin e diplomës. Dokumentacioni në hard copy, ruhet dhe administrohet nga sekretaria mësimore e fakultetit. Institucioni disponon, informacione dhe të dhënat për studentët në përputhje me rregullat dhe kriteret e përcaktuara.</i></p>




Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	


### Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqëruar në DVV, konstatohet se në kurrikulën dhe planin mësimor të programit të studimit_MSh_PAAP përfshihet dhe praktika profesionale si lëndë e kategorisë D, (në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41 të ndryshuar me VKM nr. 879) që zhvillohet në semestrin e katërt të studimeve dhe vlerësohet me 12 kredite. Nga verifikimi i dokumentacionit shoqëruar (Rregullores së UAMD-së, Rregulloreve të njësisë kryesore/bazë dhe Rregullores së Programit të Studimit), GVJ konstatoi se; është përcaktuar në mënyrë të detajuar, organizimi dhe zhvillimi i praktikave profesionale për këtë program studimi. Kohëzgjatja e praktikës është jo më e shkurtër se 2 (dy) muaj. Në përputhje me fushën e programit të studimit, institucioni dhe departamenti u ofron studentëve listën e institucioneve me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikës profesionale. Pas përfundimit të praktikës nga studenti, paraqitet vërtetimi dhe raporti i praktikës, me firmën dhe vulën e titullarit të institucionit. Më pas studenti bën mbrojtjen e saj përpara një komisioni, përbërja e të cilit propozohet nga departamenti përkatës. Procedurat e zhvillimit të praktikës janë të përcaktuara dhe në udhëzimin përkatës.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të</p>	<p>Referuar dokumentacionit shoqëruar, GVJ konstaton se, UAMD bashkëpunon me një sërë institucione publike, jopublike dhe aktorë të tjerë në vend. Këto marrëveshje bashkëpunimi përveç aspekteve të tjera, garantojnë dhe u ofrojnë mundësi studentëve që të zhvillojnë praktikat profesionale me qëllim pajisjen e tyre me aftësi praktike dhe kompetenca profesionale, në përputhje me objektivat e programit të studimit dhe kërkesat e tregut të punës.</p>




njohurive dhe kompetencave profesionale.	Gjatë takimit të GVJ me studentët, ata u shprehën pozitivisht për mbështetjen që kanë pasur nga stafi akademik dhe institucioni, për kryerjen e praktikës profesionale në këto institucione.
<b>Kriteri 3. Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</b>	<p>Në kurrikulën dhe planin mësimor të Programit të studimit MSh_PAAP, përfshihet dhe praktika profesionale si lëndë plotësuese e kategorisë D, e cila zhvillohet në semestrin e katërt dhe ka 12 kredite. Në Rregulloret e njesisë kryesore/bazë dhe Rregullores së Programit të Studimit, është përcaktuar në mënyrë të detajuar, organizimi dhe zhvillimi i praktikave profesionale për këtë program studimi. Referuar rregullores së programit të studimit dhe udhëzimit për kryerjen e praktikës profesionale, pas përfundimit të praktikës nga studenti, paraqitet vërtetimi dhe raporti i praktikës, me firmën dhe vulën e titullarit të institucionit. Për mbrojtjen e praktikës, studenti prezanton dhe mbron raportin e praktikës përpara komisionit përkatës. Vlerësimi bëhet, bazuar në njohuritë dhe aftësitë që studentët kanë përfituar gjatë kryerjes së praktikës, duke marrë në konsideratë edhe mendimin e supervisorëve përkatës.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e UAMD-së;</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e Njesisë Kryesore/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Njesisë Bazë (DAP)/FShPJ;</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e Programit të Studimit MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mësimor i Programit të Studimit MSh_PAAP;</i></p> <p><i>Aneks 105. Udhëzim për kryerjen e praktikës profesionale_Master i Shkencave_DAP_FShPJ_2022;</i></p> <p><i>Aneks 72. Lista e marrëveshjeve me IAL&amp;institucione partnere.</i></p>
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Referuar dokumentacionit shoqërues GVJ, konstaton se në kurrikulën dhe planin mësimor të programit të studimit MSh_PAAP, përfshihet dhe praktika profesionale, që zhvillohet në semestrin e katërt të studimeve dhe vlerësohet me 12 kredite. Në Rregulloren e Programit të Studimit, është përcaktuar në mënyrë të detajuar, organizimi dhe zhvillimi i praktikave profesionale për studentët e këtij program studimi. Në përputhje me fushën e programit të studimit, institucioni dhe departamenti u ofron studentëve listën e institucioneve dhe organizatave partnere me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi</i></p>





	<i>për kryerjen e praktikës profesionale. Pas përfundimit të praktikës profesionale, studenti bën mbrojtjen e saj, përpara një komisioni përkatës. GVJ konfirmon, se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë	Referuar vlerësimin të dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konfirmon se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në "Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik" i përshtaten kërkesave të këtij programi studimi, kjo në përputhje me VKM Nr. 418, datë 10.5.2017, ku saktësohet se njësi bazë duhet të ketë në përbërje të tij, të paktën, 7 anëtarë me kohë të plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të jenë me gradë shkencore ose titull akademik. Këto të dhëna përfshijnë personelin akademik (PAE dhe PAK), sikurse dhe personelin administrativ. Në këtë program studimi janë angazhuar lektore me tituj dhe grada shkencore sipas kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në




kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Instituconet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në Rregulloren e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, janë parashikuar të gjitha modalitetet që sigurojnë zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Instituconet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” për rekrutimin dhe punësimin e personelit akademik me nivelin e duhur të kualifikimit akademik dhe fushën kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. Ky vlerësim bazohet në shqyrtimin e dosjeve të personelit në zyrën e Burimeve Njerëzore dhe në takimin e drejtpërdrejtë me stafin akademik dhe atë ndihmës në UAMD, ku titullarët e lëndëve janë me gradën shkencore Dr. ose të kategorisë profesor. Fusha akademike e lektorëve të angazhuar në programin MSh\_PAAP është në përputhje me modulet dhe lëndët ku ata janë aktivizuar. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie ka një eksperiencë disavjeçare edhe në fushën kërkimore. (Evidencë 114\_CV e personeli Akademik).

Kjo vërtetohet edhe nga shqyrtimi që GVJ u bëri dosjeve të personelit akademik, CV akademike të tyre, me angazhime si botime, grupe kërkimore e shkencore sipas fushave specifike që mbulojnë. Të dhënat për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik (PAE dhe PAK) për programin e studimit, MSh\_PAAP, sipas viteve akademike, paraqiten si më poshtë:


Kualifikimi i stafit akademik	2022-2023		2021-2022		2020-2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	2	1	1	1	1	1
Prof. Asoc.	3	1	3	1	2	1
Dr./PhD.	5	-	5	1	6	1
MSc.	-	1	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>10</b>	<b>3</b>	<b>9</b>	<b>3</b>	<b>9</b>	<b>3</b>

**Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e

Institucioni zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik në përputhje me bazën ligjore në fuqi, sikurse dhe me aktet e brendshme rregullatore. Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit



<p>studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>MSh_PAAP, në përputhje me Udhëzimi Nr.29 datë 10.9.2018 të MAS, si edhe në Rregulloren e UAMD neni 107), duke respektuar kriterin e numrit të lëndëve (tre) dhe normës mësimore. Të dhënat që ka paraqitur DAP për planifikimin e ngarkesës për çdo vit akademik dhe për realizimin e ngarkesës mësimore tregojnë qartë respektimin e kornizës ligjore në fuqi.</p> <p>Niveli i kualifikimit dhe fushat akademike-kërkimore të tyre i përgjigjen natyrës dhe specifikave të lëndëve e moduleve që ata zhvillojnë</p> <p><i>Evidenca 3 _Rregullore e UAMD;</i></p> <p><i>Evidencë 99 _Lista e Stafit Akademik në këtë program studim;</i></p> <p><i>Evidencë 114 _CV e stafit akademik _DAP _FSHP</i></p> <p><i>Evidenca Nr. 90,91,91 _Tabelat e përlllogaritjeve të orëve dhe Vendimi i DAP për ndarjen e lëndëve sipas fushave</i></p> <p><i>Evidenca 142 _Vendim i DAP për kriteret e rekrutimit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>GVJ shqyrtoi, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni në sistemin AMS të ASCAL (DVV) dhe në mënyrë të veçantë, Rregulloren e UAMD-së, Rregulloren e programit të studimit MSh_PAAP, Statutin dhe Planin e Zhvillimit Strategjik, dhe konstaton se UAMD, ka një përvojë të konsiderueshme dhe burime e duhura në fushën akademike në përputhje me qëllimin kryesor të këtij institucioni, përcjelljen e dijes tek studentët. UAMD, FShPJ dhe DAP, dëshmojnë se kanë kapacitetet e duhura në fushën akademike, mësimdhënëse për ofrimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik”.</p> <p>Të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, mblihen dhe përditësohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Departamenti. Këto të dhëna përfshijnë personelin akademik (PAE dhe PAK), sikurse dhe personelin administrativ. Sektori i Burimeve Njerëzore ruan kopjet e dokumentacionit, ndërsa dokumentet origjinale ose të noterizuara mblihen në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore (njësi në nivel universiteti)</p> <p><i>Evidencë 1 _Statuti i UAMD;</i></p>




	<p><i>Evidencë 3_Rregullore e UAMD;</i></p> <p><i>Evidencë 8_Rregullore e FSHPJ;</i></p> <p><i>Evidencë 19_Rregulllore Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>UAMD rekruton personel akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ në përputhshmëri të plotë me Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” (nenet 64-67), Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, Rregulloren dhe Statutin e UAMD.</p> <p>Rregullorja për rekrutimin e stafit përmban të gjitha procedurat që duhet të ndiqen për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës mësimor dhe administrativ. I gjithë procesi i rekrutimit dhe vlerësimit konform kriterëve të shpallura, ndiqet dhe vlerësohet nga drejtoria e specializuar për këtë proces DBNJ, e fillon procesin pasi merr kërkesën nga njësia bazë. Në Statutin e UAMD, Rregulloren e Përgjithshme të UAMD dhe Rregulloret e tjera përcaktohen qartë të gjitha procedurat për rekrutimin e stafit akademik për realizimin e programit të studimit. Përzgjedhja e personelit akademik të angazhuar në realizimin e këtij programi studimi është bërë sipas nevojave të Departamentit, i cili ka përcaktuar paraprakisht me vendim të veçantë kriteret specifike për vendet e punës. GVJ konfirmon që institucioni ka miratuar dhe zbaton me rigorozitet procedura rekrutimi dhe vlerësimi, të cilat garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e kërkuar të kualifikimit.</p> <p><i>Evidencë 138_Kontrata e punës per personelin akademik;</i>  <i>Evidencë 3_Rregullore e UAMD, Neni 103,104;</i></p> <p><i>Evidencë 1_Statuti UAMD;</i></p> <p><i>Evidencë 99_Tabela e personelit akademik;</i></p> <p><i>Evidencë 76_Njoftim në faqen zyrtare për rekrutim;</i></p> <p><i>Evidencë 142_Vendime DAP për kriteret e rekrutimit;</i></p> <p><i>Evidencë 5_Ligji Për arsimin e lartë në RSH 80/2015</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit</p>	<p>Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, siguron punësimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm për mirëmbajtjen dhe realizimin e orëve laboratorike dhe të mjediseve të tjera</p>




<p>ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>mësimore referuar rregullores së institucionit dhe strukturës organizative të tij. Numri i personelit ndihmës akademik i angazhuar në këtë program, studimi është 1 (një).</p> <p><i>Evidenca 3, Kreu II, Struktura Organizative e UAMD_ Rregullore e UAMD</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike (DBNjJ) përgatit dhe ruan përskrimet e punës, bashkëpunon me Rektoren dhe Administratorin për plotësimin e vendeve të punës sipas strukturës së miratuar si dhe ndjek zbatueshmërinë e procedurave të punësimit të personelit të deri në firmosje të kontratës së punës; kjo zyrë ruan të dhënat zyrtare sipas akteve ligjore në fuqi. Mbledhja e të dhënave bëhet mbi bazën e një formulari tip, i cili plotësohet nga personeli me kohë të plotë dhe të pjesshme. Ruajtja e të dhënave të personelit bëhet me një dosje personale fizike, që përditesohet në bazë të informacionit të paraqitur në Zyrën e Burimeve Njerëzore.</p> <p>GVJ kontrolloi në mënyrë rastësore dosje të personelit akademik dhe evidentoi se dokumentacioni i tyre ishte i plotë dhe i përditësuar sipas legjislacionit dhe rregulloreve të institucionit.</p> <p><i>Evidencë 19_ Rregullore Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe juridike;</i></p> <p><i>Evidencë 126_ Rregullore për menaxhimin e aktiviteteve kërkimore shkencore;</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën</p>	<p>Të dhënat e paraqitura për këtë program studimi tregojnë se UAMD, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, në funksion të realizimit të programit të studimit Master i Shkencave në "Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik. Kapacitetet e UAMD-së dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike në përmbushje të praktikës profesionale dhe në funksion të punimit të temës së diplomës. Në kuadër të procesit të kryerjes së praktikës profesionale,</p>




<p>profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>UAMD dhe DAP janë angazhuar në realizimin e marrëveshjeve me organizata të ndryshme në nivel vendor apo qëndror.</p> <p><i>GVJ rekomandon vijimin e angazhimit nëpërmjet marrëveshjeve me palët e treta për të mundësuar e udhëhequr praktikën e studentëve, kjo nëpërmjet marrëveshjeve të cilat adresojnë në mënyrë specifike këtë program studimi.</i></p> <p><i>Evidencë 71_Liste of ILA, Interinstitution agreement;</i></p> <p><i>Evidencë 72_Liste MoU per publikim;</i></p> <p><i>Evidencë 105_Paketa e udhëzimeve për praktiken mësimore dhe diplomën master 2022</i></p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Një rëndësi e veçantë i kushtohet aftësimin të studentëve për të realizuar jo vetëm aplikimin e njohurive praktike, por edhe zhvillimin e mendimit kritik si dhe të aftësive kërkimore të tyre. Në ambjentet pritëse pranë cdo institucioni pjesë e marrëveshjeve të bashkëpunimit, caktohet një person me cilësinë e përgjegjës për ndjekjen e praktikave profesionale të studentëve, i cili harton një raport formal mbi angazhimin e studentëve në praktikat mësimore. Studentët që ndjekin këtë program studimi, janë përgjithësisht pa shikim nga puna. Ata ndjekin programin në ditë të caktuara të javës dhe mbas orarit zyrtar të punës. Ndjekja e praktikave dhe marrja e njohurive praktike prej tyre është e garantuar. Raporti përfundimtar përpilohet e dorëzohet. Vlerësimi final hidhet në procesverbalin përkatës.</p> <p><i>Evidencë 105_Paketa e udhëzimeve praktike dhe për diplomën master 2022,</i></p> <p><i>Evidencë 71_Liste of ILA, Interinstitution agreement;</i></p> <p><i>Evidencë 72_Liste MoU për publikun</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Personeli akademik që mbulon programin e studimit ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. GVJ eidenton se në të dhënat e paraqitura nga IAL lidhur me personelin akademik ka disa pasaktësi/mospërputhje, të cilat, në mënyrë të përmbledhur jane paraqitur me lart..</i></p>




Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe vëzhgimit të infrastrukturës në funksion të programit të studimit, u konstatua se procesi mësimor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve dhe në përputhje me fushën e programit të studimit. FShPJ, pjesë e të cilit është dhe DAP i cili ofron këtë program studimi e zhvillon procesin mësimor dhe veprimtarinë akademike në Godinën Nr. 2 të Kampusit Universitar, Spitallë. Në këtë Fakultet procesi mësimor kryhet në 17 auditorë me kapacitet total 1235 vende dhe me sipërfaqe totale 1691 m<sup>2</sup>, dhe 1 laborator me kapacitet 10 vende dhe sipërfaqe 20.5 m<sup>2</sup> (Klinika e Ligjit). Gjithashtu ka në dispozicion 26 zyra me sipërfaqe totale 541.9 m<sup>2</sup>. Për aktivitete të ndryshme disponon salle konferencash me kapacitet 200 vende dhe me sipërfaqe prej 192.8 m<sup>2</sup>. Fakulteti ka në dispozicion biblioteke me sipërfaqe 46 m<sup>2</sup>.</p> <p>GVJ konstaton se këto mjedise, të cilat janë edhe të pajisura me infrastrukturën IT (kompjuter, projektor, sistem audio), janë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në përputhje me natyrën e programit në fushën e shkencave të administrimit publik.</p> <p><i>Evidencë 67_Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit;</i></p> <p><i>Evidencë 68_Të dhëna për kapacitetin e Godinës Nr.2 Kampus</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise</p>	<p>Mjediset mësimore janë të pajisura me pajisjet e nevojshme elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, dhe konsiderohen të përshtatshme në funksion të përbushjes së</p>




<p>të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>objektivave të programit të studimit. Sallat janë të pajisura me kompjuter, video-projektorë, internet, sistem fonie dhe sistem kondicionimi.</p> <p><i>Evidencë 67_Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Laboratori i IT sikurse dhe ambientet e bibliotekës konsiderohen të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimit, nisur nga vetë natyra e këtij programi. Laboratori përdoret për të aksesuar informacion, për të përgatitur prezantime dhe detyra kursi, etj., ndërsa biblioteka përdoret si për aksesimin e literaturës fizike ashtu edhe asaj elektronike.</p> <p><i>Evidencë 67_Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit;</i></p> <p><i>Evidencë 27,28,29_Biblioteka online, Të dhëna për bibliotekën online</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Laboratori i IT është i pajisur me programet e paketës Microsoft Office, të cilat mund të përdoren nga studentët e këtij programi studimi. Për shkak të natyrës së programit të studimit, ku nevoja për programe profesionale është relativisht e kufizuar, GVJ konstaton se kapacitetet ekzistuese janë optimale për këtë program studimi.</p> <p><i>Evidencë Vizita në institucion, vëzhgimi i mjedisëve</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset</p>	<p>Nga vizita në institucion, vëzhgimi i infrastrukturës, konstatohet se institucioni garanton kapacitetet dhe mjediset e nevojshme, për zhvillimin e veprimtarive praktike (të cilat lidhen kryesisht me përgatitje prezantimesh, detyra kursi, etj. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në DVV lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit, GVJ konstatoi se institucioni ka një numër të konsiderueshëm marrëveshje bashkëpunimi në funksion të realizimit të praktikave profesionale për studentët me qëllim</p>




<p>janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulate me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>plotësimin e objektivave të programit mësimor. UAMD bashkëpunon gjithashtu dhe me një sërë institucione publike, dhe jopublike në vend si dhe aktorë të tjerë si, (Kuvendi i Shqipërisë, KLSH, Këshillit të Qarkut, Durrës, Autoriteti Portual Durrës, Dhoma e Tregtisë, etj.)</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konfirmon se UAMD disponon një kampus universitar me mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit. UAMD dhe DAP për formimin praktik të studentëve sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit kanë nënshkruar një sërë marrëveshjes me institucione publike, biznese dhe organizata.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

**Standardi IV.3**

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse, pjesë e fondit të bibliotekës në dispozicion të fushës studimore të këtij programi studimi vlerësohet si i përshtatshëm. Biblioteka ka hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. Sektori i IT mundëson integrimin e teknologjisë së informacionit në Bibliotekën Shkencore në bashkëpunim me Drejtorin e Bibliotekës. Ai administron dhe kujdeset për funksionimin e mirë të rrjetit të bibliotekës, të dy sistemeve.</p>




	<p><i>Evidencë 26_Rregullore e Bibliotekës UAMD;</i></p> <p><i>Evidencë 28_Biblioteka online, të dhëna mbi materialet e disponueshme;</i></p> <p><i>Evidencë 29_Informacion për bibliotekën</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Shtimi i zërave të bibliotekës është një proces periodik, bazuar mbi kërkesat e departamentit dhe personelit akademik, sipas një plani të detajuar për këtë qëllim. Përditësimi i fondit ekzistues në mbështetje të programit të studimit iniciohet nga personeli akademik, nisur nga nevojat e evidentuara në bazë të literaturës së nevojshme për lëndët e tyre. Gjithashtu në Rregulloren e Bibliotekës së UAMD përcaktohet politika e pasurimit të saj për mbështetjen e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor nëpërmjet, blerjeve, dhuratave, projekteve dhe shkëmbimit midis bibliotekave. Kërkesa i përcillet drejtuesve të njësisë bazë/kryesore, dhe në bashkëpunim me Administratorin e njësisë kryesore, fillojnë procedurat për blerjen e literaturës së nevojshme.</p> <p><i>Evidencë 26_Rregullorja e Bibliotekës UAMD;</i></p> <p><i>Evidencë 27_Biblioteka online (manual);</i></p> <p><i>Evidencë 28_Biblioteka online(të dhëna për materialet e disponueshme);</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson si të përshtatshme bibliotekën mësimore me një sipërfaqe 46 m<sup>2</sup> në godinën Nr 2 të kampusit universitar, si në aspektin e kapaciteteve akomoduese (poste leximi dhe kompjuter) ashtu edhe në aspektin e fondit fizik të literaturës në dispozicion. Biblioteka është në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Salla është në shërbim të plotë të studenteve, pedagogëve e studiuesve çdo ditë të javës, nga ora 8:00-16:00. Këto elemente garantojnë mundësinë e shfrytëzimit të bibliotekës në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit MShAP.</p> <p><i>Evidencë 66,67,68_Të dhëna për infrastrukturën</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond</p>	<p>Biblioteka e kampusit universitar UAMD ofron literaturë mësimi për programin e studimit MSHAP. Krahas librit fizik</p>






<p>fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>(mbi 12.000 njësi bibliotekare) ajo ofron edhe librin elektronik Krahas librit fizik, ofrohet edhe libri elektronik, i ruajtur në CD, server, hard disk i jashtëm (mbi 10000 tituj). Biblioteka është e pajisur me pajisje teknologjike që mundësojnë kërkimin e shpejtë të literaturës fizike e digjitale. Studentët kanë akses në EBSCO dhe JSTOR, i cili ofron mbi 170 mijë libra elektronike nga Universitetet më prestigjioze të botës, mbi 6 mijë periodike dhe revista të Web of Science apo Scopus. UAMD është gjithashtu pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike on line) një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore. Si anëtare te Konsorciumit të Bibliotekave Akademike në Shqipëri, përmes projektit ERA2012 (Electronic resources for Albania) lexuesit përfitojnë akses në një gamë të gjerë të burimeve elektronike me tekst të plotë. UAMD fitoi statusin “EU Info Point” me anë të së cilës mbërrijnë në bibliotekën e UAMD periodikisht publikime nga Zyra e Publikimeve të BE-së në Luksemburg. Biblioteka e UAMD është pjesë e ALASE (Albanian Academic Research Engine).</p> <p><i>Evidenca 26_Rregullorja e Bibliotekes UAMD;</i> <i>Evidencë 29.1_Kalendari i funksionimit të bibliotekës në fundjavë;</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka mësimore vlerësohet si e përshtatshme, si në aspektin e kapaciteteve akomoduese (poste leximi dhe kompjuter) ashtu edhe në aspektin e fondit fizik të literaturës në dispozicion. Bibliotekat në UAMD shfrytëzohen prej studentëve pa pagesë Këto element garantojnë mundësinë e shfrytëzimit të bibliotekës në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 26_Rregullorja e Bibliotekes UAMD</i> <i>Anekset, 27, 28, 29 Aksesit në bibliotekat online</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë</p>	<p>Biblioteka e UAMD është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që ofrojnë një shfrytëzim maksimal për të gjithë studentët. Koleksioni përpunohet nga ana shkencore bibliografike konform standardeve ndërkombëtare duke përdorur UDC (sistemi i klasifikimit), ISBD (International Standard Bibliographic Description), formatin MARC, Z39.50</p>




<p>shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>SRU. Për të aksesuar shërbimin e libraries digjitale, fillimisht aksesohet në linkun: <a href="https://ulibrary.rash.al/">https://ulibrary.rash.al/</a> dhe Faqja kryesore e shërbimit përmban krahas një videoje informuese dhe hapat kryesore që duhet të ndiqen.</p> <p><i>Evidenca 26_Rregullore e bibliotekës UAMD;</i>  <i>Evidencë 27,28,29_Bibliteka onlinë</i>  <i>Procesverbali i vizitës në institucion;</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Sikurse u konfirmua nga biseda e GVJ me punonjësen e bibliotekës dhe studentët e këtij programi studimi, Biblioteka ishte në dispozicion të studentëve në oraret e funksionimit të UAMD, sipas nevojave të studentëve, madje edhe përtej tyre në fundjave.</p> <p><i>Evidenc 29.1_Kalendari i funksionimit të Bibliotekës në fundjavë.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe</p>	<p>GVJ gjatë takimit me stafin akademik të këtij programi studimi, ju konfirmua se ka një planifikim vjetor për blerjen e literaturave bashkëkohore për realizimin e programit të studimit, për shtimin dhe përditësimin e zërave të bibliotekës. Pas takimit me punonjësen e bibliotekës konstatuam se vitet e fundit nuk ka pasur shtim të librave fizike, pasi vemendja ka qenë në bibliotekën online. Shtimi i zërave të bibliotekës duhet të jete një proces periodik, bazuar mbi kërkesat e departamentit dhe personelit akademik, sipas një plani të detajuar për këtë qëllim. Me shfrytëzimin e sistemeve open access, biblioteka e Universitetit ka instaluar falas Katalogun Online të Integruar, për menaxhimin e fondit të saj. UAMD është pjesë e Rrjetit Akademik Shqiptar, e cila i krijon mundësinë e aksesimit në Platformën e Bibliotekës. Elektronike ULIBRARY si edhe në databazet elektronik si:</p> <p><a href="https://op.europa.eu/">https://op.europa.eu/</a>,<a href="https://www.unrisd.org/">https://www.unrisd.org/</a>,  <a href="http://www.ebsco.com/">www.ebsco.com/</a>,<a href="https://www.elgaronline.com/">https://www.elgaronline.com/</a>;  <a href="https://msp.org/publications/journals/">https://msp.org/publications/journals/</a>,  <a href="https://onlinelibrary.Wiley.com/">https://onlinelibrary.Wiley.com/</a>,  <a href="https://librarianresources.taylorandfrancis.com">https://librarianresources.taylorandfrancis.com</a>.</p>




për performancën e personelit akademik.									
<b>Konkluzione</b>	<i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, <u>GVJ konstaton</u> se DAP ndonëse referon një literaturë të pasur tek studentët për të realizuar programin e studimit, duhet të shtojë literaturën e nevojshme fizike të përditësuar në bibliotekën e tij në mbështetje të mësimdhënies. Biblioteka ka pasur prurjet e fundit me libra fizike në vitin 2016. Mundësitë me literaturat online janë të pëlqyeshme, si për stafet akademike edhe për studentët e Masterit Shkencor. Aksesi në to është i njëjtë për të gjithë, si në mjediset e brendshme të UAMD, ashtu dhe në ato të jashtme të kampusit të ri universitar.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Gjatë vizitës në institucion, nga përfaqësuesit e sekretarisë mësimore u deklarua se institucioni ka aktualisht një sistem menaxhimi (Sistemi PITAGORA) i cili administron informacionin që lidhet me studentët, proces i cili drejtohet nga sekretaria mësimore dhe që është i pasqyruar në rregjistrat specifik dhe dokumentacionin përkatës. GVJ vlerëson se sekretaria mësimore, disponon gjithë informacionin në lidhje me studentët, nga regjistrimi deri në diplomim nëpër regjistra të standardizuar për IAL me të dhëna të përditësuara nga gjeneralitetet si datëlindja, atësia, deri tek shkolla e mesme nga kanë ardhur, data dhe viti i regjistrimit në programin e studimit që ndjekin, notat, datën e ç'rregjistrimit dhe transferimit për ata që ndërpresin studimet ose që transferohen nga IAL të tjera, datën e diplomimit dhe kontaktet.</p> <p><i>Evidencë 45_Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH);</i></p>




	<i>Evidenca 74_Manual për funksionimin e Sekretarisë Mësimore;</i>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administro informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<p>Sistemi i menaxhimit të të dhënave të personelit, administrohet nga DBNjJ dhe DAP. DBNjJ administro të dhënat e stafit mbi kualifikimet dhe aktivitetet e tyre, kontratat e punës, CV dhe dokumentacionin shoqërues.</p> <p><i>Evidencë 1_Statuti i UAMD;</i>  <i>Evidencë 3_Rregullore e UAMD;</i>  <i>Evidencë 8_Rregullore e FShPJ;</i>  <i>Evidencë 51_Buletini i aktiviteteve për FShPJ</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	<p>Sistemi Pitagora ofron akses të dedikuar për të dhënat që kanë lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Studentët kanë akses në kurrikulat e tyre, vlerësimin për kurset e frekuentuara dhe provimet, regjistrimin dhe të dhënat e orarit mësimor etj.</li> <li>- Personeli akademik ka akses në regjistrat e seksioneve që mbulon, procesverbalet e vlerësimit të studentëve, orarin mësimor etj.</li> <li>- Sekretaria mësimore ka akses të dedikuar për orarin mësimor, listat e studentëve të regjistruar në orar, të dhënat e studentëve dhe vlerësimet e tyre, të dhënat për personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie etj.</li> <li>- Dega ekonomike ka akses në të dhënat e studentëve përsa i përket tarifave të studimit. ( <a href="https://uamd.pitagora.rash.al/login">https://uamd.pitagora.rash.al/login</a>)</li> </ul> <p>Të dhënat garantoohen si për personelin dhe studentët në mënyrë fizike dhe virtuale nëpërmjet zonës së studentit në Web e UAMD dhe në sistemin e përdorimit elektronik për stafin akademik, për fakultetet dhe programet e studimit që ofrohen. GVJ konfirmoi nga stafi akademik dhe studentët, shkëmbimin e informacionit në sistemin e përdorimit elektronik për literaturat, notat, etj. Platforma PITAGORA mundëson komunikimin interaktiv dhe transmetimin e informacionit ndërmjet studentëve dhe stafit akademik, nga lektori te studenti në konfidencialitet të plotë.</p> <p><i>Evidencë 44_Manual -Petagogu PITAGORA;</i></p>




	<p><i>Evidencë 45_Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH);</i></p> <p><i>Evidencë 46_Manula -Student PITAGORA</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konfirmoi nga stafi akademik dhe studentët, shkëmbimin e informacionit në sistemin e përdorimit elektronik për literaturat, notat, etj. Platforma PITAGORA mundëson komunikimin interaktiv dhe transmetimin e informacionit ndërmjet studentëve dhe stafit akademik, nga lektori te studenti në konfidencialitet të plotë. Të dhënat garantojnë si për personelin dhe studentët në mënyrë fizike dhe virtuale nëpërmjet zonës së studentit në Web e UAMD dhe në sistemin e përdorimit elektronik për stafin akademik, për fakultetet dhe programet e studimit që ofrohen.</p> <p><i>Evidencë 44_Manual -Petagogu PITAGORA;</i></p> <p><i>Evidencë 46_Manula -Student PITAGORA</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja zyrtare e internetit e UAMD-së përmban të gjitha informacionet mbi personalin akademik, programet e studimit, aktivitete, njoftime në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Njësia kryesore ka ngritur struktura të cilat mundësojnë monitorimin dhe raportimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ. Informacionet e lidhura me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitete të ndryshme, publikohen në faqen e internetit të institucionit .</p> <p><i>Gjatë vizitës GVJ konstatoi që departamenti nuk ka një politikë të standardizuar apo manual për publikimin, por kryesisht të gjithë aktivitetet publikohen në faqen web të institucionit.</i></p> <p><i>Evidencë 14_Strategjia e komunikimit UAMD</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ arrin në konkluzionin se Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit është i kompletuar dhe mbështetës në vijimësinë</i></p>




	<i>e aktiviteteve të instituconit për programin e studimit në proces vlerësimi.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Institucioni harton raportin financiar të kostove të programit dhe plani për mbështetjen financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit cdo vit. Ndër dokumentet kryesor të lidhur me buxhetin, rendisim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendimin e Dekanatit të FSHS për miratimin e buxhetit;</li> <li>• Pasqyrat në lidhje me pagat dhe bursat;</li> <li>• Pasqyrat në lidhje me të ardhurat e kushtëzuara;</li> <li>• Pasqyrat në lidhje me numrin e punonjësve;</li> <li>• Pasqyrat në lidhje me numrin e studentëve;</li> <li>• Regjistri i parashikimit të prokurimeve publike;</li> <li>• Pasqyrat në lidhje me investimet.</li> </ul> <p><i>Evidencë 38,39_Raporti financiar 2019-2021;</i> <i>Evidencë 89_Tabelat per kostot e programit të studimit;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e</p>	<p>Plani i financimit përmban zërat e ndryshëm, si kostot dhe shpenzimet ashtu edhe të ardhurat. Të gjithë zërat bëhen bazuar në nevojat e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, nga personeli akademik, tek infrastruktura, mbështetja financiare për kërkimin shkencor, etj. Në dokumentacionin mbi buxhetin, paraqiten elementët e lidhur me financimin e burimeve njerëzore, si për personelin akademik ashtu edhe për atë administrativ, shpenzimet operative për infrastrukturën (mirëmbajtjen dhe përmirësimin e saj), sikurse dhe shpenzimet për pasurimin e fondit të bibliotekës.</p> <p>UAMD, si një institucion publik i arsimit të lartë, i nënshtrohet të gjitha detyrimeve, sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Në</p>




<p>literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>dokumentacionin e përcjell nga IAL lidhur me buxhetin, pasqyrohet edhe raporti financiar në të cilin paraqiten të ardhurat nga tarifat e shkollimit dhe kontributet e tjera.</p> <p><i>Evidencë 38,39_Raporti financiar 2019-2021;</i>  <i>Evidencë 89_Tabelat per kostot e programit të studimit;</i>  <i>Evidencë 117_Raporti i auditit në UAMD;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Njësia e Auditimit të Brendshëm ka për detyrë realizimin e auditimit të brëndshëm, në përputhje me planet e miratuara. UAMD kryen auditim të veprimtarisë nga njësitë e auditimit të brëndshëm. Institucioni ka raporte auditimi të brëndshëm çdo vit. Auditimi financiar dhe raportimi financiar janë procedura të përvitshme të dokumentuara që dëshmojnë efektivitetin financiar të UAMD.</p> <p><i>Evidencë 38,39_Raporti financiar 2019-2021;</i>  <i>Evidencë 89_Tabelat per kostot e programit të studimit;</i>  <i>Evidencë 117_Raporti i auditit në UAMD;</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Institucioni disponon raportet financiare për çdo vit akademik. Plani i financimit hartohet në nivel institucioni dhe përmban elementët financiarë për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të programit të studimit. Institucioni raporton në mënyrë periodike për realizimin e buxhetit, për rishikimin dhe për rialokimin e buxhetit, sipas ligjit mbi buxhetin. Institucioni harton Raport Financiar, si pjesë e raportit vjetor dhe buxhetit të miratuar. UAMD raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. Institucioni disponon raportet financiare për çdo vit akademik.</p> <p><i>Evidencë 10_Plani i zhvillimit strategjik UAMD;</i>  <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e</p>	<p>Të dhënat financiare dëshmojnë se institucioni siguron qëndrueshmëri dhe kapacitete financiare për gjenerimin e të</p>





<p>programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>ardhurave gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe për të ardhmen.</p> <p>Qëndrueshmëria financiare garantohet si nga të ardhurat nga tarifatat e studentëve ashtu edhe mbështetja nga buxheti, duke qenë se IAL përgjegjëse për programin e studimit, është IAL publike dhe financohet edhe nga buxheti i shtetit.</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ arrin në konkluzionin se në UAMD financimi dhe mbështetja financiare e nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtja e programit të studimit dhe mbështetja e studentëve është e garantuar.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin</b>	<p>UAMD zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, Statutin dhe Rregulloret e UAMD.</p>







<p>e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sekretarinë mësimore dhe biseda me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstaton se, institucioni respekton legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Informacioni mbi këto procedura publikohet në ëeb-in zyrtar të UAMD dhe FShPJ dhe sqarohet në institucion për çdo të interesuar.</p> <p><i>Evidencë 1, Neni 87,88,89_Statuti i UAMD;</i>  <i>Evidencë 3. Neni 31, 32,33_Rregullore e UAMD;</i>  <i>Evidencë 8, Neni 21, 22, Rregullore e FShPJ</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni zbaton politika dhe procedura të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të barabarta, për të gjithë kandidatët për studentë, duke mundësuar ndjekjen korrekte të kandidatit që nga momenti i aplikimit, më pas regjistrimit dhe deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomim të tij. Studentët fitues përzgjidhen duke u bazuar vetëm në kriteret e përcaktuara në vendimin e Senatit Akademik të UAMD duke siguruar një vlerësim korrekt dhe të barabartë për të gjithë aplikantët.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Programi i transparencës në UAMD mbështetet në parimin e së drejtës për informim për kriteret e përgjithshme e të veçanta të çdo programi studimi që u bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Çdo fillim viti akademik, DAP propozon kriteret për përzgjedhjen e studentëve në programin MSHAP. Këto kritere pranimi miratohen me vendim të Senatit Akademik të UAMD, bazuar në propozimet e DAP dhe FShPJ, dhe publikohen në faqen online të UAMD. Faqja online e UAMD <a href="https://www.uamd.edu.al">https://www.uamd.edu.al</a> dhe broshurat informative ofrojnë informacione mbi programin e studimit, kriteret e pranimit dhe mënyrën e aplikimit. GVJ i konfirmoi këto gjatë takimit në institucion me stafin mësimdhënës në këtë program studimi si dhe studentët.</p> <p><i>Evidencë 8_Rregullore e FShPJ;</i>  <i>Evidencë 3_Rregullore e UAMD;</i>  <i>Evidencë 96_Vendim Senati për Kriteret e Pranimit te Studenteve;</i></p>




<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p><i>Evidencë 97_Vendim Senati për Kuotat;</i></p> <p>Senati Akademik i UAMD, përpara fillimit të vitit të ri akademik, publikon në faqen zyrtare, informacionin e nevojshëm që lidhet me kriteret e pranimit, përzgjedhjes së studentëve transferimit dhe njohjes të studimeve, të cilat janë të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore të institucionit. Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të njohurive janë të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore, të cilat i vihen në dispozicion studentëve në fillim të çdo semestri. Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• me provim me shkrim;</li> <li>• me detyra kursi, projekte</li> <li>• i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi.</li> </ul> <p>Në syllabuset e lëndëve janë të përcaktuara format e vlerësimit të vazhdueshëm dhe pesha specifike në përqindje e secilit prej komponentëve të vlerësimit.</p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore e DAP, Neni 36;</i></p> <p><i>Evidencë 97_Vendim Senati për miratimin e kuotave të pranimit; Evidencë 96_Vendim Senati për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve</i></p> <p><i>Evidencë 3_Rregullore e UAMD;</i></p> <p><i>Evidencë 31_Rregullore e Programit të Studimit, sikurse dhe në syllabusin e secilës lëndë;</i></p> <p><i>Evidencë 115_Syllabuset e lëndëve MSHAP</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi se informimi dhe orientimi për kandidatët për studentë apo për një publik më të gjerë, lidhur me kërkesat apo kriteret e përgjithshme e specifike, realizohet në disa forma si në takimet informuese në institucion me pedagogë të këtij departamenti; përdorimi i faqes zyrtare; rrjeteve sociale etj. Në mbështetje të Programi i Transparencës së UAMD, Njoftime nga faqja web UAMD: <a href="https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/">https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/</a>, kandidatët për studentë, të gjithë të interesuarit dhe publiku i gjerë udhëzohen përpara fillimit të çdo viti akademik në lidhje me kriteret e veçanta dhe të përgjithshme për pranimin në programin përkatës të studimit si nga ana e UAMD, FShPJ dhe DAP.</p>




	<p>Kriteret e përgjithshme për pranimin në këtë program studimi janë: mbrojtja e gjuhës së huaj (niveli B1) dhe përfundimi i ciklit të parë. Për të ndjekur Programin e studimit MSh_PAAP, studentit duhet të ketë përfituar një diplomë të ciklit të parë Bachelor dhe ka grumbulluar 180 kredite ECTS.</p> <p>Çdo kandidat është i detyruar të plotësojë këto kritere:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të ketë një diplomë të ciklit të parë të studimeve (minimumi 3 vjet) të përputhshme në masën 60 % me trungun e lëndëve të ciklit të dytë (Master i Shkencave);</li> <li>• Diplomë e arsimit të lartë e përfutur jashtë vendit e vlerësuar ekuivalente me diplomat e mësipërme sipas kuadrit ligjor në fuqi.</li> <li>• Të plotësojë kriteret akademike të vendosura nga komisioni i pranimeve të njësisë bazë;</li> <li>• Institucionet e arsimit të lartë mund të njohin kredite të përfituara në programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional”, me qëllim transferimin e tyre, në programet e studimit “Master i Shkencave”.</li> </ul> <p>Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, studentët e regjistruar në programet e studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” kanë detyrim ligjor njohjen e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian .</p> <p><i>Evidencë 1 _Statuti UAMD;</i></p> <p><i>Evidencë 5 _Ligji 80-2015 _22.07.2015, Neni 76, pika 4, Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</i></p> <p><i>Evidencë 30_ Programi i Transparencës UAMD</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik, këto kritere bëhen të qarta dhe publike. Kriteret pasi shqyrtohen në dekanat, i përcillen Senatit Akademik, i cili mer vendimin përkatës dhe publikohen në faqen zyrtare të UAMD. Për sa i përket kuotave, ato i përcillen Bordit të Administrimit për miratim.</p>





	<i>Evidencë 20_Rregullore për Studentët me Aftësi të Veçanta; Evidencë 96_Vendim Senati për Kriteret e Pranimi të Studentëve;</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Pas përfundimit të procedurës nga IAL-ja, kriteret dhe kuotat i përcillen MAS në afatet e përcaktuara. IAL ka të përcaktuara gjithashtu edhe kuota të veçanta për kandidatë të kategorive të veçanta, shtresave të marginalizuara apo kandidatë të trojeve.  <i>Evidencë 20_Rregullore për Studentët me Aftësi të Veçanta; Evidencë 96_Vendim Senati për Kriteret e Pranimi të Studentëve;</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtesa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UAMD ndjek një politikë mbështetëse për studentët e kategorive sociale të veçanta. Për këtë kategori, parashikohen kriteret për përfitimin e bursave bazuar në aktet ligjore në fuqi dhe rregulloret e brendshme të UAMD. Kriteret dhe informacioni për përfitimet publikohen nga në faqen zyrtare dhe iu komunikohen nga strukturat e UAMD të interesuarve edhe me kanale të tjera komunikimi dhe me komunikim të drejtpërdrejtë. Studentët plotësojnë Formularë Aplikimi për Trajtimin me Bursë. Kjo kategori përfiton bursë në masën 100% ose 50%.  <i>Evidenca 128_Urdhër për trajtimin me bursë të studentëve nga shtresat në nevojë;</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni ndjek dhe zbaton politika si edhe procedura të qarta, publike dhe të aksesueshme nga palët e interesuara për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi V.2


**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në DVV, por edhe takimeve në sekretarinë mësimore, GVJ konstaton se kandidatëve, që në fazën e parë të aplikimit, u ofrohet informacion lidhur me programin e studimit Master i Shkencave Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik Master i Shkencave përfshihen: plani mësimor (kurrikula), stafi akademik, koha e realizimit, koha e përgatitjes dhe e mbrojtjes së diplomës (provimit të përgjithshëm përfundimtar/mbrojtjes së tezës) Studentët e regjistruar në këtë program, njihen që në seancat e para të leksioneve, në takimet me stafin akademik, koordinatorin e programit të studimit dhe përgjegjësin e departamentit mbi kriteret dhe procedurat e përparimit të tyre akademik. Gjithashtu, studentët u shprehën se marrin informacion të vazhdueshëm nga pedagogu/ët e lëndës dhe sekretaria mësimore mbi vlerësimet përgjatë semestrit: vlerësimi i provimit të ndërmjetëm, si edhe nga koordinatori i programit. Studentët informohen në lidhje me kurset e detyrueshme dhe me zgjedhje, praktikën profesionale dhe temën e diplomës.</p> <p><i>Evidencë 31_Rregullore e Programit të Studimit;</i>  <i>Evidencë 61_Plani mësimor i programit të studimit;</i>  <i>Takimet në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>DAP ndjek dhe harton procedura mbi njohjen e transferimet e krediteve dhe mobilitetin, i bazuar tek realizimi i procedurës dhe informimit të studentëve mbi këto procese. Në rastet e transferimit të studimeve, dosja e kandidatit shqyrtohet nga një komision ad hoc, në përputhje me rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 1, Neni _Statuti i UAMD;</i>  <i>Evidencë 8 _Rregullore e FSHPJ).</i>  <i>Evidencë 31_Rregullore e Programit të Studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive</p>	<p>Informacioni gjendet nëpërmjet faqes zyrtare të UAMD, faqeve sociale të fakultetit, broshurave dhe katalogut studentor si edhe gjatë shpërndarjes dhe shpjegimit të syllabuseve.</p>




të studentëve në programin e studimit.	<i>Evidenca 74_Manual për funksionimin e sekretarisë mësimore</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>GVJ vlerëson se, bazuar në Rregulloren e Re UAMD (nenet 75-78); Rregulloren e Vjetër UAMD (nenet 56-60); rregulloren e FSHPJ, kriteret dhe procedurat e diplomimit të programit të studimit janë të përcaktuara, të kuptueshme dhe aksesueshme nga studentët duke vënë në dispozicion strukturat përkatëse përgjegjëse ashtu edhe kanale e mjete të ndryshme komunikimi.</p> <p>Baza ligjore respektive e plotë dhe e aksesueshme në nivel institucional dhe njësie përgjegjëse për programin e studimit. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua nga stafi akademik dhe drejtues, dhe u konfirmua nga studentët që ky informacion ju ishte dhënë studentëve që në fillim të vitit.</p> <p><i>Evidencë 3_Rregullore e UAMD;</i> <i>Evidencë 8_Rregullore e FShPJ;</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Institucioni kujdeset në informimin e vazhdueshëm të studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit dhe mundësitë që lidhen me të. Oferta akademike për programin e studimit promovohet nga institucioni sipas bazës ligjore në fuqi. Vlen për tu përmendur iniciativa e njësisë bazë për të vijuar procesin e promovimit tek targeti i studentëve të ardhshëm të interesuar nëpërmjet fletpalosjeve, faqes zyrtare të internetit të UAMD dhe rrjeteve sociale.</p> <p>Përveç informacioneve online, departamenti përgatit dhe shpërndan broshura të pasuar me informacionin e nevojshëm për çdo shtresë dhe grup moshë. Gjithashtu koordinatori i programit të studimi, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, merr pjesë në organizimin e veprimtarive të informimit për studentët kandidatë që dëshirojnë të regjistrohen në programin e studimit. Për informimin e studentëve mbi programin e studimit dhe mundësitë që lidhen me të kujdeset dhe shërbimi i karrierës.</p> <p><i>Evidencë 136_Java e orientimit Guida studentore;</i> <i>Evidenca 18_Rregullore Sekt. i Komunimikimit, Alumnit dhe Karrierës; https://uamd.edu.al/dokumentacioni-per-te-aplikuar; Evidencë 98_Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit</i></p>




	<i>Përshkrimi i veprimtarisë së koordinatorit të programit të studimit).</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>UAMD vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program studimi.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Përmes dokumenteve bazë, si dhe angazhimit në nivel njësie bazë, DAP përgjegjës për programin e studimit, organizohen takime informuese dhe orientuese me studentët, në të cilat prezantohen elementët e programit të studimit, plani mësimor, kohëzgjatja e programit dhe struktura, kjo në bashkëpunim edhe me personelin ndihmës administrativ. Ndërsa në fillim të çdo viti akademik të dy vitet e studimit, informohen hollësisht mbi detyrimet akademike dhe periudhën e provimeve. Informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, listën e programeve dhe të lëndëve, tarifrat e studimit, si dhe parakushtet e lëndëve gjendet gjithashtu edhe në faqen ëeb të universitetit.</p> <p>FShPJ, nëpërmjet strukturave të veta, departament, staf akademik, koordinatori programi dhe sekretari mësimore, siguron menaxhim të informacionit në lidhje me programin e studimit. Si një kanal i rëndësishëm i komunikimit dhe informimit është dhe faqja ëeb ku është i detajuar programi që po analizojmë, si: kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit MSh Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik, i cili është 2 vite akademike, e që u përkojnë 120 kredite (ECTS). Forma e studimit është me kohë të plotë. Edhe nga takimi me studentet u vu re se ata ishin të mirë</p>




	<p>informuar mbi afatin e përfundimit të studimeve si dhe organizimin e programit të tyre.</p> <p><i>Evidencë 31_Rregullore e programit të studimit;</i>  <i>Evidenca 136_Java e Orientimit dhe Guida e Studentit;</i>  <i>Vizita në Institucion, takime me studentët</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Bazuar në të dhënat nga Programi i Transparencës së UAMD, Rregullorja e programit të studimit MSh Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik, e përditësuar dhe e publikuar në faqen zyrtare web, DAP, nëpërmjet Javës së Orientimit dhe Guidës së Studentit, i orienton studentët në mënyrë të vazhdueshme. Gjatë vizitës në institucion GVJ iu konfirmua që studentët njihen që ditën e parë me rregulloren e institucionit dhe të programit të studimit. informohen në lidhje me modulet, lëndët dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit nëpërmjet koordinatorit të programit dhe pedagogëve përkatës. Në fillim të vitit të ri akademik dhe çdo fillim semestri, studentëve u vihet në dispozicion nga pedagogu i lëndës programi i lëndës/ve (ku janë specifikuar temat me literaturën e detajuar, format e vlerësimit të dijeve, etj. Gjithashtu, studentët kanë një manual siç është Guida e Studentit.</p> <p><i>Evidencë 136_Java e Orientimit dhe Guida e Studentit;</i>  <i>Evidencë 61_Plani mësimor i programit të studimit</i>  <i>Evidenca 31_Rregullore e programit të stdimit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni përmes Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës si edhe Departamentit (personel akademik) informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet në hartimin e dokumentacionit të nevojshëm (CV, letër motivimi, letër rekomandimi etj.) përmes aktiviteteve këshilluese të organizuara në mënyrë periodike. Institucioni ka krijuar një traditë me panairt e punës me rrjetin e bashkëpunëtorëve me të cilët ndërmyjetëson edhe për praktikant profesionalë, të cilat janë porta e parë e orientimit në tregun e punës. SKAK-ja ofron të gjitha llojet e shërbimeve dhe kujdesit ndaj studentëve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- orientim për karrierën;</li> <li>- këshillim për karrierën;</li> </ul>






	<p>- informim dhe asistencë për aplikim për programet e studimit; - informim dhe orientim për tregun e punës.</p> <p><i>Evidencë 21_Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit, Karrierës;</i> <i>Evidencë 22.2_Shoqata Alumni UAMD dhe Aktivitetet;</i> <i>Takime me studentë dhe ALUMNI</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në funksion të realizimit të procesit mësimor, koordinatoresha e programit të studimit, e cila koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e këtij programi, për të siguruar përmbushjen e misionit dhe objektivave të tij, së bashku me sekretarinë mësimore dhe personelin akademik dhe ndihmës akademik, u venë në dispozicion studentëve informacion të përditësuar mbi gjithë komponentët e zhvillimit dhe organizimit të procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet, si nëpërmjet komunikimeve elektronike, nëpërmjet e-mail-it zyrtar, ashtu dhe përmes komunikimeve të drejtpërdrejta me ta.</p> <p><i>Evidencë 74_Manual i funksionimit të sekretarisë mësimore;</i> <i>Evidencë 31_Rregullore e programit të studimit;</i> <i>Takimet në institucion, vizita në sekretarinë mësimore të programit të studimit;</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Studentit i ofrohet informacion i përditësuar nga faqja zyrtare web. Gjithashtu, përdoren edhe platforma të tjera bashkëkohore për të shpërndarë informacion lehtësisht të aksesueshëm dhe të detajuar lidhur me programin e studimit, në mënyrë të vazhdueshme e të përditësuar edhe në distancë. Strukturat brenda FShPJ, si dhe njësi përgjegjëse e programit të studimit DAP, ofrojnë informacionin e nevojshëm për studentët e interesuar. Gjithashtu institucioni disponon një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit për studentë, qofshin edhe në distancë duke ju mundësuar, informacion të detajuar në lidhje me programin e studimit, lëndët sipas viteve dhe semestrave, kreditet, rezultatet e marra (notat) etj.</p>




	Evidenca 74_Manual për funksionimin e sekretarisë mësimore; <a href="https://uamd.edu.al/">https://uamd.edu.al/</a> Evidencë 14_Strategjia e Komunikimit;			
<b>Konkluzione</b>	GVJ vlerëson se Institucioni ofron në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. Sistemi i brendshëm të menaxhimit të informacionit, i lehtësuar nga platformat përkatëse si Pitagora, i ofron studentëve informacion të detajuar e të përditësuar lidhur me programin e studimit, i aksesueshëm lehtësisht kudo nga ata ndodhen.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve											
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Gjatë takimeve në Sekretarinë Mësimore, GVJ-së iu vunë në dispozicion të dhëna lidhur me numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar në programin e studimit Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik. Institucioni disponon dhe ka një sistem të menaxhimit të të dhënave të studentëve, në të cilin ruhen dhe përditësohen të dhënat e tyre e nga regjistrimi deri në diplomim.</p> <p>Të dhënat për numrin e studentë të regjistruar dhe të diplomuar sipas viteve akademike për këtë program studimi paraqiten si më poshtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Viti</th> <th colspan="2">Programi i studimit MSh_PA: Profili AP</th> </tr> <tr> <th>Studentë të regjistruar</th> <th>Studentë të diplomuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Viti 2022-2023</td> <td>57</td> <td>44</td> </tr> <tr> <td>Viti 2021-2022</td> <td>51</td> <td>36</td> </tr> </tbody> </table>	Viti	Programi i studimit MSh_PA: Profili AP		Studentë të regjistruar	Studentë të diplomuar	Viti 2022-2023	57	44	Viti 2021-2022	51	36
Viti	Programi i studimit MSh_PA: Profili AP											
	Studentë të regjistruar	Studentë të diplomuar										
Viti 2022-2023	57	44										
Viti 2021-2022	51	36										




	Viti 2020-2021	42	42
	<b>Totali</b>	<b>150</b>	<b>122</b>
	<p><i>Vizita në institucion, takimi në sekretarinë mësimore;</i>  <i>Evidencë 74_Manual për funksionimin e sekretarisë mësimore;</i>  <i>Evidencë 88_Tab e numrit të studentëve;</i>  <i>Evidencë 130,131,132,133,134_Raport vjetor FShPJ dhe UAMD</i></p>		
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni mban rregullisht statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit. GVJ u njoh me statistika vjetore mbi numrin e studentëve të cilët janë regjistruar në programin e studimit nga sekretaria mësimore e cila i disponon në regjistrat themeltar sipas formateve të MAS, ashtu dhe në format elektronik. Ky numër përfshin transferimet nga programe paralele brenda IAL-së apo IAL të tjera brenda vendit, tërheqjen nga programi i studimit etj.</p> <p><i>Evidencë 74_Manual për funksionimin e sekretarisë mësimore;</i>  <i>Evidencë 88_Tab e numrit të studentëve;</i></p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Institucioni disponon dhe ka një sistem të menaxhimit të të dhënave të studentëve, në të cilin ruhen dhe përditësohen të dhënat për studentët nga regjistrimi i tyre deri në diplomim. Kjo mundëson realizimin nga ana e personave të autorizuar, të raporteve të ndryshme statistikore mbi vijueshmërinë, ndërprerjen, largimin dhe përfundimin e studimeve.</p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me sekretarinë;</i>  <i>Evidencë 74_Manual për funksionimin e sekretarisë mësimore</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit,</p>	<p>Mbështetja e procesit të kontrollit periodik është qartësisht e evidentuar në bazën ligjore në nivel institucioni e njësie. UAMD ka hartuar manualin për funksionimin e sekretarisë mësimore ku shpjegon qartë jo vetëm saktësinë për ruajtjen e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, por edhe mënyrën e kryerjes në mënyrë periodike të kontrolleve për vlerësimin e të gjitha njësive përgjegjëse për menaxhimin,</p>		

<p>etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>përfshirë sekretaritet mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit etj. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Të gjithë përdoruesit kishin akses të personalizuar sipas roleve të tyre dhe njësive përkatëse në sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve. GVJ bëri verifikime të të dhënave të studentëve të rregjistruar e të transferuar, si dhe të ecurisë akademike në mënyrë rastësore dhe nuk konstatoi mangësi.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Institucioni harton raporte me të dhëna analitike mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, si dhe ndjek punësimin e tyre përmes njësisë bazë dhe atyre mbështetëse, si ZKK, Alumni-etj.</p> <p>Nuk ka ndonjë studim të mirëfilltë të fokusuar të njësisë bazë për studentët që mbarojnë këtë program studimi edhe pse sekretaria mwsimore harton raporte, kryesisht tabela me të dhëna statistikore dhe me shifra që pasqyrojnë numrin dhe ecurinë e progresit të studentëve. Sidoqoftë, njw vlerësim i përgjithshëm i tregut, vlerësimi i deritanishëm i punësimeve të studentëve të këtij programi që janë diplomuar më parë do ishte i dobishëm për ecurinë e programit dhe Institucioni i ka kapacitetet për ta realizuar këtë aspekt.</p> <p>Evidenca _Tabelë përmbledhëse me numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar në FSHPJ 2019-2023; Evidenca Nr. 52 Statistika Studentë në DSHK 2018-2022)</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se UAMD, si institucion publik i arsimit të lartë, respekton detyrimin për të raportuar periodikisht në Ministrinë e Arsimit të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, që sigurohen nga Sekretaria Mësimore. Departamenti në kontakt të vazhdueshëm me Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës përpilon pyetësor me studentët mbi orientimin e tyre në tregun e punës, duke analizuar e diskutuar mundësitë për të ndihmuar studentët që të bëjnë lidhjen më të mirë mes përvojës së tyre aktuale akademike dhe karrierës në punë. ALUMNI evidenton të dhëna të punësimit të tyre pas diplomimit.</i></p>





Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të UAMD, janë parashikuar përfshirja dhe angazhimi i studentëve në organet vendimmarrëse si në Senatin Akademik, në Komisionin e përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në Komisionet e përhershme të njësisë kryesore etj, në të cilat marrin pjesë 1(një) deri në 2(dy) përfaqësues të studentëve me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.</p> <p><i>Evidencë 1 _Statuti i UAMD;</i>  <i>Evdencë 3 _Rregullore e UAMD;</i>  <i>Evidencë 8 _Rregullore e FShPJ;</i>  <i>Evidencë 31 _Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Angazhimi i studentëve është konkret, pasi ata janë vendimmarrës në disa struktura të universitetit. Të dhënat e mbledhura nga vlerësimet e studentëve për cilësinë e mësimdhënies përmes NjSBC, bëhen pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës. Rezultatet e këtyre instrumenteve trajtohen në nivel të strukturave drejtuese. Përfshirja e studentëve në vendimmarrje garantohet përmes përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse. Po ashtu, vlerësimi i tyre mbi procesin akademik dhe performancës së stafit akademik kryhet edhe nëpërmjet zhvillimit të pyetësorëve në fund të semestrit ose përpara fillimit të sesionit të provimeve për të marrë vlerësimet e tyre, të cilat pasi diskutohen në departament pasqyrohen në analizat dhe raportet periodike. Institucioni ka miratuar një paketë instrumentesh të cilësisë. Pjesë e GVB-së për akreditimin e programit MSh_PAAP është edhe një</p>

	<p>përfaqësues i studentëve, i cili u takua nga GVJ edhe gjatë vizitës.</p> <p><i>Evidencë 1_Statuti UAMD;</i>  <i>Evidencë 3_Rregullore UAMD;</i>  <i>Evidencë 23_NjSBC FShPJ;</i>  <i>Evidencë 93_Urdhëri i dekanit për ngritjen e grupit të NjSBC;</i>  <i>Evidencë 95_Analiza dhe Raporti Vjetor i DAP dhe programit të studimit;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Institucioni, përmes pyetësorëve të studentëve që realizohen çdo fund semestri apo përpara fillimit të sesioneve të provimeve, dy herë në vit, me secilin grup, për të gjitha lëndët dhe pedagogët, si dhe për planet mësimore të lëndëve (syllabuset), garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Në kuadër të akreditimit të programit të studimit MSh_PAAP, Institucioni ka përfshirë në grupin e punës edhe përfaqësues të studentëve për të punuar dhe dhënë kontribut në hartimin e RVB-së.</p> <p><i>Evidencë 1_Statuti UAMD;</i>  <i>Evidencë 3_Rregullore UAMD;</i>  <i>Evidencë 8_Rregullore e FShPJ;</i>  <i>Evidencë 9_Rregullore e DAP;</i>  <i>Evidencë 95_Analiza dhe Raporti Vjetor i DAP dhe programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësies/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregullorja e UAMD përcakton procedura në rast ankese nga studenti. Studenti realizon ankesën pas shpjegimeve përkatëse gjatë seancës sqaruese me pedagogun e lëndës. Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korigjimit. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe me pikët në çdo rubrikë. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorigjuara apo pikë të pa llogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim tek Drejtuesi i Njesisë Kryesore brenda 72 orëve nga marrja në dijeni e rezultetit të provimit. Institucioni nëpërmjet NjSBC-së përdor metoda të drejtpërdrejta dhe mjete të tërthorta vlerësimi, ku studentët kanë mundësi të shprehin mendimin, vlerësimin dhe kërkesat e tyre duke plotësuar formularët, ku vlerësojnë</p>




	pedagogun, lëndën, stafin administrativ, etj. Të cilët realizohen në javën e fundit të çdo semestri.			
	<i>Evidencë 3_Rregullore UAMD;</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se ka një harmonizim ndërmjet bazës ligjore e parashikimeve përkatëse në të me proceduat rutinë të përfaqësimit e integritit të zërit studentor në funksion të përmirësimit të cilësisë në aspektin e mësimdhënies, vendimmarrjes, ofertës akademike në tërësi, për programin e studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.6

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	UAMD ka krijuar strukturat dhe procedurat e posaçme me qëllim informimin dhe shërbimin ndaj studentëve si Zyra e Këshillimit të Karrierës, Zyra e informacionit, Sekretaria Mësimore, por edhe stafet akademike të këtij program studimi, me të cilët GVJ pati takime ne institucion. Ato kryejnë funksione në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të UAMD, për shërbimet e kërkuara nga studentët që nga regjistrimi, deri në diplomim.
	<i>Evidencë 1_Statuti i ri i UAMD;</i> <i>Evidencë 3_Rregullore e UAMD;</i>




	<p><i>Evidencë 18_Rregullore Sekt. i Komunikimit, alumnit dhe Karrierës;</i></p> <p><i>Evidencë 31_Rregullore e programit të studimit;</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Të gjitha shërbimet e strukturave administrative në UAMD, si dhe zyrave në shërbim të studentit janë tregues i një sistemi të posaçëm për informimin, këshillimin dhe përparimin e studentëve. GVJ konfirmon se studentët marrin gjithë shërbimet e kërkuara që nga informimi, këshillimi dhe asistimi për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, si dhe për aktivitete e shërbime brenda e jashtë institucionit, për mbarëvajtjen e jetës së tyre studentore.</p> <p><i>Takime në institucion me studentët, përfaqësues së zyrës së këshillimit dhe karrierës</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni përmes zyrës së Këshillimit dhe Karrierës, mbështet çdo studentë aktual apo dhe të diplomuar, të këtij program studimi, nëpërmjet informimit, orientimit, trajnimit dhe këshillimit, që dhe pas diplomimit të shfrytëzojnë kapacitetet e tyre intelektuale për zhvillimin e një karriere sa më të suksesshme e për të qenë sa më konkurrues për tregun e punës. Gjithashtu kjo njësi, informon studentin e vitit të fundit për mundësinë e arsimimit të mëtejshëm dhe zhvillimit profesional.</p> <p><i>Evidencë 18_Rregullore e Sektorit të Komunikimit, alumnit dhe Karrierës;</i></p> <p><i>Evidenca 22.1_Shoqata Alumni UAMD dhe Aktivitetet;</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e</p>	<p>Zyra e Këshillimit dhe Karrierës mban kontakte të vazhdueshme me studentët edhe pas diplomimit duke aktivizuar edhe rrjetin alumnin bazuar në Rregulloren e Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës. Sektori i Komunikimit, Alumnit &amp; Karrierës ofron jo vetëm vendosjen e kontakteve me Alumnit e UAMD me qëllim gjurmimin dhe mbledhjen e informacioneve mbi punësimin e tyre duke evidentuar rastet e suksesit si dhe duke i ardhur në ndihmë atyre që janë të papunë për t'i informuar mbi mundësi punësimi dhe praktikash, por edhe ftesën për Alumnit e suksesshëm për të zhvilluar orë të hapura leksioni apo</p>






<p>autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>seminaresh për studentët ku të tregojnë mbi eksperiencat e tyre profesionale dhe karrierën e tyre të suksesshme. Duhet thënë që ndonjëherë këto kontakte nuk ishin të nevojshme pasi disa prej studentëve që ndiqnin këtë program studimi ishin të punësuar në sektorin publik dhe jo vetëm.</p> <p>Ish studentët (alumni), që kanë arritur një nivel të lartë profesional, propozohen për “Çmimin e Karrierës”, i cili synon të promovojë arritjet e tyre dhe të shërbejë si shembull për të gjithë ata që do të mbarojnë studimet pranë UAMD siç evidentohet në Raportin e Sektorit të Karrierës dhe Alumnit.</p> <p><i>GVJ konfirmon që zyra nuk ka mundur të zhvillojë çdo vit vrojtimin me studentët e diplomuar, pasi stafi në dispozicion nuk ishte i mjaftueshëm dhe nuk mund të realizohej një gjurmim i tillë për të gjithë programet.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se UAMD ka një dokumentacion që detajon kërkesat ligjore për përcaktimin e procedurave e strukturave të posaçme për informimin, orientimin, këshillimin dhe mbështetjen e studentëve. Krahas dokumentacionit, ka struktura funksionale. Në sferën akademike, Departamenti dhe stafet akademike ndihmojnë për të orientuar e bashkëpunuar ngushtë me studentët. Zyra e Këshillimit, Alumnit dhe Karrierës ofron shërbime këshillimore dhe orientuese në dobi të karrierës së studentëve dhe të punësimit. Sekretaritetë sigurojnë shkëmbimin e informacionit me studentët për notat, kreditet, transferimet, etj.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X


## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



113




**Standardi VI.1**

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Në Statutin dhe Rregulloren e institucionit, Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë është parashikuar në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Në statutin e Institucionit (<i>Evidencë 1_Statuti i UAMD</i>) janë të përcaktuara strukturat dhe procedurat për realizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>Vlerësimi i brendshëm i cilësisë mbështetet në manualin për sistemin e brendshëm për sigurimin e cilësisë në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike. UAMD përdor një udhëzues për personelin akademik për metodat e ndryshme dhe inovative të mësimdhënies bazuar në rregulloren e Qendrës për Edukim në Vazhdim. Kjo njësi organizon gjatë vitit akademik trajnime për personelin akademik në lidhje me metodat inovative në mësimdhënie si dhe për rritjen e aftësive pedagogjike të personelit akademik. Shqyrtimi nga GVJ i formateve të syllabuseve tregon që stafet akademike përcaktojnë një larmi metodash mësimdhënie, në varësi të subjekteve që mbulojnë. GVJ konstaton se UAMD ka krijuar struktura dhe ka miratuar politika të brendshme që sigurojnë cilësinë në mësimdhënie në përmbushje të kërkesave të ligjit, të cilat kanë objektiv zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies dhe të të nxënit si dhe promovimin e kulturës së rritjes së vazhdueshme në mbështetje të Rregullores së NjBSC.</p> <p><i>Evidencë 1_Statuti i UAMD;</i></p> <p><i>Evidenca 3_Rregullore e UAMD;</i></p> <p><i>Evidenca 23.1_Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të Sigurimit të Cilësisë;</i></p> <p><i>Evidenca 115_Syllabuset e lëndëve;</i></p> <p><i>Evidencë 24. Rregullore Qendra për Edukim në Vazhdim</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë</p>	<p>Në Statutin dhe Rregulloren e institucionit, Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë është parashikuar në përputhje me</p>

<p>mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>dispozitat e legjislationit në fuqi. Në Statutin e Institucionit janë të përcaktuara strukturat dhe procedurat për realizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Struktura që realizon këtë proces në nivel institucional është Komisioni i Përhershëm Për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë së Institucionit (KPGSC) dhe në rregulloren e sigurimit të cilësisë në UAMD - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), ku nga 7 anëtarë që përbëhet ky komision, një përfaqësues është nga njësia kryesore Fakulteti i Shkencave Politike Juridike. Pjesë e organizimit dhe funksionimit të këtij komisioni është dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti) - Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për cdo program studimi si edhe Koordinatorët e Programeve të studimit. Këto struktura dhe të tjera, kanë për detyrë paraqitjen e informacioneve dhe vlerësimeve për procesin e mësimdhënies, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar, si dhe janë përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, duke rekomanduar edhe masa për përmirësimin e parametrave të cilësisë në të ardhmen. Procesi i vazhdueshëm i monitorimit dhe vlerësimit për përmirësimin e cilësisë është edhe në objektivat strategjike dhe vizionin e institucionit. GVJ, nga takimi me përfaqësues të kësaj zyre në institucion, konfirmon procedurat standarde të UAMD për vlerësimin e cilësisë dhe promovimin e stafit akademik dhe ndihmësakademik të përcaktuara në Rregulloren e tij.</p> <p><i>Evidencë 25_Rregullore për sigurimin e cilësisë UAMD;</i>  <i>Evidencë 1_Statuti i UAMDT,Neni;</i>  <i>Evidencë 23, Neni 2_NjSBC;</i>  <i>Evidencë 25_Rregullore për sigurimin e cilësisë në UAMD;</i>  <i>Evidencë 10_Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Rreferuar dhe akteve ligjore të UAMD, pjesë e KPGSC është përfshirja e një studenti me mesatare mbi 9. Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive në mësimdhënie të personelit akademik realizohet kryesisht bazuar në anketimet periodike të studentëve çdo fund semestri mësimor. Në këto anketime studentët shprehin opinionin e tyre në lidhje me cilësinë e mësimdhënies për personelin akademik dhe lëndët e frekuentuara në atë semestër mësimor. Një tjetër pyetësor që angazhon studentët është</p>




	<p>anketimi gjithëpërfshirës vjetor në lidhje me opinionin e tyre të përgjithshëm për eksperiencën e tyre gjatë kohëzgjatjes së studimeve. Rezultatet e këtij anketimi bëhen publike nga NjBSC në faqen elektronike zyrtare të UAMD.</p> <p><i>Evidencë 3, Neni 20_Rregullore UAMD</i></p> <p><i>Evidenca 23.1_Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të Sigurimit të Cilësisë;</i></p> <p><i>Evidencë 81_Pyetesor Student UAMD;</i></p> <p><i>Evidenca 40_Raporti i Vetëvlerësimit UAMD</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Sistemi i sigurimit të standardeve të cilësisë në UAMD funksionon në bazë të dokumenteve dhe rregullave institucionale, të cilët përcaktojnë politikat dhe organizimin e veprimtarisë në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Njësia kryesore në fund të çdo viti akademik harton Analizën Vjetore të punës. Të dhënat e rezultateve të vlerësimit të pyetësorit të kryer për çdo semestër akademik, bëhen publike dhe ju vihen në dispozicion strukturave vendimmarrëse të fakultetit, si dhe në mënyrë individuale të gjithë anëtarëve të Stafit Akademik, të vlerësuar si dhe të aksesueshme për studentë dhe palë të tjera të interesuara, si dhe në faqen zyrtare të UAMD.</p> <p><i>Evidencë 1_Statuti i UAMD;</i></p> <p><i>Evidencë 24_Rregullore për SC-së</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Mbi bazën e analizës së rezultateve të anketimit, departamenti nxjerr problematikat dhe reagon për përmirësimin e tyre. Promovimi i përmirësimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor rezultoi nga bisedat me stafin akademik dhe studentët, të cilët përfshihen në projektet e pedagogëve të cilët kanë avancuar në karrierën e tyre përmes gradave Doktor, Prof.Asoc. dhe Profesor.</p> <p><i>Evidencë 47_Formular i vetëvlerësimit të performances së personelit akademik;</i></p> <p><i>Evidencë 82_Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ</i></p>




<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i></p> <p><i>UAMD ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies në UAMD sigurohet nëpërmjet pyetësorit të studentit dhe vlerësimit të përgjegjësit të departamentit dhe dekani. Rezultatet dhe analizat e pyetësorëve i vihen në dispozicion individualisht të gjithë anëtarëve të stafit akademik, përgjegjësve të njwsisw bazw dhe kryesore, duke diskutuar njëkohësisht edhe problematikat ekzistuese të mundshme dhe planin e masave për përmirësimin e tyre.</i></p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>		<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, GVJ konstaton se UAMD, Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë është parashikuar në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Bazuar në rregulloren për sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë në nivel institucional strukturat përgjegjëse për sigurimin e standardeve të cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Senati Akademik;</li> <li>- Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë;</li> <li>- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</li> <li>- Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë.</li> </ul> <p>Në nivel fakulteti, përgjegjës për sigurimin e standardeve të cilësisë janë:</p>





- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve;
- Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program studimi;
- Koordinatorët e programeve.

Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KPGSC) është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. Ky komision kërkon në mënyrë të vazhdueshme informacione dhe raporte lidhur me çështjet e cilësisë dhe programeve të studimit nga NjSBC, e cila ka si funksion kryesor bashkëpunimin dhe asistimin e këtij Komisioni. Komisioni mbikëqyr dhe pranon raportet 3-mujore, 6-mujore dhe ato vjetore që përgatiten nga NjSBC dhe nëse gjykohet e nevojshme i kthen ato me sugjerime apo rekomandime për reflektim të mëtejshëm. Procesi i vazhdueshëm i monitorimit dhe vlerësimit për përmirësimin e cilësisë është edhe në objektivat strategjike dhe vizionin e institucionit. Misioni kryesor i NjBSC është planifikimi i përmirësimit të vazhdueshëm të UAMD dhe realizimi i proceseve që e garantojnë këtë përmirësim. Procesi i përmirësimit të vazhdueshëm mundësohet nga angazhimi i të gjitha palëve të përfshira në sistemin e sigurimit të brendshëm. Në UAMD, rolin e NjBSC-së e realizon Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë. NjBSC në nivel Fakulteti realizon në mënyrë autonome objektivat dhe masat e vendosura nga NjBSC në nivel Institucional. Në realizimin e këtyre objektiveve NjBSC në nivel Fakulteti kërkon dosjen e programeve të studimit nga koordinatorët e programeve. Në realizimin e objektiveve të akreditimit NjBSC në nivel Fakulteti bashkëpunon me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për programet e studimit, duke u koordinuar nga NjBSC në nivel Institucional. Dokumentacioni i NjBSC në nivel Fakulteti i përcillet Dekanit dhe NjBSC në nivel Institucional.


*Evidenca 1\_Statuti i UAMD;*

*Evidenca 23.1\_Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të Sigurimit të Cilësisë;*

*Evidenca 93\_Urdhër për ngritjen e njësisë së brendshëm të sigurimit të cilësisë*




<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. Ky komision përbëhet nga përfaqësues nga secila njësi kryesore e UAMD dhe një përfaqësues të studentëve. Në nivel institucioni funksionon gjithashtu Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e ngritur me Urdhër të Rektorit, e cilë përbëhet nga një përfaqësues nga stafi akademik i çdo fakulteti të UAMD, drejtuesi i Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë në Rektorat, si dhe një përfaqësues nga studentët. Kjo njësi realizon raporte periodike të vetëvlerësimit në bashkëveprim me Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel fakulteti.</p> <p>GVJ konstaton se Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë në nivel institucional NjSBC në nivel Fakulteti si dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë ushtrojnë kompetencat me funksione të plota në ruajtjen e standardeve dhe sigurimin e cilësisë të Institucionit. Gjatë vizitës në institucion drejtuesit e programit dhe stafi akademik konfirmojnë së rishikimet e programit të studimit (nevoja të ndryshme për shtimin apo heqjen e lëndëve, përfshirjen e disiplinave të reja, ndryshimi i kategorizimit të disiplinave, apo ndryshime në ECTS dhe ngarkesën e orëve) janë realizuar konform kuadrit ligjor në fuqi me propozime të cilat vijnë nga departamenti dhe me miratim nga senati deri në masën 20 % te programit.</p> <p><i>Evidenca 1_Statuti i UAMD;</i></p> <p><i>Evidenca 3_Rregullore e UAMD;</i></p> <p><i>Evidenca 23.1_Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të</p>	<p>Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Llojet e akreditimit, afatet dhe procedurat shprehen qartësisht në Pjesën VI të rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL dhe ka marrë Akreditim për 5 vite deri në vitin 2021. Ky program studimi i nënshtrohet për herë të parë akreditimit.</p>

<p>akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p><i>Evidencë 23.1_Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë;</i></p> <p><i>Evidencë 122_Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë;</i></p> <p><i>Evidencë 133_Raporti vjetor UAMD;</i></p> <p><i>Evidenca 131,132_Raport vjetor FSHPJ 2020-2021,2021-2022</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ nga biseda me drejtuesin e FShPJ dhe DAP dhe shqyrtimi i DVV rezultojnë se në nivel institucioni dhe në nivel njësie bazë përdoren tregues të qartë e të matshëm për vlerësimin dhe mbarëvajtjen e arritjeve apo mangësive të programit të studimit si: monitorimi i syllabuseve nëse janë konform formateve të përcaktuara nga VKM dhe Departamenti, rezultatet e studentëve në provime dhe në detyra kursi, projekte, punë individuale, punë në grup, rezultatet e praktikës profesionale dhe të punimit të diplomave, si dhe rezultatet e punësimit të studentëve. Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë, aktualisht i përbërë nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Sigurimit për vlerësim institucional, ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e parametrave të cilësisë në gjithë veprimtarinë mësimore e kërkimore – shkencore të Institucionit, duke u bazuar në Standardet shtetërore të cilësisë, si dhe në Manualin për “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”. Institucioni, nëpërmjet NjSBC-së, përdor metoda të tërthorta vlerësimi, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Pyetësorë të studentëve (2 herë në vit);</li> <li>▪ Fokus grupe (në muajin dhjetor) mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës, etj.</li> </ul> <p>Bazuar në rregulloren për sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ka në kompetencat e tij kontrollin dhe miratimin e raporteve 3-mujore, 6-mujore dhe ato vjetore që përgatiten nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe nëse gjykohet e nevojshme i kthen ato me sugjerime apo rekomandime për reflektim të mëtejshëm.</p> <p>GVJ, nga dokumentacioni i paraqitur dhe diskutimet me stafin akademik dhe administrativ, konstaton se raportet e deritanishme</p>






	<p>janë të fokusuar në pasqyrimin e arritjeve dhe të dobësive të programit specifik. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies kryhet për të gjithë pedagogët me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme. Ruajtja e nivelit të regjistrimeve, nivelet e kalueshmërisë, nivelet e diplomimit, diversiteti i profileve studentore, ndërkombëtarizimi etj. Këto të dhëna mblidhen në nivel fakulteti dhe i dërgohen NjBSC-së, çdo fillim viti akademik. Më tej ajo ka për detyrë të japë mendim në formën e sugjerimeve dhe masave korrigjuese. Të dhënat, sugjerimet dhe masat korrigjuese shqyrtohen nga KPGSC-ja, dhe më pas i propozohen Senatit Akademik për miratim.</p> <p><i>Evidenca 1 _Statuti i UAMD;</i>  <i>Evidenca 3 _Rregullore e UAMD;</i>  <i>Evidenca 23.1 _Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>UAMD ka të ngritura struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucioni dhe njësie kryesore, të cilat zhvillojnë veprimtarinë e tyre bazuar në aktet e brendshme rregullatore të institucionit. UAMD ka të hartuara dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe	Njësia kryesore (FSHPJ) në bashkëpunim me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë (DKSC) organizojnë punën për kontrollin e cilësisë. Departamenti i cilë është përgjegjës për programin e studimit, është njësia që kryen dhe analizën vjetore të procesit të mësimdhënies dhe vlerësimin e

<p>mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>tij. Çdo fillim viti akademik asambleja e personelit akademik të DAP, diskuton në lidhje me programet e studimit që mbulon duke përfshirë edhe programin e studimit, Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik”. Në rastet kur shikohet e arsyeshme DAP propozon/miraton ndryshimet e nevojshme duke dokumentuar formalisht ndryshimet e bëra dhe arsyetimet përkatëse. Vlerësimi i mbarëvajtjes së programit Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik” bazohet në disa parametra sasior dhe cilësor të cilët vijnë kryesisht nga statistikatat e ofruara nga sekretaria mësimore e FShPJ dhe anketimet e studentëve. Disa nga parametrat që përdoren për vlerësimin e programit të studimit janë cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje (nota mesatare), kalueshmëria e kurseve, përqindja e studentëve të diplomuar brenda kohëzgjatjes normale të programit, përqindja e punësimit të studentëve brenda profilit pas diplomimit, opinioni i studentëve për lëndë të vecanta dhe për programin e studimit në përgjithësi. Këto të dhëna organizohen nga koordinatori i programit të studimit dhe u bëhen të njohura autoriteteve drejtuese të FShPJ. Bazuar në këto të dhëna përcaktohen edhe objektivat e programit të studimit për vitin pasardhës akademik.</p> <p><i>Evidencë 1 _ Statuti i ri i UAMD;</i></p> <p><i>Evidencë 5 _ Rregullore për sigurimin e cilësisë, e rishikuar;</i></p> <p><i>Evidencë 122 _ Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë;</i></p> <p><i>Evidencë 82 _ Raport i rezultateve të anketimit të studentëve, të anketimit të stafit akademik dhe të administratës.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të</p>	<p>Raportet e vlerësimit lidhur me ecurinë e programit të studimit me synim adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim duhet të jetë periodike dhe e vazhdueshme. Institucioni ka kapacitet për të realizuar matje sasiorë e cilësorë për të përmbushur sa më sipër. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konstatoi që instrumenti i përdorur është i mjaftueshëm për të siguruar një vlerësim cilësor dhe të besueshëm në përputhje dhe me specifikën e fushës akademike të programit të studimit, si dhe të mundsohet përdorimi periodikisht i tyre.</p>




<p>mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p><i>Evidenca 95_Analiza dhe Raporti Vjetor i DAP dhe programit te studimit;</i></p> <p><i>Evidence 122. Raporti vjetor per monitorimin dhe sigurimin e cilesise;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të DVV dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi se për vlerësimin e mbarëvajtjes së cilësisë së programeve të studimit, krahas formave të larmishme të përmendura më sipër, përdoret edhe vlerësimi i pedagogëve për njeri tjetrin nëpërmjet formularëve të vetëvlerësimit. Gjatë takimeve në institucion me GVB dhe përgjegjësen e departamentit na u konfirmuan të dhëna mbi individët e angazhuar në komisionin e sigurimit të cilësisë apo të NjsBC-së, të mbledhjeve në departament për ecurinë e procesit mësimor, vlerësimi paraprak i tezës së provimit nga drejtuesi i departamentit sipas formatit të standardizuar; mentorimi për mikrotezën e diplomimit, apo dhe vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës profesionale. Një praktikë e mirë konsiderohet raporti vjetor i departamentit i cili përfshin të dhëna përshkruese dhe sasore të hollësishme mbi çështje që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, vetëvlerësimin e stafit akademik, rezultatet e arritura të studentëve, financimi i aktiviteteve të zhvilluara dhe kërkimi shkencor, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaritë shkencore etj. Departamenti evidenton elementët që lidhen me programin e studimit dhe i bën pjesë të vetëvlerësimit në kuadër të akreditimit të programit të studimit dhe atë institucional.</p> <p><i>Evidencë Takimi me anëtarë të GVB-së, Drejtoria e Kurrikulave dhe standarteve të Cilësisë;</i></p> <p><i>Evidencë 47_Formular i vlerësimit të performancës për personelin akademik;</i></p> <p><i>Evidencë 82_Raporti i Rezultateve të anketimit të studentëve , stafit Akademik dhe Administrativ;</i></p> <p><i>Evidencë 25_Rregullore për sigurimin e cilësisë në UAMD</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të</p>	<p>Nga biseda me stafet drejtuese të institucionit dhe shqyrtimi i DVV rezulton se në nivel institucioni dhe në nivel njësie bazë përdoren edhe metoda të tërthorta për vlerësimin e ecurisë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit si: monitorimi i</p>




studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.

syllabuseve nëse janë konform formateve të përcaktuara nga VKM dhe Departamenti, rezultatet e studentëve në provime dhe në detyra kursi, projekte, punë individuale, punë në grup, rezultatet e praktikës profesionale dhe të punimit të diplomave, si dhe rezultatet e punësimit të studentëve.

Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë, aktualisht i përbërë nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Sigurimit për vlerësim institucional, ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e parametrave të cilësisë në gjithë veprimtarinë mësimore e kërkimore – shkencore të Institucionit, duke u bazuar në Standardet shtetërore të cilësisë, si dhe në Manualin për “*Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit*”. Në përmirësimin e cilësisë rol të rëndësishëm luan edhe përfshirja e studentëve dhe palëve të treta. Instrumentat e përdorura për metodën e tërthortë (sondazhe, intervista) janë pasqyruar në nenet 6 dhe 15 të rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, mbështetur nga njësitë kryesore në IAL, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimi si:

- organizon pyetësorë drejtuar studentëve dhe ALUMNI për të marrë mendim në lidhje me cilësinë e programit të studimit;
- organizon pyetësorë në formë elektronike drejtuar kompanive/palëve të treta për të analizuar performancën dhe përgatitjen e njohurive që kanë studentët e diplomuar;
- organizon workshop-ve/panaire pune ku mbledh sugjerimet dhe kërkesat e bizneseve në lidhje me programet e studimeve Institucioni, nëpërmjet NjSBC-së, përdor metoda të tërthorta vlerësimi, si:
  - Pyetësorë të studentëve (2 herë në vit);
  - Fokus grupe (në muajin dhjetor) mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës, etj.

*Evidencë 23\_Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë;*

	<i>Evidencë 47_Formular i vetevlerësimit te performances;</i> <i>Evidencë 48_Formular vlerësimi nga studentët per pedagoget;</i> <i>Evidencë 81_Model Pyetesor per studentet e UAMD</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni vlerëson dhe monitoron përmes njërive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. GVJ evidenton nevojën për të adresuar në përputhje me kapacitetet ekzistuese që programi tashmë zotëron, palët e treta, si dhe analizën e përditësuar e sistematike të ecurisë së punës në programin e studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**


<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	UAMD ka hartuar dhe zbatuar një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë si pjesë e strategjisë së saj. Gjithashtu, në dokumentet themelore si Statut, Rregullore, Strategji e Universitetit, janë të parashikuara strukturat përgjegjëse për realizimin e procedurave të brendshme të cilësisë dhe garanton përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar në këtë proces. Realizimi i instrumenteve të matjes së cilësisë si pyetësorë, fokus-grupe, anketa, formularë janë mekanizma që sigurojnë përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.  <i>Evidencë 1_Statuti i UAMD;</i> <i>Evidencë 10_Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025).</i> <i>Evidencë 3_Rregullore e UAMD;</i> <i>Evidencë RVB,</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe	Përgjegjësitë dhe detyrat e njësive të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin Master i Shkencave




<p>detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>“Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik” janë të përcaktuara në kuadrin ligjor mbi të cilin funksionon UAMD dhe në dokumentet institucionale që rregullojnë veprimtarinë e lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë Më konkretisht, Senati Akademik është organi kolegjal më i lartë drejtues i UAMD, dhe që përmbush këto përgjegjësi lidhur me sigurimin e cilësisë. Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë (KPSSC) dhe Njësia e sigurimit të cilësisë (NjSC) në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet, ushtrojnë dhe kanë lirinë e plotë për të identifikuar problematikat e programit të studimit dhe të marrin nisma për ti tejkaluar ato. Komisioni i përhershëm i kurrikulave i Senatit Akademik të UAMD dhe Drejtoria e Kurrikulave në UAMD bashkëpunojnë ngushtë me KPC dhe NjSC për sigurimin e cilësisë të programeve të studimit. Njësia e Sigurimit të Cilësisë nëpërmjet grupit ad hoc në nivel njësie bazë, monitoron zbatueshmërinë e këtyre standardeve tek strukturat dhe funksionimi i stafit akademik dhe atij administrativ në tërësi. Këto struktura nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive akademike, kërkimore shkencore dhe administrative që ushtrohen në institucion, janë fokus i një përmirësimi të vazhdueshëm të punës së këtij institucioni .</p> <p><i>Evidencë 33_Kodi i Cilësisë;</i></p> <p><i>Evidencë 24 Kreu III, Neni 13_Rregullore e sigurimit të cilësisë në UAMD;</i></p> <p><i>Evidenca 1_Statuti i UAMD;</i></p> <p><i>Evidenca 3_Rregullore e UAMD;</i></p> <p><i>Evidenca 8_Rregullore e FSHPJ;</i></p> <p><i>Evidenca 23_Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik,</p>	<p>GVJ konstaton se në vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit përfshihen studentët, pedagogët, strukturat në nivel fakulteti, departamenti dhe në rang universiteti. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit garantohet përfshirja e departamenteve dhe FShPJ, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e</p>

<p>ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 1_Statuti i UAMD;</i>  <i>Evidenca 7_Rregullore e UAMD;</i>  <i>Evidenca 8_Rregullore e FShPJ;</i>  <i>Evidenca 10_Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni ka përcaktuar standarde që të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve të përfshirë në proceset ciklike të vlerësimit te tilla si: kompetencat profesionale; paanshmëria; qasja në informacionet për të kryer vlerësimin Nga shqyrtimi i raporteve të vlerësimit GVJ konfirmon se ato respektojnë etikën dhe integritetin akademik të personelit të përfshirë në sigurimin e cilësisë në Departamentin e Administrimit Publik. Sikurse u diskutua me përgjegjësen e Departamentit dhe të NjSBC, për çdo vërejtje konkrete në adresë të stafit akademik që ka dalë nga procesi i vlerësimit, ata kontaktohen veçmas duke shmangur çdo keqkuptim për këtë proces. Po ashtu, edhe vlerësimet e studentëve janë anonime, për të siguruar çdo qëndrim negative ndaj kritikave të tyre. Specifikisht këto standard referohen në Rregulloren e NjSBC në UAMD dhe Kodin e Etikës.</p> <p><i>Evidenca 3_Rregullore e UAMD;</i>  <i>Evidencë 32_Kodi i Etikës</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të DVV, GVJ konstaton përfshirje të drejtpërdrejtë të bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm me proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, në nivel programi studimi. Gjithsesi, personeli i jashtëm akademik, i angazhuar në programin e studimit, sikurse dhe ky proces vlerësimi i jashtëm që po i nënshtrohet programi për herë të parë, janë element që ndikojnë në përfshirjen e aktorëve të tjerë në procesin e sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 1_Statuti i UAMD;</i></p>






me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<i>Evidenca 3_Rregullore e UAMD, Evidenca 8_Rregullore e FSHPJ;</i> <i>Evidenca 23_Rregullore për Funkionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë;</i> <i>Evidencë 140_Vendim DAP për anëtarin e NjSBC të FShPJ</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ arrin në konkluzionin se Institucioni përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Sistemi i sigurimit të standardeve të cilësisë në UAMD funksionon në bazë të dokumenteve dhe rregullave institucionale, të cilët përcaktojnë politikat dhe organizimin e veprimtarisë në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Njësia kryesore në fund të çdo viti akademik harton Analizën Vjetore të punës. Të dhënat bëhen publike dhe të aksesueshme për studentë dhe palë të tjera të interesuara, si dhe në faqen zyrtare të UAMD.  <i>Evidencë 1_Statuti i UAMD;</i> <i>Evidencë 3_Rregullore UAMD;</i> <i>Evidencë 24_Rregullore e SC</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm i Cilësisë (KPGSC) në UAMD ka të përcaktuara parime të cilat sigurojnë garantimin e transparencës, informimin e personelit dhe






<p>programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>studentëve mbi raportet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit, duke respektuar Kodin e Etikës dhe Rregulloret e UAMD.</p> <p><i>Evidencë 25, Aneks I _Rregullore për Sigurimin e Cilësisë; Model i Raportit e vlerësimit të brendshëm për programet e studimit;</i></p> <p><i>Evidencë 32_Kodi i Etikës UAMD;</i></p> <p><i>Evidencë 3 _Rregullore e UAMD)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentave të dosjes se vetëvlerësimit dhe takimeve me aktorët përgjegjës, të gjithë pyetësorët e plotësuar janë përpunuar, me metoda cilësore dhe sasiore, në varësi të llojit të pyetjes. Problemet që janë evidentuar nuk kanë qenë esenciale të lidhura me stafin akademik, stafin administrativ apo literaturën që përdorin. Gjithësesi DAP, në raportin vjetor ka të evidentuara përmirësimin cilësisë për procesin e mësimdhënies, performancës së tyre, infrastrukturës etj. <i>GVJ nuk gjeti dokument me të dhëna plane masash të hartuara nga njësia bazë, apo nga njësia kryesore lidhur me përmirësimin e mangësive dhe të dobësive të konstatuara për këtë program studimi, me argumentin se ky program studimi nuk i është nënshtruar procesit të vlerësimit dhe të akreditimit të jashtëm.</i></p> <p><i>Evidencë 95_Raporti Vjetor i DAP;</i></p> <p><i>Evidencë 130,131,132, _Raporti vjetor i FShPJ v.a 2019-2020, 2020-2021,2021_2022</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UAMD nëpërmjet NjSBC analizon në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe ato të kërkimit shkencor. Analizat periodike dhe ndërëgjegjësi për rëndësinë e ruajtjes së cilësisë mundësojnë përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Stafin akademik dhe studentët e programit të studimit Master i Shkencave në “Politika dhe Administrim me profil: Administrim Publik”, gjatë takimeve me GVJ-në, shprehën gatishmërinë dhe vullnet të mirë për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit, nisur nga analiza vjetore e punës që vetë departamenti hartonte.</p>

	<p><i>Evidenca 95_Analiza Vjetore e DAP;</i></p> <p><i>Evidenca 51_Buletini i aktiviteteteve dhe kerkimit shkencor FShPJ, DAP 2023;</i></p> <p><i>Vizita në Institucion, takimi me personelin akademik dhe studentët e programit</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni në fillim të çdo viti akademik në javët orientuese sqaron studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit, avantazhet dhe disavantazhet që kanë këta të fundit nga vlerësimi cilësor dhe vlerësimi institucional. Institucioni ka gjithmonë në vëmendjen e tij përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore - shkencore që ofron. Sigurimi i cilësisë është pjesë e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit të Universitetit.</p> <p>GVJ nga takimet me studentët dhe personelin akademik konstatoi, se DAP organizonte takime të hapura, në të cilat marrin pjesë studentë, staf akademik dhe përfaqësues të tregut të punës, duke i informuar ata dhe duke nxitur ndërgjegjësimin dhe rëndësinë e ruajtjes së cilësisë dhe nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm në përputhje me standardet e cilësisë.</p> <p><i>Evidencë 10_Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit përfshijnë të gjithë aktorët e interesuar, strukturat, stafet akademike dhe studentët e bashkëpunëtorët e jashtëm. Gjetjet e vlerësimeve diskutohen në takime dhe workshope të organizuara në UAMD, me synim krijimin e kulturës së brendshme të cilësisë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X




**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Politika dhe Administrim, me profil: “Administrim Publik”, ofruar nga Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike, pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Përvoja e fituar ndër vite, në programin e studimit Master i Shkencave në Administrimin Publik, me profil Administrim Publik, përbën një bazë të mirë mbi të cilën mund të ndërtohet një prognozë më e qartë dhe më e besueshme.
2. Staf i akademik është i kompletuar, me eksperiencë akademike dhe profesionale. Ata janë të përfshirë në disa programe dhe projekte të bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar dhe kjo përbën një avantazh krahasues.
3. Plani mësimor i programit të studimit është i kompletuar me lëndët e rëndësishme dhe prioritare të fushës, duke u pajisur me një formim cilësor studentët, që u mundëson atyre punësim në tregun e punës si dhe ekuivalentim dhe njohje të studimeve.
4. Në programin e studimit, Master i Shkencave në Administrimin Publik, me profil Administrim Publik, ka studentë që janë në marrëdhënie pune, që kanë eksperiencë, që njohin bizneset, administratën publike apo institucionet ku punojnë. Ata kanë kulturën e punës dhe bëjnë lidhjen e fortë midis njohurive të marra në auditor dhe praktikës.
5. Bashkëpunimi i Departamentit të Administrimit Publik dhe Fakultetit të Shkencave Politike dhe Juridike me disa fakultete të tjera jashtë, si dhe marrëveshja e nënshkruar për ofrimin e diplomës së dyfishtë ndërmjet UAMD dhe Universitetin Côte D’Azur, Nicë, Francë është një eksperiencë që mund të sjellë përfitime në të ardhmen.
6. Përfshirja e departamentit dhe e Fakultetit në disa projekte të financuara prej qeverisë shqiptare si dhe bashkëpunimi me strukturat shtetërore të administratës publike dhe me strukturat e institucioneve vendore dhe rajonale.
7. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione publike dhe biznese private, lehtësojnë dhe mundësojnë kryerjen e praktikave profesionale si dhe punësimin në të ardhmen e studentëve në këtë programi studimi.
8. UAMD dhe FShPJ, disponon mjediset e nevojshme fizike dhe laboratorike për të realizuar sa më mirë procesin e mësimdhënies dhe praktikave mësimore për studentët e këtij programi studimi.
9. Biblioteka e universitetit dhe fakultetit si dhe aksesin në libraritë online, plotëson kërkesat e stafit akademik dhe studentëve me literaturën bazë dhe ndihmëse për nevojat e procesit mësimor si dhe kërkimin shkencor.
10. Mbështetja financiare nga ana e institucionit për stafin akademik, sa i përket pjesëmarrjes në konferenca dhe botime të artikujve në revista shkencore të indeksuara në scopus dhe faktor impakt.

**Pika të dobta**

1. Niveli i ulët në njohjen e gjuhëve të huaja prej studentëve plogështon përfshirjen e tyre në hapësirat e bashkëpunimit ndërkombëtar që Departamenti dhe UAMD kanë mundësuar .

2. Mungesa e ofrimit të trajnimeve të vijueshme profesionale, për studentët e diplomuar në këtë program studimi, në bashkëpunim me institucionet partnere [(Standardi I.2, Kriteri 5)].
3. Përdorimi i kufizuar i platformave e-learning, për arsye të mungesës së infrastrukturës nevojshme teknologjike [(Standardi III.1, Kriteri 2; RVB)].
4. Zhvillimi kryesisht mbasdite i procesit mësimor dhe larg qytetit të Durrësit, nuk krijon kushte të mira për shfrytëzimin e bibliotekave, të infrastrukturave të tjera dhe të laboratoreve mbas orës së orarit zyrtar. Në orën 17:00 përgjithësisht zyrat dhe mjediset universitare janë të mbyllura [(Standardi IV.2, Kriteri 1)].
5. Rënia e numrit të studentëve të rregjistruar, apo më saktë, mosplotësimi i numrit të kuotave të parashikuara përbën gjithashtu një disavantazh për këtë program studimi [(Standardi VI.5, Kriteri 4)].


#### **Rekomandime**

1. Në rekrutimet/pranimet e reja, duhet vendosur si kriter njohja e mirë e gjuhës së huaj, me atë IAL të huaj në të cilën njësia kryesore dhe njësia bazë kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe këmbimi apo ekuivalentim kreditësh.
2. Shkëmbimet e studentëve në programet e diplomave dyfishë të kthehet në praktikë standarde dhe jo në mënyrë rastësore dhe me numër shumë të reduktuar.
3. Ofrimi i trajnimeve profesionale në vazhdimësi për studentët e diplomuar, nga njësia kryesore/bazë në bashkëpunim me institucionet dhe bizneset partnere.
4. Të rritet përdorimi i platformave e-learning, duke ofruar për studentët dhe stafin akademik, mënyra dhe metoda alternative e interaktive të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

#### **Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in Politics and Administration with profile: Public Administration provided by the Faculty of Political and Legal Sciences at "Aleksander Moisiu University, Durrës.**

#### **Strengths and affirmations**


1. The experience gained over the years, in the study program, Master of Science in Public Administration, with the profile Public Administration, constitutes a good basis on which a clearer and more reliable prognosis can be built.
2. The academic staff is complete, with academic and professional experience. They are involved in several national and international cooperation programs and projects, constituting a comparative advantage.

3. The curriculum of the study program is completed with the important and relevant courses of the respective fields, providing qualitative education to the students and enabling them to be successfully employed in the labor market or continue further studies.
4. In the study program, Master of Science in Public Administration, with the profile Public Administration, there are students who are in employment, have experience, know the businesses, public administration or institutions where they work. They have a work culture and connect strongly with the knowledge gained in the auditor and the practice.
5. The cooperation of the Department of Public Administration and the Faculty of Political and Legal Sciences with several other faculties abroad, as well as the agreement signed for the provision of a double degree between AMUD and the Côte D'Azur University, Nice, France, is an experience that can bring benefits in the future.
6. The involvement of the department and the Faculty in several projects financed by the Albanian government, as well as cooperation with the state structures of the public administration and with the structures of local and regional institutions.
7. Cooperation agreements with public institutions and private businesses facilitate and enable the performance of professional practices as well as the future employment of students in this study program.
8. AMUD and FPLS have the necessary physical and laboratory facilities to carry out the teaching process and teaching practices as best as possible, for students of this study program.
9. The university and faculty library, as well as access to online libraries, meets the requirements of academic staff and students with basic and supplementary literature for the needs of the teaching process and scientific research.
10. Financial support from the institution for the academic staff, in terms of participation in conferences and publication of articles in scientific journals indexed in Scopus and with impact factor.

### Weaknesses

1. The low level of knowledge of foreign languages by students slows down their involvement in the spaces of international cooperation that the department and AMUD have made possible (IER).
2. The lack of provision of continuous professional training, for the students who graduated in this study program, in cooperation with the partner institutions [(Standard I.2, Criteria 5)].
3. Limited use of e-learning platforms, due to lack of necessary technological infrastructure [(Standard III.1, Criteria 2; IER)].
4. The development of the learning process mainly in the afternoon and far from the city of Durres, does not create good conditions for the use of libraries, other infrastructures and laboratories after the official schedule. At 5:00 p.m., offices and university facilities are generally closed. [(Standard IV.2, Criteria 1)].
5. The decrease in the number of registered students, or more precisely the non-fulfilment of the number of foreseen quotas, also constitutes a disadvantage for this study program [(Standard VI.5, Criteria 4)].

### Recommendation

1. In new recruitments/admissions, a good knowledge of a foreign language should be set as a criterion, with that foreign HEI in which the main unit and the base unit have signed a cooperation and exchange agreement or credit equivalence.
2. Exchanges of students in double degree programs should be returned to standard practice, not randomly and with a much reduced number.
3. Providing continuous professional training for graduate students, from the main and basic unit in cooperation with partner institutions and businesses.
4. Increasing the use of e-learning platforms, to provide students and academic staff alternative and interactive teaching and learning methods.

### Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E				X

<b>PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				<b>X</b>
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>